



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-4294/2026
Kaçanik, 16.02.2026

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Legjislaturës së 8 të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 26 shkurt 2026 (e enjte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Në mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të datës 26.02.2026, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2025;
3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025;
4. Raporti vjetor i Njësisë së Auditimit të brendshëm, për vitin 2025;
5. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026;
6. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;
7. Propozim Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Isen (Agush) Raka;
8. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K Koxhaj, në Z.K Soponicë dhe Z.K Stagovë;
9. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik të parcelave kadastrale në Z.K në Kaçanik dhe në Z.K Bob;
10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të reshurat e bores 02.10.2025 dhe të reshurat e shiut 24,25.11.2025;
11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;
12. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës - AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-1776/26
Kaçanik, 30.01.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.01.2026. Mbledhja është mbajtur në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 19 anëtarë. Gjatë tërë mbledhjes munguan me arsye 2 anëtare: Lejla Luta dhe Hafize Sallahi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema, drejtorët e drejtorive komunale: Korab Krasniqi-DUKMM, Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika Selmani-DSHMS, Arlinda Rakoci Raka-DZHET, Gazmend Bunjaku-DA, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi-Zyra e IT, Makfire Malsiu- Zyra e KK, Mavije Murseli- Kabineti i kryetarit.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka.

Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit

Procesmbajtëse, Makfire Malsiu, ZLPKK.

Kryesuesi i Kuvendit z. Selajdin Troni: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, prezent janë 19 anëtarë. Në mbledhje mungojnë me arsye 2 anëtare: Lejla Luta dhe Hafize Sallahi. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e I-r të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 30.01.2026, me këtë:

REND PUNE

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Brahim Imishti;
2. Betimi Solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Elona Gjini;
3. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja I-r e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2025;
4. Plani i punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2026;
5. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026;

6. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;
7. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” Sh. A- Njësia në Kaçanik;
8. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë;
9. Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;
10. Propozim Vendimi për Ndryshim dhe Plotësim të Vendimit 01 Nr.060/01-31302/2025 të datës 30.12.2025 për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Brahim Imishti;

Kryesuesi i Kuvendit: E ftoj anëtarin e zgjedhur të Kuvendit të Komunës Brahim Imishti, të lexoj tekstin e Betimit solemn për anëtar të Kuvendit të Komunës, ndërkaq në shenjë respekti, ju ftoj të gjithë të ngritëm të gjithë në këmbë.

z. Brahim Imishti : Fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimit Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Në sajë të kësaj del konstatimi se ,

Ndryshohet dhe Plotësohet përbërja e Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së tetë (8), të zgjedhur me 12 Tetor 2025/ Lënda: 01Nr. 060/02-2646/26.

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 01/33-2026 të datës 12.01.2026 pranuar me 14.01.2026, protokoli i komunës 01Nr. 60/01-1230/26, anëtari i dorëhequr nga PDK Xhelal Dema, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i PDK, Brahim Imishti, i cili nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin.

2. Betimi Solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Elona Gjini;

Kryesuesi i Kuvendit: E ftoj anëtares e zgjedhur të Kuvendit të Komunës Elona Gjini, të lexoj tekstin e betimit solemn, për anëtar të Kuvendit të Komunës, ndërkaq në shenjë respekti, ju ftoj të gjithë të ngritëm të gjithë në këmbë.

znj. Elona Gjini: Fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, e lexoi tekstin e Betimin Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Në sajë të kësaj del konstatimi se,

Ndryshohet dhe Plotësohet përbërja e Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së tetë (8), të zgjedhur me 12 Tetor 2025/ Lënda: 01Nr. 060/02-2645/26.

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 01/37-2026 të datës 12.01.2026 pranuar me 14.01.2026, protokoli i komunës 01Nr. 60/02-1227/26, anëtarja e dorëhequr nga PDK Dardana Tafili Dauti, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i PDK, Elona Gjini, e cila kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin.

Kryesuesi i Kuvendit: I uroj anëtarët e zgjedhur të KK, Brahim Imishti dhe Elona Gjini, iu uroj shëndet dhe suksese në aktivitetin e Kuvendit të Komunës, ndërkaq konstatoj me kaluar në pikën vijuese:

3. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja I-r e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: A ka kush ndonjë vërejtje në Procesverbal?

z. Islam Gashi:

Fillimisht shfrytëzoj rastin ti uroj të gjithë drejtorët dhe dy anëtarët e ri të KK për marrjen e mandatit.

Vërejtjet në procesverbal: Propozimin për anëtarët e LVV me u përfaqësuar në Komitetin për Politikë dhe Financa e ka dhënë Islam Gashi, e jo siç është shënuar, Jeton Luma. Propozimin për anëtarin e LVV në Komitetin për Komunitete e ka dhënë, Enis Vishi, e jo siç është shënuar, Buletin Guri. Propozimin për anëtarin e LVV në Komisionin për hartimin e Planit të Punës së KK për vitin 2026, e ka dhënë Buletin Guri, e jo siç është shënuar, Islam Gashi.

z. Heset Malsiu:

Përshëndetje për të gjithë, urime për marrjen e mandatit dy anëtarëve të ri të KK, suksese. Urime edhe të gjithë drejtorëve të drejtorive, besoj se e kanë marrë një detyrë të rëndësishme që ju ka besuar, për me zhvilluar komunën e Kaçanikut me aktivitetin dhe angazhimin e tyre. Si opozitë ne besojmë shumë se nuk do të kemi nevojë me u marrë shumë me ta, ndërkaq nëse është nevojë, ne do të jemi këtu.

Vërejtje në procesverbal: Janë bërë disa lëshime teknike në emërtimin e subjektit politik të cilit i përkasim. Aty ku është shënuar, Vizioni për Zhvillimin Ekonomik, duhet të korrigjohet, dhe të shënohet, Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit: Me këto korrigjime teknike, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës.

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja I-r e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2025, të datës 30.12.2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-31227/2025.

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës i korrigjuar.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit-Selajdin Troni, konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Bashkim Krasniqi: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, uroj dy anëtarët e ri për marrjen e mandatit. E përshëndeti vendimin e kryetarit të komunës për mbulimin e shpenzimit të transportit për dy shkollat e mesme në Kaçanik.

1. Kam një kërkesë për nxënësit e komunës tonë që janë në drejtimin e mjekësisë në Ferizaj, pasi në komunën tonë nuk është drejtimi i mjekësisë, kërkoj të shqyrtoni mundësitë që nxënësve të drejtimit të mjekësisë, t'iu mundësohet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit.

2. Kërkesë tjetër, të shqyrtohen mundësitë për një subvencionim me mjete, Shefket Palloshit, për incizim dhe transmetim të drejtpërdrejtë të videove të luftës dhe të pasluftës, videove të aktivitete sportive dhe aktivitete tjera.

z. Jeton Luma: Fillimisht shfrytëzoj rastin ti uroj anëtarët e Ekzekutivit të komunës dhe dy anëtarëve të ri të KK për marrjen e mandatit, shëndet dhe punë të mbarë.

1. E ngriti problemin e ndriçimit publik në f. Gllloboçicë, ku me tepër se gjysma e fshatit janë pa ndriçim publik. Shumica e dritave që janë vendosur nëpër lagje të ndryshme janë të dëmtuara dhe ndodhë shpesh që mos me u riparuar për një kohë të gjatë. Kjo çështje bien në kompetencë të DSHPE. Kërkoj me marrë përgjigje nga kryetari apo nga drejtori i DSHPE: Edhe sa kohë duhet me u mbuluar edhe pjesa tjetër e fshatit me ndriçim publik? Si funksionon çështja e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, a kontraktin komuna ndonjë kompani, nëse po cila është ajo kompani dhe kur do të merren veprimet e nevojshme për riparimin e dritave në fshatin Gllloboçicë?

znj. Ardita Rrahmani: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, iu uroj mandatin Ekzekutivit të komunës, shëndet e suksese, uroj me përfunduar deri në fund mandatin, pastaj rezultatet janë të përbashkëta. I uroj Brahim Imishti rikthimin në KK, edhe Elonës i uroj marrjen e mandatit të anëtares së KK.

Pasi kanë kaluar disa muaj nga mbledhja e fundit e KK e legjislaturës së kaluar ku kemi ngritur kërkesa, tani numri i kërkesave padyshim se ka me qenë me i madh. Kërkoj nga Ekzekutivi i komunës të merr parasysh çdo kërkesë, dhe të trajtoj me seriozitetin me të madh, pasi që kërkesat janë gjithëpërfshirëse.

Kërkesat:

1. Kërkesë imediate dhe nga shumë qytetarë është ajo e lagjes Dushkaja, konkretisht rruga në lagjen Dushkajë- pjesa në kyçje të magjistrales, në dalje të gjimnazit, e

- cila rrugë ka kohë që është dëmtuar, dhe nuk është në funksion pasqyra konvekse e komunikacionit, përkundër se ka hyje dalje të mëdha në atë rrugë.
2. Kërkesë e qytetarëve- por edhe e përsëritur, Kur do të bëhet emërtimi i Palestrës sportive të qytetit?
 3. Me shumë vetëdije po e shfrytëzoj të drejtën për kërkesë tjetër publike drejt KRU“Bifurkacionit” për rregullimin e gypave të kanalizimit në rrugë lokale, konkretisht në një nga lagjet me të mëdha të qytetit, lagjja “Ismail Qemali”, ka muaj që uji kalon përmes rrugës. Me rritjen e çmimeve të tarifave të ujit dhe të kanalizimit, ishte edhe zotimi për cilësi. Kur mendohet me u marrë veprime të nevojshme me u intervenuar në atë pjesë? E di se nuk është pyetje për DSHPE, por i takon KRU “Bifurkacionit”.
 4. Sa e di unë, nga vitit 2022 ekziston Strategjia kombëtare dhe Plani i veprimit për menaxhimin e kontrollin e qenve me dhe pa pronar në Republikën e Kosovës. Referuar legjisllacionit në fuqi, komunat janë një ndër tre akterët përgjegjës për kontrollimin e qenve. Ku jemi ne si komunë me menaxhimin e qenve?

z. Kijani Zeneli: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, uroj anëtarët e ri të KK për marrjen e mandatit.

Unë nuk do të flas shumë, se atë që pata me thënë e potencoj edhe Ardita.

1. Çështja e ujësjellësit dhe kanalizimit, dihet se janë në domenin e KRU “Bifurkacioni”, mirëpo edhe komuna duhet me pasur qasje sa i përket këtyre shërbimeve që disa punë me u kryer. Ardita me herët ka pas ardhur me shishe këtu, tani është pjesë e koalicionit, mendoj se disa punë sa i përket kësaj çështje, duhet të angazhoheni me u kryer. Unë po ndërlihem të pika 7, të KRM “Pastërtia”, këtu kemi nevojë për me na dhënë sqarime me të hollësishme, për shkak se KRM “Pastërtia” ka numër të madh të punëtorëve, ndërkaq komuna është aksionare e kësaj kompanie.

Kryesuesi i Kuvendit: Kijani, jemi të pyetjet dhe kërkesat, kur të mbërrijmë të pika 7, atëherë jepen sqarime me të hollësishme.

znj. Shqipe Murseli: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e ngriti çështjen e një parcele në afërsi të shkollës e cila është duke u ndërtuar në f. Doganaj. Kërkoj të merret parasysh kërkesa ime, që ajo parcelë ti bashkëngjitet shkollës, pasi që shkolla është në përfundim të punimeve.

znj. Ernesta Krasniqi: Pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi dhe qytetarët, e uroj ekzekutivin për mandatin, ndërkaq theksoj se kisha pasur dëshirë që përfaqësimi i grave në ekzekutiv mos të mbetet vetëm në plotësimin e kuotës gjinore dhe ligjore me vetëm 3 femra. Sidoqoftë, iu uroj suksese të gjithëve në realizimin e përgjegjësi të marra. Njëherë i uroj dy kolegët e ri asamblistë, ju priftë e mbara.

Kërkesat:

1. Kërkesa e parë i drejtohet Kryetarit të komunës dhe Kryesuesit të KK. Ne si anëtarë të KK parashtrijmë pyetje dhe kërkesa, ndërkaq kërkoj që të njëjtat mos mbesin pa përgjigje për 3-4 muaj apo fare siç ka ndodhur në mandatin e kaluar. Mendoj se një afat prej 1 muaji ashtu siç i kemi mbledhjet çdo muaj, është e arsyeshme për kthimin e përgjigjeve, në mënyrë që ato përgjigje të jenë ende relevante dhe mos të humbin kuptimin për ne dhe për të gjithë qytetarët.
2. Projekti i nënkalimit, sipas meje ky projekt është total i dështuar. Për me shkuar me i promovuar projektet me prerë shirita, i vizitoni projektet, ndërkaq nuk e di a ka shkuar ndonjëherë Kryetari i komunës me pa se, A mundet me kaluar ndokush

andëj? Kohëve të fundit kemi pa se janë vendosur disa mbulesa të nënkalimi. Kërkesa ime është: A kanë qenë këto mbulesa në projektin fillestar, apo janë bërë me aneks kontratë? Sot kam shkuar me shikuar gjendjen e nënkalimit të këmbësorëve dhe Në vazhdim znj. Krasniqi i prezantoi disa foto të gjendjes në atë pjesë, ndërkaq theksoj se janë shpenzuar 54 mijë euro përsëri dhe nuk mundesh me kaluar për shkak të grumbullimit të ujit. Edhe sa mjete duhet me shpenzuar me finalizuar projektin. E kemi pa se për një projekt shpenzohen mjete 3-4 herë, uroj të mos arrijë shuma gjysmë milioni euro, sikurse që janë shpenzuar për parkun e qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ernesta jemi të pyetjet dhe kërkesat, nuk ka nevojë për me debatuar.

z. Heset Malsiu: Duke ditur se ka një numër të madh të punëtorëve që punojnë në Ferizaj, deri në orët e vona të natës, është mirë të shqyrtohet mundësia e një linje të autobusit, Ferizaj-Kaçanik, pas orës 22:00, për arsye se po iu kushton udhëtimi dhe si rezultat i kësaj shumica e banorëve po largohen nga Kaçaniku dhe po gjejnë banim në Ferizaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, atëherë vazhdojmë me pikat e rendit ditës:

4. Plani i punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2026;

Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, uroj drejtorëve të drejtorive marrjen e mandatit. Gjithashtu i uroj anëtarët e ri të KK, Brahim Imishti dhe Elona Gjini, suksese dhe mbarësi për të gjithë. Ky plan i ekzekutivit, i cili paraqitet në letër, është i mirë, ndërkaq ne si LVV do të monitorojmë gjatë tërë vitit, dhe do të debatojmë në raportin e realizimit të këtij plani.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, Plani i punës së Ekzekutivit të komunës kalon vetëm si informatë, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Planin e punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2026/ Lënda: 01Nr. 104/02-1729/26.

5. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Jeton Luma: Unë si anëtar i komisionit për hartimin e planit të punës së KK për vitin 2026, i kam shtuar disa pika, disa janë pranuar disa jo. Mendoj se pika: Pyetje dhe Kërkesa duhet me ekzistuar të secila mbledhje e rendit të ditës dhe kjo i jep hapësirë secilit anëtar të KK të shprehë një nevojë apo sfidë të lokalitetit nga vjen. Kur unë e kam kërkuar këtë pikë me u futur në plan, me është thënë se nënkuptohet. Ne e dimë se edhe procesverbali nënkuptohet, por duhet me figuruar, ashtu edhe kjo pikë duhet me qenë në secilin rend të punës. Unë kam kërkuar edhe pikë tjera, një ka të bëjë me orarin. Ne shumica jemi të besimit islam dhe mbledhja mundet me u caktua në ditën e premte. Në llogaritjen dimërore të kohës, në ora 12:00 falet namazi i xhumasë. Nëse ekziston

mundësia në llogaritjet dimërore, orari i mbledhjeve të jetë për 1 orë me herët, për me dhënë mundësia me i kryer ritet fetare.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë nuk e di qysh mundemi me i përshtatur këto data e dita.

znj. Kadrije Lika Troni: Nga ne si grup i anëtarëve të LVV gjatë mandateve vazhdimisht kemi kërkuar të investohet në një sallë të kuvendit, e cila do t'i plotësoj kushtet minimale, sipas standardeve, që seancat të mbahen normalisht. Këtë çështje e diskutuam edhe në mbledhjen e KPF. Ky KK që nga fillimi nuk ka foltore dhe ju e dini se foltorja është e rëndësisë së veçantë, se aty paraqitja dhe përfaqësimi qytetar është më dinjitoz. Po ashtu zërimi është i dobët, ndriçimi nuk është në nivel, kamerat nuk mbulojnë hapësirat e kësaj salle sa duhet dhe kjo po e vështirëson përcjelljen e seancave nga qytetarët. Qytetarët nga transmetimi live e kanë të vështirë të dallojnë kush përfaqëson pozitën, kush opozitën dhe kush ekzekutivin. Tani keni parasysh i kemi drejtorët e drejtorive të cilët na qëndrojnë prapa e nuk kanë as zërim, e që këta duhet të ishin përballë neve. Kur e shikova planin e KK për këtë vit, i cili është mjaft voluminoz, nuk pash që parashihet, Ndërtimi apo rregullimi i një salle të KK që i plotëson standardet minimale për mbajtjen e seancave. Duhet pasur parasysh që KK, është institucioni me i lartë përfaqësues i qytetarëve të komunës tonë dhe si i tillë duhet të shërbejë si tempull i demokracisë. Prandaj, po kërkoj që kjo çështje me u trajtua seriozisht, me u futur në plan dhe me u caktuar një afat konkret për ndërtimin e një salle dinjitoze që plotëson kriteret e një salle të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa e juaj Kadrije është shumë me vend, është e vërtetë se nuk i kemi kushtet e punës të mira, por po besoj që gjatë këtij mandati kryetari do t'na i rregulloj një sallë të mirë. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Planin e punës së KK për vitin 2026, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026/Lënda: 01Nr. 060/01-1779/26.

6. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Themelimi i KKSB shihet se ka përbërje prej 15 anëtarëve, ndërkaq përfaqësuesit nga FSK nuk është caktuar emri. Kërkoj nga Kryetari i Komunës të dimë për emrin e përfaqësuesit të FSK. Gjithashtu në këtë këshill nuk është përfaqësimi gjinor i mjaftueshëm, pasi janë përfaqësuar vetëm 3 femra. Unë mendoj se ky këshill është i mangët pa përfaqësim të mjaftueshëm gjinor apo kuotës gjinore.

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Faleminderit kryesues, faleminderit për pyetjen zonja Kadrije. Një përgjigje e keni marrë edhe në pyetjen që e keni ngritur në KPF, ku keni thënë se duhet me pasur edhe përfaqësim nga shëndetësia-QKMF. Ky Propozim Vendim është në përputhje me aktet në fuqi, janë dhënë emrat e përfaqësuesve, me përjashtim të përfaqësuesit nga FSK, ata e sjellin emrin dhe e shihni anëtarin nga FSK në mbledhjen e parë të KKSB. FSK mund të ndodhë që i ndryshojnë emrat, se e dërgojnë nga

një përfaqësues, nuk e sjellin sa herë të njëjtin. Sa i përket gjinisë, kështu kemi menduar se është në rregull, përkundër që ju nuk mundeni me u pajtuar.

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk është pyetje se a pajtohem apo jo, por kujtoj se në çdo komision duhet me u respektuar kuota gjinore. Ky grup prej 15 anëtarëve, nuk e ka të përfshirë kuotën gjinore, se janë vetëm 3 gra të përfaqësuar. Për përfaqësuesin nga FSK, në mbledhje të KPF na keni thënë se emrin do të keni në KK. Pse nuk është siguruar me herët emri i përfaqësuesit të FSK, a keni pasur problem me emrin apo çka është në pyetje? Unë nuk mund të votoj këtë këshill, pa e pasur emrin e përfaqësuesit nga FSK.

Kryetari i Komunës: Nuk e di se kam thënë se keni me pasur emrin e FSK në KK, por kam thënë që keni me i pasur pozicionet që në KK kemi me debatuar me gjerësisht. E dyta, Sa i përket përfaqësimit gjinor, këtu shkon përfaqësimi me funksione, e që disa pozita i ushtrojnë meshkujt, si kryetari i komunës, komandanti i policisë etj. Aty ku kemi mundur me bërë ndërhyrje, e kemi përfshirë strukturën gjinore. Ata që janë me pozicione përkatëse, nuk mundemi me i ndryshuar, pasi që sipas funksionit, caktohet përfaqësuesi. Nuk mundemi me ndryshuar përfaqësuesin ku duhet të jetë, komandanti i policisë, nuk mundemi me ndryshuar përfaqësuesin e BI- ku duhet të jetë kryetari i kësaj bashkësie, etj., nëse ju mundeni me ndryshuar diçka në këtë drejtim, urdhëroni.

znj. Kadrije Lika Troni: Të përfaqësuesi i bizneseve, mundet me u ndryshuar, me qenë një femër. Edhe të OJQ lokale, a mundemi me ndryshuar kryesues, a ka ndonjë të gjinisë femërore nga OJQ. Nuk është puna kush po e thotë këtë, por çështja është se e thotë ligji. Ne të njëjtën kohë e kemi edhe një deklaratë me u respektuar gratë në politikë, ndërkaq këtu po bëhet menjëherë shkelja, se nuk po është përfaqësimi gjinor.

z. Jeton Luma: Të pozicioni me numër 5, përfaqësuesi për barazi gjinore, është Vedat Dema. A mundet me qenë ndonjë zyrtare (femër) nga kjo zyre.

Kryetari i Komunës: Në Zyrën për Barazi Gjinore është vetëm Vedati.

z. Jeton Luma: Në rregull atëherë.

znj. Kadrije Lika Troni: Përfaqësuesin për barazi gjinore e keni në këtë këshill, ndërkaq në anën tjetër nuk po e respektoni në këtë këshill barazinë gjinore. Ndryshimi mundet me u bërë në këtë këshill, që me pasur me tepër femra, nëse nuk ndryshohet, ne si grup i LVV, do të jemi kundër miratimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim themelimin e KKSB. Rezultati i votimit është: 13 votë Për, Kundër janë 6 nga LVV. Abstenim nuk ka. Prezentë 19. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB / Lënda: 01-Nr.60/01-1739/26.

7. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” Sh. A- Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kijani Zeneli: Unë të KRM “Pastërtia” i kam disa vërejtje. Sa i përket shërbimeve të kësaj kompanie, shërbimet janë të mira, ndërkaq sa i përket mbulimit të terrenit me shërbime, kemi vërejtje. Nuk e di ku është arsyeja pse nuk mbulohet krejt terreni ? Kompania po ka mundësi me i mbuluar me shërbime fshatrat me të thella si fjala vjen fshatin Gllloboçicë, ndërkaq nuk po ka mundësi me e mbuluar, Kaçanikun e Vjetër, Begracën. Kjo është arsyeja që unë nuk e votoj këtë pikë, se këtu vërehen sa ka interesa. Komisioni ka me qenë, një anëtar propozohet prej kryetarit, një anëtar prej partisë në pushtet apo prej koalicionit. Unë këtë pikë të rendit të punës nuk e votoj, pa me dhënë një sqarim pse nuk mbulohen me shërbime fshatrat, Kaçanik i Vjetër, Begracë dhe disa terrene tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Për sqarime të nevojshme, fjalën ia kaloj drejtorit të DSHPE, Arian Teneqja.

z. Arian Teneqja: Pasi përshëndeti pjesëmarrësit e këtij takimi, uroj për dy anëtarët e zgjedhur të KK. Komisioni për KRM “Pastërtia” themelohet në bazë të nenit 5.2 të Ndërmarrjeve publike. Sipas këtij neni, një anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës. Anëtar i emëruar nga Kryetari do të jetë, Ermir Luma. Dy anëtarët tjerë emërohen nga KK, aprovohen me shumicë të thjeshtë të votave.

z. Bashkim Krasniqi: Në emër të PDK, ne propozojmë për anëtarë të komisionit për KRM “Pastërtia”, Fatmir Bunjaku dhe Arton Salihu.

znj. Kadrije Lika Troni: A ka të drejtë një subjekt politik ti jep dy propozime? Sa e di unë, një anëtar ka të drejtë me propozuar kryetari, ndërkaq dy anëtarët tjerë, njërin ka të drejtë pozita, ndërkaq tjetrin, subjektet opozitare.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne i shtrojmë në votim, pastaj e shikojmë a e merr miratimin. Nëse Kadrije është qysh po thoni ju, atëherë na argumentoni se ku po bazoheni.

znj. Ernesta Krasniqi: Unë e di se i keni votat dhe i miratoni, por një komision ku nuk ka të bëjnë me asnjë anëtarë nga subjektet opozitë, nuk dihet se çka ndodhë aty. Raporti duhet me qenë, një anëtar prej kryetarit të komunës, një anëtar nga pozita, një anëtar nga opozita, që të ketë komisioni llojshmëri dhe të kemi raport direkt nga anëtar i opozitës, përndryshe, ky komision në këtë formë, nuk ka arsye të votohet.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju po paragjykoni, se nuk mundeni me ditur a janë pozitë apo opozitë propozimet.

z. Bashkim Krasniqi: Sa i përket propozimeve, meqë qeverisja lokale i takon pozitës, është shumë e natyrshme me përfaqësuar njerëzit që munden me treguar rezultate në KRM “Pastërtia”. Nëse nuk funksionon ky komision, fatura i atribuohet pozitës.

znj. Kadrije Lika Troni: Ne Bashkimit ia aprovojmë një kandidat e jo dy, se dy kandidatë nuk i shkojnë partisë në pushtet. Nuk pajtohem me propozimin e Bashkimit, se është konflikt interesi me i dhënë dy propozime.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë Bashkim jepe propozimin vetëm për një kandidat.

z. Bashkim Krasniqi: Atëherë unë e propozoj për anëtar të komisionit të jetë, Fatmir Bunjaku.

z. Kjani Zeneli: Nga VZHK e propozojmë të jetë anëtar i komisionit, Heset Malsiu. Meqenëse Heseti nuk po pranon me qenë anëtar i komisionit, atëherë e propozojmë të jetë Lejla Luta, anëtare e komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Të nderuar anëtarë të KK, ne shkojmë me propozime veç e veç. Ato që marrin me shumti vota kalojnë. Kush është për votimin që e dha Bashkimi për anëtar të komisionit të jetë, Fatmir Bunjaku.

znj. Kadrije Lika Troni: Propozimet nuk dalin veç e veç, se kjo është shkelje.

Kryesuesi i Kuvendit: Të përfundojmë ne, shkeljet i vërteton tjetër kush. Propozimin për anëtar të komisionit për Fatmir Bunjaku, e shtroj në votim. Rezultati i votimit ishte 11 votë Për. Kundër votë nuk ka, Abstenim nuk ka. 8 anëtarë morën pjesë në votim (6 - LVV, 2 - VZHK). Prezentë 19.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryesues, në momentin që formohet komisioni prej tre anëtarëve, një të drejtë ekskluzive e ka kryetari i komunës. Kryetari e ka sjellë emrin. Ne duhet të shkojmë tani me dy propozimet tjera, e jo me një propozim. Kryetar, a mendoni se kjo formë e zgjedhjes së komisionit është në rregull? Ne nga LVV e propozojmë për anëtar të komisionit, Jeton Luma.

Kryetari i Komunës: Propozimin për një anëtar të komisionit që vjen nga kryetari i komunës, dy anëtarë që propozohen nga KK i thanë partitë politike. Për komitetet obligative, ju e dini që KPF dhe Komiteti për Komunitete janë të caktuar saktësisht përfaqësimi. Ndërkaq të ky komision, nëse ju e dini ndonjë akt që e thotë qysh po thoni ju për përfaqësim, na e shpjegoni, nëse jo, lë të kalojë propozimet qysh u propozuan.

znj. Ernesta Krasniqi: Ku është formuar KPF, a është votuar komplet komiteti? Qysh mundemi me i votuar një nga një. Komisioni nuk është prej 5 anëtarëve, çka nëse kalojnë të pesë anëtarët?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne veç e veç i votojmë anëtarët e komisionit, por krejt nuk kalojnë.

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk është e drejtë anëtarët e komisionit me u votuar një nga një.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju keni të drejtë me menduar ashtu, edhe unë kam të drejtë me menduar se kam të drejtë. Ju nuk po mundeni me na sqaruar pse nuk kemi të drejtë.

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk është kjo fontanë dëshirash, nuk keni të drejtë me votuar një nga një anëtarët e komisionit.

z. Heset Malsiu: Unë e kuptova vetëm një propozim të Bashkimit, ndërkaq propozimin tjetër nuk e kuptuam cili ishte. Nëse ka mundësi me na sqaruar me tepër se cili ishte propozimi i dytë, pasi që Bashkimi i pati dy propozime.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse e keni dëgjuar mirë, ne kemi shkuar me një emër.

z. Heset Malsiu: Nëse Bashkimi e ka propozuar një emër për anëtar të komisionit, një emër po ngelë i zbrazët. Në Propozim Vendim duhet të jepen dy emra dhe të votohen, ndërkaq çështja se a pajtohem apo nuk pajtohem, është diçka tjetër, por jo me mbetur një emër i zbrazët. A jemi duke shkuar me një emër apo me dy emra për anëtarë të komisionit?

Kryesuesi i Kuvendit: Jemi duke shkuar me propozimin e dytë, me një emër. Secila parti lë të jep nga një emër.

znj. Ardita Rrahmani: Ne që jemi këtu në KK, e dëgjuam sqarimin e drejtorit sipas nenit 5.2 të Ndërmarrjeve është publike. Atë ligj mundemi me konsultuar edhe ne. Nuk e di sesi ka funksionuar në praktikë ky komision, por praktika bëhet nga vet ne që jemi këtu. Kryetari i komunës e ka dhënë një emër, subjektet tjera politike, fjala vjen e japin nga një emër. Çështja është se, a duhet 5-6 emrat që propozohen me i hedhur në votim?

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk e di qysh po e lexoni ju këtë çështje.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk është puna qysh po e lexoj unë, por qysh po e thotë ligji. Unë jam juriste dhe nuk mundem me lexuar ndryshe. Nëse donë me i dhënë konotacion ndryshe, ajo është çështje tjetër.

znj. Ernesta Krasniqi: Nuk e di ju qysh tani po i lexoni ligjet. Është pika tjetër se qysh duhet me i lexuar ligjet. Kisha dashur një mendim prej juve në këtë rast.

znj. Ardita Rrahmani: Patjetër. Mos i jepni konotacion qysh doni ti, por qysh shkruan. Merrni Ligjin për ndërmarrje publike, lexoni dhe shikoni se a mund të gjeni diku në ligj apo në ndonjë rregullore që përcakton atë që po thoni ju.

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me propozimin e LVV për Jeton Luma, për anëtar të komisionit.

znj. Kadrije Lika Troni: Pa u shpjegua çështja mirë dhe qartë, ne nuk mundemi me votuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimin e LVV e shtojmë në votim, Vota Për -0, Kundër ishin 11 votë (8 nga PDK, 3 nga LDK), Abstenim nuk ka, Nuk marrin pjesë në votim 8 anëtarë (6 -LVV, 2-VZHK).

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me propozimin e LDK për anëtar të komisionit.

znj. Ardita Rrahmani: Nga LDK e propozojmë Arton Salihu për anëtar të komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e shtoj në votim propozimin e LDK për anëtarin e komisionit. Rezultati i votimit ishte: 11 Për, 8 nuk marrin pjesë në votim (6-LVV, 2 - VZHK). Atëherë, vazhdojmë me propozimin e VZHK, kush është Për?

z. Kijani Zeneli: Ne VZHK e kemi tërhequr propozimin tonë për Lejla Luta.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë Propozimet që kaluan i shtojmë në votim për Aproxim. Rezultati i votimit është, 11 votë Për, Kundër votë nuk ka, nuk marrin pjesë në votim 8 (6-LVV, 2-VZHK). Në bazë të rezultatit të votimit, konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” Sh. A-Njësia në Kaçanik, në përbërje:

1. Ermir Luma, anëtar i propozuar nga Kryetari i Komunës,
2. Fatmir Bunjaku, anëtar i propozuar nga KK,
3. Arton Salihu, anëtar i propozuar nga KK.

Lënda: 01Nr. 60/01-1740/26.

8. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, ne e kemi ridërguar materialin me foto me të dukshme. E hapi diskutimin:

z. Jeton Luma: Shprehi keqardhje për dëmet që iu kanë shkaktuar fermerit, ne si subjekt politik i LVV e mbështetim, por fermeri duhet me u ndihmuar në bazë ligjore. Në raportin që e kemi para vetës, e kemi me ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit: Materiali nuk ka ndryshuar, vetëm fotot kanë ardhur me të dukshme.

z. Jeton Luma: Në shtojcë, raportit i bashkëngjitën fotot e gjedheve të ngordhura me numër të matrikulimit për secilën gjedhë. Në raportin e parë që e kemi pasur, nuk ka ardhur se është e precizuar se gjedhet kanë qenë të mbaruara, kjo bien ndeshë me procesverbalin e inspektorit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës-AUV, që shkruan kështu; Në inspektim u konstatua gjendja faktike, duke u bazuar në kërkesën e datës 12.01.2026, lidhur me një incident të ngordhjes së kafshëve. Nga konstatimet e raportit, shihet se një pjesë e objektit është mbuluar nga rrëshqitja e dheut, ku si rezultat i kësaj, 10 kafshë kanë ngordhur, sipas të dhënave të pronarit Shaip Luta. Gjedhet nuk mund të shihen, sepse janë të mbuluara nga dheu. Urdhëresa vazhdon këtu, “Urdhërohet autoriteti kompetent -komuna e Kaçanikut që të merr të gjitha veprimet e nevojshme për groposjen e kafshëve të ngordhura në afat të menjëhershëm”. Unë i kam disa pyetje: Komisioni komunal i përbërë prej anëtarëve që vijnë direkt nga komuna, aty nuk ka veterinar të kontraktuar prej AUV . Si mundet me dal një konstatim nga një zyrtar i komunës që lopa ka qenë e mbarësuar? Unë jam me mbështetur fermerin, por jo kështu me shkelje flagrante. Në Procesverbalin e AUV thuhet se lopët nuk shihen, se janë të mbuluara me dhe. Me çfarë të drejte ligjore dhe kompetence, një zyrtar i komunës i DUKMM që nuk është as autoriteti as profesionist, konstaton se lopa ka qenë e mbarësuar apo që është e ngordhur? Këtu janë shkeljet të cilat i konsideroj unë. Këtu e keni pa në raport ku thuhet se janë 8 gjedhë lopë të mbarësuar, kjo lënë vend për keqpërdorim. Ne mund të ndihmojmë fermerin, por duhet të gjejmë mekanizma ligjor dhe të drejtë.

z. Arian Teneqja: Lidhur me pyetjen, demet në fermën e Shaip Luta, që kanë ndodhur me datën 10 dhe 11 janar të vitit 2026 kemi marrë thirrjen si drejtori për këtë rast emergjent dhe menjëherë kemi marrë veprimet e nevojshme, janë njoftuar ekipet e emergjencës, policia, njësia zjarrfikës, kemi dalë në vendngjarje. Aty është pa se nga reshjet e shiut, është shembur një pjesë e dheut, ku nën rrënoja të fermës kanë ngelur disa bagëti, të cilat kanë ngordhur. Ne si komunë menjëherë kemi formuar një komision për vlerësim të dëmit, për arsye se nuk kemi fond për kompensimin e dëmeve, mirëpo si ndihmesë e formojmë një komision për vlerësimin e dëmeve, dhe me anë të këtij raporti për kompensimin e dëmeve, ai mund të kërkoj kompensim nga niveli qendror. Në këtë rast siç e keni parë nga fotot dhe vlerësimi, mund të ketë mospërputhje në mes raportit të AUV dhe raportit të komisionit komunal, për arsye se komisioni komunal e ka përcjellë ngjarjen nga fillimi deri të groposja dhe i ka evidentuar një nga një gjedhet, që kanë qenë nën rrënoja dhe disa tjera që janë dëmtuar fizikisht. Se a kanë qenë kafshët e mbarësuar apo jo, ajo pjesë nga deklarata e fermerit, ka qenë e rezervuar, për mëshjtjerrat e mbarësuar dhe këto janë konstatuar gjatë procesit të groposjes, një për një dhe janë evidentuar në

raport. Nuk mendoj që është kriter apo ndikimi i madh, mbarës-imi i gjedhit në raport me vlerën e tërësishme të gjedhit, që po pretendoni për keqpërdorime dhe nuk besoj se ka. Ne si komunë i kemi dalë në ndihmë menjëherë fermerit, qysh është përcaktuar në raport, jemi të obliguar që komisionin të formojmë në kuadër të drejtorisë së emergjencave, përfaqësuesi është nga kjo drejtori, dhe janë ekspert nga drejtoria e bujqësisë që kanë marrë pjesë dhe ekspertë tjerë që kenë qenë pjesë e komisionit. Prandaj, këtu nuk mendoj se ka vend për debat, shpresoj të bëhet kompensimi nga niveli qendror. Ne veç e kemi paraqitur si rast në nivel qendror, se kanë kërkuar fatkeqësitë, mirëpo që ky raport të miratohet dhe t'i bëhet kompensimi nga niveli qendror, duhet të merr miratimin nga KK.

z. Jeton Luma: Në raport nuk është raporti i veterinarit i kontraktuar nga AUV. Ky raport nuk mundet me qenë i plotë, se referencat ligjore nuk e thonë një gjë të tillë. Në ligj thuhet, që inspektori veterinar është zyrtari kompetent që i konstaton kafshët e ngordhura apo të mbarësuar. Nuk ka një dokument që ajo stallë ka qenë për disa lopë që kanë qenë të mbarësuar, së paku unë nuk e kam atë dokument.

z. Arian Teneqja: Siç e potencova, pronari në fjalë sigurisht i ka gjedhet me numra të identifikuar, besoj se ka kontroll të rregullta dhe raporte. Nëse kërkohet një gjë e tillë, besoj se pronari do t'ia plotësoj atë kërkesë komisionit. Sa i përket anëtarëve tjerë të komisionit, ne nuk jemi thirrur dhe nuk mund të vendosim si komision, se nuk jemi duke bërë hulumtim shkencor aty. Ne e kemi kryer pjesën e parë, besoj se dëmi duhet të kompensohet nga niveli qendror.

z. Jeton Luma: Hulumtim drejtor nuk jeni duke bërë, por ky material do të shkojë në MBPZHR. Nëse ky material shkon në ministri, nuk është i plotë, se ka mospërputhje, se nuk është as raporti i AUV. Nëse vjen një raport i detajuar, dërgohet në ministri, besoj se pranohet, ndërkaq kështu siç është, mundësitë janë tepër të mëdha që të kthehet, e kjo i bien veç me shëtitur fermerin atje, këtu dhe me hequr vetën nga përgjegjësia.

z. Arian Teneqja: Raporti shkon në Agjencinë e emergjencave, si raport mendoj se është profesional dhe i kompletuar, me numra të gjedheve, me foto të dëshmuara, është raporti i inspektorit, raporti i njësitit të zjarrfikëseve dhe nuk mendoj se ka nevojë për diskutime me të gjëra.

z. Heset Malsiu: Unë mendoj se nuk ka nevojë me hyrë ne në detaje, se përgjegjësinë e merr komisioni. Ne duhet me votuar këtë raport, shpresoj të ndihmohet blegtori për dëmin që iu ka shkaktuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin. Rezultati i votimit, 13 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarët nga LVV. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë, fermerit Shaip Luta, në shumë 25, 800.00€. / Lënda: 01Nr. 104/02-1705/26.

9. Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht e lexoj Deklaratën Mbështetëse mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike si vijon:

1. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.
2. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.
3. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
4. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjimore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.

Lidhur me këtë pikë, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Ky vendim i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, përbën një hap të rëndësishëm për të dëshmuar qartë se dhuna ndaj grave në politikë dhe jetën publike nuk duhet të ketë vend në shoqërinë tonë. Mbështetja e kësaj deklarate na lidhë drejtpërdrejtë me angazhimet kombëtare dhe rajonale, duke pozicionuar Kaçanikun si një pjesë të një fronti të përbashkët për barazi, dinjitet dhe respekt. Uroj dhe pres që kjo deklaratë të mos mbetet vetëm në letër, por të shndërrohen në veprime konkrete dhe të prekshme që realisht mbrojnë dhe fuqizojnë gratë në jetën publike. Ne si përfaqësues të qytetarëve, kemi obligim të kërkojmë transparencë dhe llogaridhënie, në mënyrë që ky angazhim të prodhojë rezultate reale dhe të dukshme. Institucionet tona lokale janë të obliguara të promovojnë këtë deklaratë, përmes aktiviteteve konkrete, dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim Deklaratën Mbështetëse dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, vendosi të nxjerrë

DEKLARATË MBËSHTETËSE

Mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike/ Lënda: 01Nr. 060/01-1738/26.

10. Propozim Vendimi për Ndryshim dhe Plotësim të Vendimit 01 Nr.060/01-31302/2025 të datës 30.12.2025 për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Korab Krasniqi: Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, iu uroj punë të mbarë anëtarëve të KK. Në vendimin për miratimin e listës së veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, nga MAPL është kthyer në rishqyrtim, ku thuhet se nuk është vendimi në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe është kërkuar që në afat prej 30 ditëve, vendimi të ndryshohet dhe plotësohet në bazë të ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale.

znj. Ernesta Krasniqi: Sa i përket kësaj pike, kam marrë përgjigje të qartë nga ministria. Nuk mundem mos me reaguuar ndaj kolegëve, ku nuk mundeni me dëgjuar diskutimin tim, duke thënë se jam duke zgjatur shumë dhe kërkonin të hedhet sa me shpejt në votim. Është mirë me lexuar materialin e me ditur se çka po votoni, e jo veç qysh t'iu thonë me votuar ose të paktën me lexuar ligjin. Nëse nuk dini me lexuar ligjin, ka jurist që ju lexojnë dhe ua sqarojnë se çka po votoni. Siç e kam cekur edhe unë, kjo listë nuk është në përputhje me ligjin, sepse mungon pika 2 e nenit 13 e Ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim. E kuptoj që nuk ka të bëjë me hapin e dytë kryetar, por pikërisht me të parin. Ajo çka nuk e kuptoj në këtë situatë, edhe pas refuzimit, me një arsyetim shumë të qartë, vazhdoni duke mos përcaktuar pikët që kërkojnë. Ju prapë mendoni të votoni në këtë mënyrë dhe me dërguar në qeveri dhe mandej ankoheni se ka vonesa nga ministria. Normal se ka vonesa kur nuk i përcaktoni kërkesat e plotësimit ndryshimit. Edhe njëherë kërkoj nga ju që kjo listë të përpilohet sipas legjislacionit në fuqi, të caktohet kohëzgjatja e dhënies në shfrytëzim, qëllimi, përndryshe do të kthehet prapë nga ministria.

z. Korab Krasniqi: Ernesta po flet me shumë vetëbesim se do të refuzohet vendimi përsëri nga ministria. Vendimi edhe nëse krahasohet me atë të vitit 2024, kur është votuar me i dhënë në shfrytëzim pronat komunale, i njëjti format është edhe tani, dhe i njëjti organ e ka shqyrtuar, ndërkaq herën e kaluar e ka aprovuar, ndërkaq tani e ka refuzuar. Këtu nuk është diçka në rregull edhe me MAPL. Mendoj përvoja ka ndikuar, se kanë pasur me tepër kohë me lexuar ligjin. Përndryshe, vendimi i KK është kthyer për ndryshim dhe plotësim, konkretisht për mungesë të destinimit të shfrytëzimit siç kërkohet në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. MAPL, duhet me saktësuar se nuk e ka shfuqizuar vendimin, por ka dhënë afat ligjor 30 ditë për me ndryshua dhe plotësuar, d.m.th. bëhet fjalë për mungesë teknike procedurale dhe jo shkelje substanciale apo veprime të paligjshme. Në kohën kur është marrë vendimi, unë nuk kam qenë pjesë, por tani që e kam marrë detyrën, jam i përkushtuar në këtë drejtim, veprojmë në bazë të ligjit në fuqi, për ndryshim plotësimit e vendimit brenda afatit ligjor dhe të siguroj që çdo vendim i KK do të jetë juridikisht i qëndrueshëm dhe transparent. Sa i përket akuzave të juve si opozitë, i konsideroj të pabaza, procedura e kthimit të vendimit për ndryshim plotësimit, është pjesë normale e mbikëqyrjes së ligjshmërisë nga MAPL. Përgjegjësia duhet me u pa në kontekst kohor dhe institucional, komuna është duke vepruar brenda afateve dhe kompetencave ligjore. Qëllimi ynë, nuk është polemika politike, por është respektimi i ligjit, mbrojtja e interesit publik dhe miratimi i vendimeve të qëndrueshme dhe të zbatueshme.

znj. Ernesta Krasniqi: Unë normal se kam shumë vetëbesim se e respektoj ligjin dhe kur të jam drejtë ligjit, me vetëbesim të plotë të kthej përgjigje. Nuk po e kuptoj qysh po thoni se nuk ka ndonjë shkelje ligjore. A mundeni me na treguar arsyetimin pse është kthyer vendimi në rishqyrtim?

z. Korab Krasniqi: Nëse kishte pasur shkelje ligjore, vendimi ishte anuluar, ndërkaq ky vlerësim është për plotësim ndryshim të vendimit.

znj. Ernesta Krasniqi: A mundesh me na sqaruar pse është kthyer vendimi?

z. Korab Krasniqi: Vendimi është kthyer për ndryshim plotësimit, në bazë të pikës 2 të nenit 13 që e potencuat ju, për plotësim me pika shtesë.

znj. Ernesta Krasniqi: Ju nuk keni qenë në mbledhjen e kaluar, por po besoj se e keni lexuar materialin. Në si grup i LVV kemi kërkuar që në pikën 2 të nenit 13, të përcaktohen

të dhënat kadastrale, qëllimin, destinimin, datën e publikimit, njoftimin dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Kjo është arsyeja pse është kthyer vendimi.

z. Betim Shala: Zakonisht të gjitha vendimet të cilat shqyrtohen apo atakohen prej palëve, në ministri, ministria i kthen në tre variante: E anulon vendimin, e kthen në rishqyrtim për ndryshim dhe harmonizim apo e aprovon vendimin. Në këtë rast nuk e ka aprovuar vendimin, as e ka anuluar, por e ka kthyer për plotësim ndryshim. Unë mendoj se nuk ka pasur ndonjë shkelje ligjore në këtë pjesë. Sa i përket pjesës me caktuar deastinimin, destinimi i tyre është zona industriale, por nuk mundesh me caktuar destinimin, se nuk mundemi me thënë se këtu kemi me hapur një fabrikë fjala vjen të gomave, se pastaj na vjen investitori për me prodhuar diçka tjetër dhe nuk mundemi me dhënë për atë destinim. Destinimi i tyre është industriale, kohëzgjatja është sipas ligjit. Ne nuk mundemi me shkruar se një pronë jepet për 99 vjet, se nëse kemi pastaj një investitor serioz për 45 vjet, nuk mundemi me ia dhënë atë pronë në shfrytëzim. Sa përket pjesës që e ka kthyer ministria, ju po e paraqitni si me pasur shkelje ligjore.

znj. Ernesta Krasniqi: Unë po kërkoj plotësim ndryshimin e pikës 2 të nenit 13, qysh ka kërkuar ministria. A është bërë plotësimi i pikës 2, pyetja ime është për drejtorin?

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori e dha sqarimin njëherë.

znj. Ernesta Krasniqi: Jo, drejtori nuk na ka sqaruar.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryesues, unë pajtohem me Ernestën se ju pavarësisht se keni bërë ndryshime, nuk e keni ndryshuar periudhën kohore, e cila luan një rol të rëndësishëm, me çka ua lehtëson edhe investitorëve të cilët duan me ardhur dhe i shohin parcelat se për çfarë afati janë duke u dhënë. Nëse përfshihet edhe periudha kohore, mendoj se kishte me qenë e kompletuar ky plotësim ndryshim.

z. Islam Gashi: Në mbledhjen e kaluar i kemi pasur dy pikë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Pika 9 ishte për dhënien në shfrytëzim të lokaleve, është caktuar afati kohor 1-15 vite. Kjo pikë nuk është kthyer nga MAPL, ndërkaq pika 7 që ka pasur të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, nuk e ka pasur afatin kohor, dhe e njëjta është kthyer. Shtrohet pyetje, pse njëri vendim është kthyer në rishqyrtim, ndërkaq vendimi tjetër nuk është kthyer?

znj. Ardita Rrahmani: Po ndërlidhem me kolegun, për me i kontribuar debatit dhe secili nga ne është mirë me i kontribuar debatit. Të pikat që i përmendi kolegu, dy pika të mbledhjes së kaluar, pika 7 dhe pika 9, të cilat janë të kundërta me njëra tjetrën, se ti mundesh me dhënë një lokal për një vit, fjala vjen për rrobaqepësi, por nuk mundesh me dhënë pronën për një fabrikë për 99 vite, se nuk e dinë sesa ka me punuar ajo. Tani pronat që epën, vjen dikush me kërkuar një pronë në komunë, fjala vjen për një fabrikë të përpunimit të ujit. Nëse ne e destinojmë për 99 vjet pronën, e fabrika donë me marrë për 30 vite, a jemi në gjendje me humbur atë investitor? Se atëherë ne duhet me prituri edhe një vit deri në fund të dhjetorit, për me mundur me e ndërruar afatin për sa vite po donë me dhënë atë pronë. A jeni të vetëdijshëm se mundeni me refuzuar një investitor, ndërkaq në anën tjetër dihet sesa ka kjo komunë nevojë për investime? Ju jeni për investitorë, ndërkaq kur vjen puna me diskutuar këtu, gjeni ankesa. Prej praktikës se kaluar, çdo herë kur janë diskutuar çështjet e pronave, keni votuar kundër. Kësaj here, jepni justifikime se cilat prona me i dhënë për 40 vjet, cilat 99 vjet etj. Nëse nuk është i ligjshme ky vendim, atëherë MAPL, na e kthen.

z. Islam Gashi: Ligji thotë se duhet me pasur destinimin dhe periudhën e caktuar, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale. Për atë e ka kthyer ministria, kështu ajo pjesë duhet të plotësohet. Nëse për lokalet po thuhet se është ndryshe, ne nuk e dimë nëse një biznes a ka me qëndruar 15 vite, se ndoshta falimenton në vitin e parë.

znj. Ardita Rrahmani: Tjetër është 15 vite, tjetër është 40 dhe 99 vite. Lokalet janë me metra katror, që cilido zëjtari mundet me vepruar aty, ndërkaq fabrika nuk është veprimtari zëjtari.

z. Islam Gashi: Ardita, nuk është me rëndësi ne a kemi votuar Për apo Kundër. Të dy pikat i kanë pasur numrat e mjaftueshëm me kaluar. Atëherë, mundeni të aprovoni edhe këtë Propozim Vendim kështu siç është propozuar, mirëpo mundet t' na kthen ministria.

znj. Ernesta Krasniqi: Ne jemi duke bërë një pikëpyetje mbi ligjin, se ligji e ka keq, se ligji nuk duhet me kërkuar përcaktimin e kohës së dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, se ne së pari duhet me menduar për kohën- për sa vite me dhënë në shfrytëzim. Ardita me juve e kam si juriste, A po e kërkon ligji kohën e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale? Ne si grup i LVV po e kërkojmë të përcaktohet kohëzgjatja e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Afati ligjor i dhënies në shfrytëzim i pronave komunale është 15-99 vjet. Ne kemi punuar ne komisione dhe dimë afatet e dhënies në shfrytëzim sa janë. Ne kemi me bërë një komision këtu në KK dhe përcaktohen afatet kohore për sa vjet me u dhënë në shfrytëzim. Ne po e dërgojmë këtë vendim në ministri si plotësim ndryshim, nëse nuk është në rregull, atëherë na e kthen ministria.

z. Hestet Malsiu: Ne si Vizion për Zhvillimin e Kaçanikut, në parim e përkrahim dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, ndërkaq problemet tjera ligjore që i keni, merruni ju me to.

z. Betim Shala: Po jap një përgjigje në pyetjen e cila iu adresuar Ardites, edhe pse Ardita është shefe e grupit. Lista që është bërë, kur të jepet një pronë në shfrytëzim, normal se caktohen afatet kohore. Kjo është një listë e pronave komunale që munden me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2026, e që munden me aplikuar investitorët e interesuar.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryesues, a bënë drejtori me na shpjeguar se atë që ka kërkuar MAPL, a është plotësuar dhe a ka mangësi në plotësim që është bërë ndryshimin, e mos të debatojmë këtu?

Kryesuesi i Kuvendit: Kadrije, drejtori ju shpjegoj, ne nuk mundemi këtu me ju përsëritë disa herë.

znj. Kadrije Lika Troni: Jo nuk e kemi të qartë.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka kush diçka tjetër me diskutuar?

znj. Ernesta Krasniqi: Ju po thoni pasi të formohet komisioni, ne me caktuar afatin kohor. Ne momentin që një ofertues e mendon një plan për biznesin që donë me hapur, i shikon pronat, qëllimin, destinimin dhe kohëzgjatjen. Nuk mundet me aplikuar dikush me marrë pronë komunale në shfrytëzim, pa i pasur çështjet e qarta. Në momentin që i ka çështjet e qarta, ofertuesi e përpilon planin në mënyrë të detajuar. Kur të jenë gjërat e qarta, na vinë ofertues me serioz, e jo siç kemi pasur me herët, se ne e dimë qysh kanë

përfunduar disa nga ofertues të mëhershëm, si “Betonjerka”, se nuk kanë pasur kurrfarë kriteri. Duhet me i pasur gjërat e qarta ofertuesit se për çka po ofertojnë, cili është qëllimi, vitet e dhënies në shfrytëzim, etj.

z. Betim Shala: Kuvendi i komunës mundet me ia dhënë dikujt një tokë në shfrytëzim, ndërkaq ju Ernesta nuk mundeni me paragjykuar se a ka me qenë serioz apo jo. Mos u ndërlidhë me Betonjerka, çështjen e saj e dimë nga fillimi qysh është nisur, nuk ka mundur me përfunduar projektin dhe iu ka marrë prona. Ka pasur raste kur operatorët ekonomik kanë për formuar mirë, si e kemi një operatorë ekonomik në Begracë, pastaj një në Doganaj. Me menduar me paragjykime, nuk kishim mundur me dhënë asnjë pronë në shfrytëzim. Të vitet që po thirreni ju, komuna e publikon listën se cilat prona kanë me u dhënë në shfrytëzim në këtë vit, ndërkaq nuk mundemi me ia caktuar dikujt një pronë që me thënë se kjo pronë ka me u dhënë për 30 vjet, se mundet një interesuar me marrë për 99 vjet, atëherë ajo pronë mbetet me u planifikuar me u dhënë në shfrytëzim për vitin vijues. Kush jemi ne me ia përcaktuar një prone kohën e dhënies në shfrytëzim, as ne as ekzekutivi, se atë e cakton investitori që donë me investuar, pastaj komuna vendosë se a ia jep në shfrytëzim apo jo atë pronë investitorit.

Kryetari i Komunës: Meqë u shterë debati në këtë temë, realisht u kërkua me u dhënë destinimi. Destinimi i pronave është në prodhuese, përpunuese, shërbyese, rekreacion dhe turizëm. Ne e dimë krejt se ligji ka ndryshuar për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Me herët ka qenë dhënia në shfrytëzim në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ndërkaq tanë janë në afatshkurtër 1-15 dhe në afatgjatë, 15-99 vjet. Nëse kërkohet që ne duhet me përcaktuar afatin e dhënies në shfrytëzim, afatshkurtër apo afatgjatë, atëherë ia shtojmë Propozim Vendimit afatin kohor, në afatshkurtër 1-15 vjet dhe në afatgjatë, 15-99 vjet, në mënyrë që pronat të jepen në të ardhmen, varësisht qysh e kërkojnë investitorët.

z. Korab Krasniqi: Po kryetar, mundemi me plotësuar pikën e Propozim Vendimit, me precizuar dhënien në shfrytëzim në afatshkurtër 1-15 vjet dhe në afatgjatë, 15-99 vjet, ndryshe nuk e jep as ligji, mundem me cituar edhe ligjin, është ligji 06/L-092.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë mendoj që parcelat që dalin në faqe të komunës, duhet me qenë të grupuara se cilat epën 1-15 vite dhe cilat jepen 15-99, kjo është periudha kohore, për atë edhe është kthyer, se ligji po e kërkon kështu., dhe me iu lehtësuar edhe investitorëve për me ardhur, se nëse ne e potencojmë periudhën prej 15-99 vjet, atëherë po i vjen se krejt parcelat jepen për atë periudhë kohore.

Kryetari i Komunës: Nëse me kuptove drejt Kadrije, u thashë me shtuar pasuesin e dhënies në shfrytëzim, në afatshkurtër 1-15 vjet dhe në afatgjatë kohor 15-99 vjet. Nëse vjen një ofertues për 15 vjet, e kemi me vendim dhe mundemi me ia dhënë në shfrytëzim pronën. Nëse kemi ofertues për 99 vjet, kemi me formuar komision për me vlerësuar se a kemi kompani serioze apo jo, se nuk kemi prona si komunë veç me i dhënë ashtu, se është dëshmuar se kompanitë që nuk janë serioze, ju merret prona. Këtë lë ta dimë krejt qytetarët e komunës së Kaçanikut dhe kushdo që vjen me investuar në komunën e Kaçanikut, se ne nuk bëjmë hajgare me pronat e komunës. Kushdo që është i interesuar me marrë një pronë të komunës në shfrytëzim dhe nuk e shfrytëzon për destinimin e caktuar, KK ka me ia marrë atë pronë. Unë nuk jam jurist, por për me u plotësuar afati

kohor, unë themi ti shtohet afati kohor i dhënies në shfrytëzim në afatshkurtër 1-15 vite dhe në afatgjatë 15-99 vite.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë përsëri nuk e kam të qartë kryetar, se ju po thoni me përcaktuar afatin 1-15 dhe 15-99 vite, pa i cekur se për cilat pronat. Drejtori i ka zyrtarët e saj në drejtorinë dhe ata e kanë atë punë, e dinë se cilat pjesë të pronave epën për industri, cilat epën për bujqësi, se ju i ndani parcelat për destinim dhe për vite, për me ia lehtësuar investitorit. Nëse investitori ka një projekt madhor dhe nëse hynë në faqe të komunës, duhet me i ditur cila pronë epët për 99 vjet, për me qenë me e lehtë për të. Investitori që marrin toka në shfrytëzim, të jenë serioz dhe në bazë të dhënave dhe nëse e kanë afatin e përcaktuar kohor pronat, ata e kanë me të lehtë me u përcaktuar për pronën. Ndërkaq, ne kemi me pasur komision që vlerëson pronat dhe kemi me i pasur në monitorim se a janë duke iu përmbajtur planit ideor. A jemi në kohë kryetar, drejtor, se ky plotësim ndryshim është dashur me u krye në dhjetor? Nëse kthehet prapë ky vendim, a jemi në kohë për me realizuar?

z. Korab Krasniqi: Vendimi nuk është kërkuar me u shfuqizuar, por me u ndryshuar dhe plotësuar, kështu që jemi në kohë në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës: E njoftoj KK se është zgjatur afati për publikim të listës së pronave komunale që epën në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë me këto ndryshime që u propozuan t'i shtohen Propozim Vendimit, Pronat komunale të cilat epën në shfrytëzim në vitin 2026, epën për afatshkurtër 1-15 vite dhe në afatgjatë 15-99 vite, e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 13 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarët nga LVV. Prezentë 19. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Ndryshim dhe Plotësim të Vendimit 01 Nr.060/01-31302/2025 të datës 30.12.2025 për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026.

Vendimi që plotësohet dhe ndryshohet, i shtohet pasuesi si vijon: **Të gjitha pronat të cilat janë të përshkruar sipas Zonave Kadastrale, Jepen në shfrytëzim në periudhë Afatshkurtër 1-15 vite dhe në periudhë Afatgjatë 15-99 vite, për Veprimtaritë: prodhuese, përpunuese, shërbyese, rekreacion dhe turizëm. /Lënda 01 Nr. 01-Nr.060/01-1743/26.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatohet mbledhjen e përfunduar në ora 12:32. Deri në fund të mbledhjes ishin 19 anëtarët -të gjithë që ishin pjesëmarrës në këtë mbledhje.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 13.02.2026	Vendi Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
	01-104/02-	4152/26



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik
Zyra e Kryetarit



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2025



Kaçanik, Shkurt 2026

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit.....	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	3
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	10
Drejtoria e Arsimit.....	23
Drejtoria e Buxhetit dhe Financave	31
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	36
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	48
Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	60
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	62
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	70
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	74
Zyra e Prokurimit	77
Zyra Ligjore	81
Zyra e Inspektoratit.....	83
Zyra e Teknologjisë Informative dhe Zyra e Informimit.....	91
Zyra për Komunitete dhe Kthim.....	93
Zyra për Barazi Gjinore.....	94
Zyra për Integrime Evropiane.....	96
Zyra e Kuvendit Komunal	99

Fjala e Kryetarit

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

Të dashur qytetarë,

Duke u mbështetur në kornizën ligjore për nivelin lokal, si dhe në të drejtat dhe përgjegjësitë që burojnë nga kjo kornizë, po ju paraqesim Raportin Vjetor të Punës së Ekzekutivit për vitin 2025.

Ky raport përmbledh angazhimin, përkushtimin dhe punët konkrete të realizuara nga ekzekutivi komunal në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Për periudhën për të cilën po raportojmë janë realizuar projekte të ndryshme, si projekte infrastrukturore, investime në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, mbështetje në kulturë, rini dhe sport, mbështetje në bujqësi dhe biznese lokale, si dhe rritje e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve administrative, etj.

Po ashtu, komuna jonë është renditur ndër komunat e para më transparente dhe llogaridhënëse, sipas organizatave që masin transparencën komunale.

Për arritjen e rezultateve konkrete, Komuna e Kaçanikut ka bashkëpunuar ngushtë me akterë lokalë, qendrorë dhe ndërkombëtarë.

Natyrisht, të pranishme kanë qenë edhe sfidat, por ato na kanë motivuar të punojmë me më shumë përgjegjësi, profesionalizëm dhe vizion afatgjatë.

Si përfundim, ju siguroj se do të vazhdojmë të punojmë për një komunë moderne, funksionale dhe gjithëpërfshirëse.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Në kuadër të raportit vjetor, Drejtoria për Administratë gjatë periudhës raportuese ka realizuar detyrat dhe obligimet e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kaçanikut, si dhe me ligjet e tjera përkatëse, udhëzimet administrative, urdhëresat dhe rregulloret komunale, duke kontribuar në funksionimin efikas dhe transparent të administratës komunale.

Administrata komunale synon rritjen e efikasitetit dhe cilësisë në veprimtarinë e saj, duke ofruar shërbime publike të qasshme dhe të orientuara ndaj nevojave të qytetarëve, përmes procedurave të standardizuara dhe menaxhimit efektiv të burimeve. Veprimtaria e saj bazohet gjithashtu në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit, duke garantuar funksionim të përgjegjshëm dhe besueshmëri institucionale ndaj qytetarëve.

Veprimtaria e Drejtorisë së Administratës bazohet në parimet e efikasitetit, performancës dhe transparencës, të cilat janë zbatuar përmes investimeve të vazhdueshme në digjitalizim, infrastrukturë dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale. Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë njëvjeçare të drejtorisë dhe sektorëve të saj, duke ofruar pasqyrë të qartë mbi rezultatet dhe angazhimet e realizuara.

Përgjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka inicuar kërkesa të ndryshme për zhvillimin dhe arritjen e objektivave të drejtorisë si në vijim:

1. Kërkesa për mirëmbajtjen e GPS-ve në veturat e administratës komunale.
2. Kërkesa për shërbime të byfes.
3. Kërkesa për shërbime të sigurimit fizik të objekteve të administratës komunale.
4. Kërkesa për furnizim me material higjenik për objektin e administratës komunale.
5. Kërkesa për furnizim me pajisje teknologjike për zyrtaret.
6. Kërkesa për furnizim me material për zyre.
7. Kërkesa për regjistrim dhe sigurim të veturave zyrtare të administratës komunale.
8. Kërkesa për mirëmbajtje dhe servisim të veturave zyrtare të administratës komunale.
9. Kërkesa për mirëmbajtje të objektit të administratës komunale.

Gjithashtu gjatë vitit të kaluar kemi filluar realizimin e projektit “Rregullimi i sistemit të nxemjes qendrore të objektit të administratës komunale”, ky projekt është projekt 2 (dy) vjeçar.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kujdesur edhe për pranimin dhe procesimin e të gjitha faturave të institucionit po ashtu edhe për sistemin e E-Pasurisë dhe përditësimin e të dhënave në këtë sistem.

Është kujdesur edhe për Kutinë e Ankesave, hapjen e saj dhe raportimin e rregullt nga Komisioni për hapjen e kutisë së ankesave.

Përmes zyrtares për përkthime janë përkthyer të gjitha dokumentet e kërkuara në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare të Kosovës.

Gjithashtu, është realizuar publikimi i shpalljeve në tabelën fizike dhe atë elektronike, si dhe është menaxhuar pranimi dhe shpërndarja e postës zyrtare, në përputhje me procedurat institucionale dhe kërkesat ligjore.

Në muajin dhjetor, komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare të komunës ka bërë inventarizimin dhe më pas ka filluar me raportin final.

Qendra Komunale për Shërbime me Qytetarët

Gjatë periudhës raportuese, Sektori i Qendrës për Shërbime me Qytetarët ka luajtur rol kyç në ofrimin e shërbimeve publike, duke garantuar qasje të drejtpërdrejtë dhe të standardizuar për qytetarët. Ky sektor ka menaxhuar procedurat administrative në përputhje me ligjin dhe ka kontribuar në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Përmes përdorimit të mjeteve teknologjike dhe optimizimit të proceseve, qendra ka përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve dhe ka siguruar funksionim të rregullt dhe efektiv të institucionit.

Gjatë vitit 2025 në sektorin e Shërbimit me Qytetar janë pranuar, procesuar dhe përfunduar 32,138 lëndë.

Në vijim paraqitet tabela e detajuar.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

01/01/2025 - 31/12/2025

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DAP	Drejtoria e Administrates se Pergjithshme	47	203	2,200	5	0	0	0	4	16,239	18,698
DA	Drejtoria e Arsimit	12	82	1,733	16	1	24	2	16	0	1,886
DBZHRP	Drejtoria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Pylltarise	0	6	517	218	0	0	0	4	0	745
DBF	Drejtoria e Buqetimit dhe Financave	0	658	598	0	0	0	0	3	0	1,259
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0	70	483	56	0	0	0	2	0	611
DESHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	6	12	517	33	0	21	1	6	0	596
DUKMM	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	29	2,540	2,732	17	2	36	0	14	0	5,370
SHK	Shërbimi i Kryetarit	28	862	1,554	334	1	0	3	6	0	2,788
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2	117	2	0	0	0	0	0	0	121
DZHET	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	0	1	38	25	0	0	0	0	0	64
		124	4,551	10,374	704	4	81	6	55	16,239	32,138

10/02/2026

1/1

Tabela 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01/01/2025 – 31/12/2025.

Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Sektori i Gjendjes Civile gjatë vitit 2025 ka ofruar të gjitha shërbimet në përputhje me autorizimet ligjore, duke garantuar trajtim të shpejtë dhe efikas për qytetarët, si në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1.	Ekstrakte të Lindjes	12305
2.	Certifikata të Lindjes	4594
3.	Certifikata e Martesës	2950
4.	Certifikata e Vdekjes	1082
5.	Certifikata e Gjendjes Martesore	508
6.	Deklarata Familjare	2420
7.	Certifikata e Vendbanimit	1822
8.	Certifikata e Shtetësisë	121
9.	Vërtetime të Arkivit	520
10.	Dëshmi Vdekje	198
		Gjithsej: 26520

Tabela 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2025-31/12/2025.

Përshkrimi	Sasia
Regjistrime të Lindjes të Rregullta	2
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	360
Shpallje të martesave	236
Kurorëzime	236
Kurorëzime speciale	97
Regjistrime të vdekjes të rregullta	115
Regjistrime të vdekjes speciale	25
Lëndë të kompletuara për fitim dhe rifitim të shtetësisë së RKS	163
Lëndë të kompletuara për tërheqje të shtetësisë së RKS	3
Vendime të ndryshme	109
Aktvendime për ndryshime, korrigjime në RTHL,RTHM, Regjistrime të mëvonshme në RTHL,RTHV, Refuzime të kërkesave	85
Verifikime nga Ambasada e RKS në shtete të jashtme dhe departamentet e pensioneve, Gjykatat dhe Policia rreth dokumentacionit për shtetasit e Komunës :	
Kërkesa për verifikime	210
Kërkesa të verifikuara	210

Tabela 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01/01/2025-31/12/2025.

- Në kuadër të punës të ZKGJC, janë përgatitur statistikat mujore për lindje, martesë dhe vdekje të rregullta dhe jashtë vendit janë dërguar në kohë në Agjensionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësime janë dërguar me kohë në ARC.
- Lëndët në Intranet të vitit 2025 janë miratuar me kohë për përmirësime nga zyrtarët e Gjendjes Civile dhe shkresat nga Departamenti i Pensioneve, Konsullatat e Republikës së Kosovës në shtete të ndryshme, Gjykatat, Policia si dhe nga MPB/ARC janë kryer dhe përcjellë me kohë.
- Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre.
- Jemi kujdesur për funksionimin e rregullt të e-kioskut dhe furnizimin me kohë me certifikata.
- Gjithashtu janë realizuar vizita herë pas here edhe në zyret e gjendjes civile, të cilat operojnë në terrenin e komunës sonë.

Arkivi

1.PUNË NË ZYRE

Gjatë vitit 2025, Sektori i Arkivit ka punuar dhe është angazhuar me punimin, rregullimin, klasifikimin, sistemimin, regjistrimin e lëndëve arkivore, duke krijuar data bazën e dokumentacione me vlerë të përhershme dhe me afate të tjera.

Sektori i Arkivit ka bërë pranimin e lëndëve të ndryshme nga ish-BVI në Kaçanik, në lidhje me pronën, veprimtaritë zejtare etj.

Po ashtu është bërë pranimi i lëndëve të dorëzuara nga ish-drejtori i Gjimnazit "Skënderbeu" në Kaçanik, të periudhës për vitet 1992,1993,1995,1996.

Është bërë pranimi i lëndëve të dorëzuara nga Zyra e Personelit, për listat e pagave mujore të vitit 2023.

Gjithashtu janë pranuar materiale të Kuvendit të legjislaturës nga viti 2018 deri në vitin 2021.

2.PUNË NË DEPO

-Hulumtimi për gjetjen e lëndëve arkivore sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve, bartja e lëndëve nga depo për t'i shërbyer palëve si dhe për t'i punuar në zyrë dhe anasjelltas duke i vendosur në vendin përkatës.

3. KËRKESA INTERNE - Zyrtarët e Drejtorive të Komunës kanë parashtruar dyqind e katër dhjetë (240) kërkesa gojore për gjetjen e lëndëve arkivore dhe projekteve, të njëjtat janë kthyer në vendin përkatës.

Janë parashtruar dy (2) kërkesa nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Divizioni i Pensioneve të Jashtme për verifikimin e vërtetimeve të lëshuara nga Sektori i Arkivit Komunal.

4. KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA PALËT – Njëqind e njëzet e dy (122) kërkesa, katërdhjetë e tre (43) për stazh pune, shtatë (7) për vërtetim dhe konfirmim dokumenti.

Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale konform Ligjit për Arkivat dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mirëmbajtja e objektit dhe Autoparku

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, nëpërmjet sektorit teknik, është përkujdesur për higjienën, pastërtinë e objektit të administratës komunale, mirëmbajtjen e nxemjes, mirëmbajtjen e aseteve etj.

Veturat zyrtare kanë qenë në gjendje të rregullt të regjistruara, servisuara dhe furnizuara me derivate, si dhe në dispozicion për të gjithë zyrtarët publik përgjatë vitit për të cilin raportojmë.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

RAPORTI VJETOR PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025

Ky është raport përmblledhës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i cili ka për qëllim raportimin te kryetari i komunës lidhur me ecurinë e punëve të kësaj drejtorie , si dhe informimin e qytetarëve të komunës së Kaçanikut për mbarëvajtjen e punëve të DSHMS-së , për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare punon 24 orë, që nënkupton se stafi shëndetësor punojnë në tre ndërrime gjatë javës dhe të shtunave e të dielave. Stafi i QKMF-së kujdesen për shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve të komunës sonë.

Në QKMF funksionojnë Këshilli Drejtues i QKMF-së dhe Këshilli Profesional të cilët janë në përbërje nga stafi shëndetësorë, kryesuar nga Drejtori i QKMF-së. Këto Këshilla mbajnë takime të rregullta në çdo muaj, në të cilat diskutohen çështje të ndryshme profesionale si dhe çështje organizative për funksionim të mirë të punës së QKMF-së.

Në QKMF funksionon edhe klasa për nëna dhe fëmijë, e cila mbanë ligjërata rregullisht për të gjitha grat e interesuara. Kontribut të madh në këto ligjërata japin specialistja e gjinekologjisë dhe specialistja e pediatriisë.

Gjithashtu edhe vizita shtëpiake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit, si dhe te të sëmurët e palëvizshëm ,si dhe vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë vitit 2025.

QKMF është furnizuar me insulinë, si dhe me terapi tabletare për sëmundjen e sheqerit, për hipertension, për yndyrë. Po ashtu edhe me material shpenzues mjekësor jemi të furnizuar. Po ashtu jemi furnizuar me barna edhe nga komuna . Furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë më i mirë se në vitin 2024.

Edhe gjatë këtij viti në QKMF janë kryer të gjitha shërbimet shëndetësore siç janë:

1.Mjekësia familjare	79,739	kontrolla mjekësore
2.Urgjenca	31,089	kontrolla mjekësore
3.Stomatologjia	1,505	kontrolla mjekësore
4.Pediatra	4,312	kontrolla mjekësore
5.Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç	1,886	
6.Vaksinimi	6812	
7.Laboratori	15,008	
8.Rëntgeni	5,246	
9.Terreni	3,475	
10.Shërbimet infermierike –QKMF ,QMF dhe AMF.....	115,671	
11.Gjinekologjia	1575	
12.Pulmologjia	1802	
13.Radiologjia	386	
14.Klasa për nëna dhe fëmijë	250	
15. Mamografia	101	
TOTALI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR VITIN 2025 - 268,857		

AKTIVITETET NË QKMF GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, janë mbajtur takimet e rregullta mujore të Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues, me ç' rast janë diskutuar çështje të ndryshme profesionale, si dhe çështje të tjera organizative që ka të bëjë me funksionimin më të mirë të punës në QKMF.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë më i mirë se në vitin 2024. Vlen të theksohet se Komuna e Kaçanikut e ka kontraktuar një kompani e cila e ka furnizuar me barna dhe material shpenzues mjekësor QKMF-në, me disa lloje të barnave të cilat nuk furnizohemi nga Ministria e Shëndetësisë.

Poashtu edhe barnatoret e kanë mbajtur me rregull kujdestarinë gjatë natës, të caktuar nga DSHMS-ja.

Gjatë vitit 2025 kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të Edukimit të vazhdueshëm profesional me mbajtjen e ligjëratave në QKMF nga ana e mjekëve dhe infermierëve të QKMF-së, si dhe mjekëve jashtë institucionit tonë.

Gjatë muajit janar kemi pasur fluks të madh të pacientëve, si rezultat i virozave të dimrit.

Prej dates 08.01.2025 kemi filluar me zbatimin e çmimoreve të re të bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore në Kujdesin Primar Shëndetësor sipas UA 03/2024, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Me datën 14.01.2025 kemi pritur ekspertin për mbrojtje nga rrezatimi Prof.Dr.Fadil Hasani,ku në cilësinë ekspertit do të vlerësojë gjendjen e njësive të rëntgenit,kushtet që i ofron,si dhe përgaditjen e dokumentacionit për licencimin e aparatit të rëntgenit dhe mamografit.Licencimi është i domosdoshëm,pasi në të kundërtën dënimi është 8.000 € për institucionin.

Nga muaji shkurt 2025 pritet të fillojë vaksinimi kundër Human Papilloma Virusit (HPV) edhe te gjinia mashkullore nga mosha 12 vjeçare parashikohet të bëhet edhe një fushatë sensibilizuese për këtë qëllim nga ekipet tona mjekësore .

Me datën 29 janar 2025 i kemi pasur në inspektim Inspektoratin Farmaceutik nga Ministria e Shëndetësisë.Ata kishin ardhur për të inspektuar depon e barnave dhe për të parë nga afër se sa respektohen procedurat e përshkrimit të recetave mjekësore sipas ligjit dhe si paraqitet gjendja e stokut farmaceutik në depon e barnave.

Gjatë muajit janar kanë vazhduar punimet në ndërtimin e garazhave, punimet janë duke shkuar nga përfundimi i fazës së parë.

Me 13.02.2025 është bërë inagurimi i aparatit të mamografisë në QKMF-Kaçanik.Në ceremoninë e inagurimit ka marrë pjesë Nënkrjetari i Komunës, Sabedin Vishi, Drejtori i Islamic Relief, Dr.Mohamed Salimon, Drejtori i DSHMS-së, Sali Malsiu dhe Drejtori i QKMF-së së bashku me stafin shëndetësor. Vlen të theksohet se projekti është realizuar në bashkëfinancim në mes Komunës së Kaçanikut dhe Islamic Relief dhe ka kushtuar mbi 100.000€.

Me datën 25.02.2025 i kemi pasur në inspektim Inspektoratin Shëndetësor.Ata kishin ardhë për të parë nga afër zbatimin e ligjit për duhanin. Ata në shoqërim me Drejtorin e QKMF-së bënë inspektimin në QMF-Gllloboçicë dhe AMF-Begracë. Inspektorët shëndetësor u ndanë të kënaqur me respektimin e ligjit për duhanin në këto 2 punkte shëndetësore dhe kërkuan që të vazhdohet me respektimin e ligjit,për duhanin .

Gjatë muajit mars 2025 janë krijuar trupat e ri të QKMF-së, sipas statutit të ri të QKMF-së, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut.

Me datën 02 prill 2025, organizuar nga Agjensia për informim dhe privatësi është mbajtur punëtorja 1 ditore me temën "Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin shëndetësor" e cila punëtori është mbajtur në Gjilan dhe nga QKMF-ja kanë marrë pjesë 2 mjeke dhe 2 infermiere.

Me datën 04.04.2025 organizuar nga AQH-ja është mbajtur trajnimi final për infermiere, që ka të bëjë me dhomën e edukimit dhe promovimit shëndetësor për sëmundjet kronike jo-ngjitese kronike. Me datën 15.04.2025 është funksionalizuar Dhoma për Edukim dhe Promovim shëndetësor për sëmundjet kronike jo-ngjitese (diabeti mellitus tip 2, hypertension arterial dhe asthma bronkiale). Me datën 16.04.2025 kemi pritur në takim përfaqësuesit nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik nga Ferizaj në krye me Dr. Hidajete Halimi dhe Sherif Topalli-infermier. Ata kishin ardhur për të diskutuar për raportimin e sëmundjeve ngjitese nga QKMF-ja, por gjatë inspektimit vërejtëm se kemi të bëjmë me defekt në rrjetin qeveritar dhe se e kemi të pamundur të raportojmë nga QKMF-ja dhe presim që kjo çështje të rregullohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Me datën 17 prill 2025, ka vazhduar aktiviteti në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, ku ligjerues ka qenë Dr. Nuhi Baftiu me temën “ASTMA BRONKIALE”

Me datën 25.04.2025 është mbajtur takimi i parë i ekipit të kujdestarisë për antibiotikët në QKMF, ekip i cili është formuar me vendim të Drejtorit të QKMF-së, ku dhe janë dhënë detyra anëtarëve të ekipit si p.sh. auditi klinik për përshkrimin e antibiotikëve, si dhe detyra të tjera të parapara me përgjegjësitë e këtij grupi në kuadër të projektit QKMF-IKSHPK-ICARS.

Me datën 29.04.2025 kemi pritur përfaqësuesit e CARITAS-it nga Luksemburgu. Ata kanë investuar dhe mbikëqyrur punimet e objektit të ri të QKMF-se në vitin 2015 dhe 2016 dhe kishin ardhur për të parë nga afër se si është gjendja e objektit të QKMF-se. Ata u ndanë të kënaqur me mirëmbajtjen e objektit dhe pastërtinë, si dhe përgëzuan Komunen e Kaçanikut për investimet e qelluara në QKMF.

Me datën 7 maj 2025 është mbajtur trajnimi për përdorimin optimal të antibiotikëve në KPSH, ligjeratë për mjekët. Ligjeratë është mbajtur në QKMF dhe ligjerues kanë qenë Prof. Dr. Lul Raka dhe Dr. Jehona Krasniqi.

Me datën 12 maj 2025 është shënuar Dita ndërkombëtare e infermierisë, me ç'rast një ekip mjekësor ka qëndruar për disa orë të sheshi “Ismajl Raka” dhe kanë ofruar shërbime shëndetësore falas për qytetarët tanë siç janë: matja e hipertensionit, matja e sheqerit, si dhe janë dhënë këshilla mjekësore për ruajtjen e shëndetit.

Me datën 13 maj 2025, kemi pranuar një e-mail nga Drejtoresha e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik nga Ferizaj, Dr. Sevdije Mehmeti e cila na informoi për paraqitjen e rasteve me fruth në rajonin e Ferizajit- 4 raste. Me të marrë informacionin kemi kontaktuar mjekët e QKMF-së dhe i kam njoftuar me paraqitjen e rasteve me fruth dhe kam kërkuar nga ata që në rast që paraqitet ndonjë rast me fruth ta raportojnë rastin menjëherë në IKSHPK, në mënyrë që të hulumtohen rastet me fruth, si dhe të bëhet vaksinimi i atyre fëmijëve që nuk janë vaksinuar. Po ashtu kemi informuar edhe Çerdhen e fëmijëve në Kaçanik në mënyrë që të mos pranojnë fëmijë të pavaksinuar.

Me datën 16 maj 2025 është mbajtur trajnimi për përdorimin optimal të antibiotikëve në KPSH me grupin e dytë të mjekëve nga QKMF-ja. Ligjerues kanë qenë Prof. Arianit Jakupi dhe Dr. Rushit Ismajli.

Me datën 26 maj 2025, QKMF-ja është inspektuar nga Inspektorati Shëndetësor i MSH-së. Ata kanë bërë inspektimin në tërë hapësirën e QKMF-se dhe vlerësuar lartë organizimin e punës, pastërtinë e objektit, renditjen e njësive organizative dhe në fund dorezuan procesverbalin e inspektimit në Drejtori, kurse raporti i inspektimit do ta dergojnë me vone.

Nga data 09 korrik 2025 pacientet kanë filluar të realizojnë mamografinë në QKMF-Kaçanik. Leximin e mamografive e ka bërë radiologu-Dr. Mentor Trena, i cili është kontraktuar nga Prokurimi për shërbime të veçanta konsulente.

Gjatë muajit shtator dhe tetor 2025, nga ana e ekipeve tona mjekësore nëpër shkolla fillore dhe të mesme janë mbajtur ligjërata sensibilizuese për sëmundjet seksualisht transmise, për duhanin, alkoolin, drogat, për vaksinimin dhe rëndësinë e tij.

Me datën 19 shtator 2025 në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut është organizuar në QKMF-Kaçanik aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut, ku me dhjetëra qytetarë iu përgjigjen ftesës për dhurim të gjakut.

Me datën 24 shtator 2025 në Kaçanik është mbajtur karvani shëndetësor "PËRSHËNDETJE" ku qytetarët paten mundësinë të matin tensionin e gjakut, të matin nivelin e sheqerit në gjak, si dhe të marrin këshilla për sëmundjen e sheqerit dhe parandalimin e tij, hipertensionit dhe sëmundjeve tjera kronike jo ngjitëse.

Me datën 29.09.2025 kemi pranuar Ultrazërin për nevojat e QKMF-së. Ultrazëri është sjellë si rezultat i bashkëpunimit në mes të Komunës së Kaçanikut dhe AQH-së- faza e tretë e projektit, me bashkëfinancim ku 70 % ka participuar AQH-ja dhe 30 % Komuna e Kaçanikut.

Në muajin tetor është mbajtur fushata kundër kancerit të gjirit, me ç'rast janë mbajtur aktivitete në sheshin e qytetit ku janë shpërndarë broshura, si dhe janë dhënë këshilla për parandalimin e kancerit të gjirit. Poashtu është mbajtur edhe një ligjëratë për kancerin e gjirit në sallën e Kuvendit Komunal të Kaçanikut. Aparati i mamografisë ka qenë në dispozicion për të gjithë ata që kanë shprehur interesim për të kryer mamografinë tek ne nga dita e hënë deri të premten gjatë tërë vitit. Vlen të theksohet se deri me datën 20 dhjetor 2025 janë kryer 101 mamografi në QKMF-Kaçanik, nga data 09 korrik 2025 kur kemi filluar me realizimin e mamografisë në institucionin tonë.

Nga data 15 nëntor 2025 deri me datën 01.12.2025 në Prishtinë është kryer trajnimi për përdorimin e ultrazërit të abdomenit nga 4 specialistë të mjekësisë familjare nga QKMF-ja. Ky trajnim është mbështetur në tërësi nga AQH-ja në kuadër të fazës së tretë të projektit AQH-QKMF-Komuna e Kaçanikut. Qytetarët e Kaçanikut nga muaji janar 2026 do ta kryejnë ultrazërin e abdomenit në QKMF-Kaçanik dhe nuk do të kenë nevojë të shkojnë në qendra tjera për këtë procedurë diagnostike.

Me datën 12 dhjetor 2025, Ministria e Shëndetësisë i ka ndarë QKMF-së në Kaçanik një autoambulancë në vlerë prej 30.000€. Në ceremoninë e pranimit-dorëzimit ka marrë pjesë Drejtori i QKMF-së, i cili ka pranuar çelësat nga Zv. Ministri i Shëndetësisë, Dr. Arsim Berisha.

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar bashkëpunimi me organizata të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare, me organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe shpresojmë që bashkëpunimi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026.

Gjatë vitit 2025 është funksionalizuar edhe Këshilli i Pacientëve në QKMF i parapare sipas statutit të QKMF-së. QKMF -ja i ka liruuar një zyrë Këshillit të pacientëve, kurse për kompletimin e inventarit dhe trajnimit të Këshillit të pacientëve është bërë nga AQH-ja.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Misioni i Qendrës për punë sociale

Misioni i Qendrës Për Punë Sociale në Kaçanik është të ofrojë shërbime profesionale sociale dhe mbrojtëse për individët, familjet dhe komunitetin, duke promovuar mirëqenie sociale, mbrojtjen e fëmijëve, barazinë, dinjitetin njerëzor dhe integritetin e të gjitha kategorive në nevojë.

Qendra Për Punë Sociale në Kaçanik synon:

- Të mbrojë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit dhe neglizhimit,

- Të ofrojë mbështetje për familjet në krizë dhe situata të vështira sociale,
- Të fuqizojë viktimat e dhunës në familje dhe të sigurojë reagim të shpejtë dhe të kordinuar
- Të promovojë shërbime cilësore sociale bazuar në standarde profesionale dhe etike.
- Të kontribuojë në përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe kategorive të marginalizuara.
- Të parandalojë fenomenet sociale negative përmes ndërhyrjeve, këshillimit dhe programeve të edukimit.
- Të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional për të garantuar siguri dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët.

Qëllimi i Qendrës për punë sociale

Qendra për punë sociale, si qëllim kryesor ka organizimin dhe realizimin e formave mbrojtëse sociale, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të gjitha komunitetet pa dallim etniciteti dhe besimi. Qëllimet kryesore të Qendrës Për Punë Sociale do t'i priorizojmë me këtë renditje:

përkrahja e grupeve të marginalizuara shoqërore, zbutjen e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të gjithë qytetarët;

- ofrimin e ndihmave sociale për familjet me gjendje të vështirë materiale dhe shëndetësore
- implementimi i politikave sociale të hartuara nga DMS-së;
- ngritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale në përgjithësi;
- rritja e bashkëpunimit më të ngushtë në mes institucioneve profesionale, OJQ-ve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.
- ngritja e vazhdueshme profesionale e zyrtareve gjegjësisht e stafit të Qendrës me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira, në dobi të të gjithë qytetarëve.

Aktivitetet e zhvilluara

Gjatë këtij viti Qendra Për Punë Sociale ka zhvilluar aktivitetet e sajë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale për qytetarë dhe mbrojtjes së grupeve të cënueshme.

Gjatë kësaj periudhe, në Qender Për Punë Sociale janë pranuar gjithsej **1056** kërkesa prej tyre në shërbimi social janë **825** kërkesa të cilat janë trajtuar me profesionalizëm dhe brenda afateve ligjore, dhe në Asistencë Sociale **231** kërkesa, këto kërkesa kanë përfshirë fusha të ndryshme si ; mbrojtja sociale, çështjet familjare, kujdestaria , dhuna në familje, problemet mendore, përkujdesja për të mitur, si dhe shërbime të tjera sociale dhe familjare.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të resurseve humane në Qendrën për punë sociale edhe gjatë këtij viti ,zyrtaret e shërbimeve sociale kanë marrë pjesë në përpunimin e udhëzuesit për ofrimin e shërbimeve sociale, dhe trajnime të ndryshme ku janë trajnuar për bazën e të dhënave të shërbimeve sociale , bazën e dhunës në familje, bazën e FAKP (fëmijëve me aftësi të kufizuara), bazën e strehimit familjar, duke marrë pjesë në të gjitha trajnimet e organizuar nga ministria , departamenti dhe OJQ të ndryshme , ku edhe jemi licensuar i gjithë stafi nga ministria për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Qendrën për Punë Sociale.

Realizimi i të drejtave të qytetarëve për shërbimet e ofruara

Realizimi i të drejtave të qytetarëve në marrjen e shërbimeve sociale dhe publike është një synim bazë i funksionimit të çdo institucioni që synon mirëqenien dhe mbrojtjen e komunitetit.

Qytetarët kanë të drejtë të marrin shërbime të barabarta cilësore dhe në kohë, pavarësisht gjinisë moshës, etnisë, statusit ekonomik apo gjendjes sociale.

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje të barabart në shërbimet që ofrohen pa diskriminim dhe me respekt të plotë,

Institucionet publike duhen të sigurojnë informim të qartë për procedura kriteret dokumentet e nevojshme dhe afatet kohore.

Qytetarët kanë të drejtë të marrin përgjigje brenda afateve dhe të mos përballen me vonesa të panevojshme.

Të gjitha të dhënat personale të qytetarëve trajtohen me kujdes dhe ruhen sipas standardeve ligjore për mbrojtjen e privatesisë.

Shërbimet sociale dhe vendosja në institucionet për përkujdesje

Shërbimet Sociale përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për Mbrojtjen dhe mirëqenien e individëve dhe familjeve që përballen me vështërsi sociale ekonomike, psikologjike, apo shëndetësore.

Qëllimi i këtyre shërbimeve është që të sigurojnë mbështetje të vazhdueshme, të promovojnë jetesën e pavarur dhe të mbrojnë grupet e cënueshme të shoqërisë.

Llojet kryesore të shërbimeve sociale:

Këshillime psikosociale; qëllimi i mbështetjes profesionale për individ dhe familje për menagjimin e krizave, konflikteve, dhunës në familje dhe vështërsive emocionale.

Ndihma dhe ndërhyrje emergjente: për familje që ndodhen në situatë të rrezikut të menjëhershëm, ofrohen shërbime urgjente si: strehim i përkoshëm, mbrojtje, asistencë material dhe ndërmjetësim institucional.

Mbështetje ekonomike dhe materiale: identifikimi i familjeve në nevojë dhe propozimi i tyre për skema sociale, ndihma materiale, pako ushqimore apo paisje të domosdoshme për jetesë.

Shërbime për fëmijë: Përfshijnë vlerësimin e rastëve të braktisjes, neglizhencës, abuzimit, vendosjes në kujdestari, riintegrimi familjar dhe monitorimi i mirëqenies së familjes.

Shërbime për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara: ofrimi i asistencës në shtëpi mbështetja për paisje ndihmëse, vlerësim për skema mbështetëse dhe vendosje në institucione të specializuara kur kujdesi familjar mungon.

Fëmijët pa përkujdesje prindërore

- a. Fëmijët bonjak (pa dy prindër);
- b. Fëmijët e braktisur;
- c. Strehimi familjar;
- d. Prindërit e fëmijëve që nuk i kanë kryer detyrat prindërore

a. Fëmijët bonjak pa dy prind

Gjatë kësaj periudhe zyrtaret e shërbimeve sociale, kujdesë të veçant i kanë kushtuar fëmijëve pa kujdes prindorë(bonjak), të strehuar te të afërmit e tyre, nëpunësit konform ligjit për të gjithë fëmijët pa kujdesje prindërore numri i të cilëve ishte nga fillim i vitit tre (3), shërbimi social në vazhdimsi ka përcjell dhe monitoruar në vazhdimsi këta familje dhe fëmijë në bashkpunim edhe me OJQ të ndryshme.

b. Fëmijët e braktisur

Gjatë këtij viti Qendra Për Punë Sociale ka trajtuar një (1) një rastë të braktisjes së fëmiut, rasti është menagjuar në pajtim me legjislacionin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe procedurave standard te veprimit.

Veprimet e ndërmarra nga QPS

Vlersimi fillestar i gjendjes së fëmiut, vendosja e menjëhershme në kujdes të përkoshëm sipas procedurave ligjore, hartimi i planit individual të mbrojtjes, njoftim dhe kordinim me policin, prokurorinë, dhe institucionet tjera relevante, ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijë, verifikimi i mundësisë së ribashkimit familjar, vazhdim i monitorimit deri në stabilizimin e plotë të rastit. Fëmiu aktualishtë është i vendosur në kujdestari të përkoshme strehim të përkoshëm, procedurat ligjore janë në zhvillim të finalizimit. Rasti i braktisjes së fëmiut është trajtu me prioritet të lartë, dhe në përputhje me standartet profesionale dhe ligjore. QPS ka siguru mbrojtje, sigurinë dhe mirëqenien e fëmiut në çdo faze të procesit.

Adoptimi

Qendra Për Punë Sociale në Kaçanik, në kuader të përgjegjësiave dhe kompetencave ligjore në fushën e mbrojtjes së fëmiut dhe procedurave të adoptimit, gjatë periudhës raportuse ka evidentuar këto të dhëna:

Numri i përgjithshëm i kërkesav për adoptim janë gjashtë (6), ndërsa një (1) adoptim i realizuar.

Nga gjithsej gjashtë (6) kërkesa të paraqitura për adoptim, një rastë ka përfunduar me sukses, dhe proceduara e adoptimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standartet profesionale të shërbimeve sociale.

Kërkesat e tjera janë në faza të ndryshme të shqyrtimit dhe trajtimit, duke u bazuar në vlersime sociale, verifikimin e kushteve familjare dhe interesin më të mirë të Fëmijeve. Qendra Për Punë Sociale në Kaçanik vazhdon angazhimin e saj profesional për trajtimin e rasteve të adoptimit, duke respektu procedurat ligjore dhe duke siguruar mbrojtje dhe mirëqenien e fëmijëve.

Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindore

Nje prej dukurive shqetësuese me të cilat është ballafaquar shërbimi Social është edhe mbrojtja e fëmijëve, për të cilët është mbajtur evidencë, janë dhënë mendime dhe propozime të ndryshme për masat që duhet tu shqiptohen këtyre të miturve.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me raste të cilat prindërit nuk kanë pasur kujdes të duhur prindëror ndaj fëmijëve të tyre, ku numri i tyre arrin në 8 fëmijë, ndaj të cilëve prindërit nuk kanë treguar kujdes të duhur, por me punën dhe angazhimin e shërbimit social këta fëmijë janë kthyer në shkollë dhe vijnë në mësimet, ndërsa 3 prej tyre kanë braktis shkollën, shërbimi social ka inicuar, propozu procedura disiplinore ndaj prindërve, pasi është konstatuar që ka pas neglizhencë nga ana e prindërve, po ashtu ka edhe disa fëmijë ku janë identifikuar nga nëpunësit e Qendrës duke lypur në rrugë. Lidhur me këto raste nuk ka munguar bashkpunimi me Shërbimin Policor të Kosovës.

Fëmijët e familjeve në konflikte:

- a. Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të çrregulluara.
- b. Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar dhe të ndarë.

Gjatë këtij viti, në trajtim të QPS-së kanë qenë tetë (8) qifte bashkëshortore, prej tyre të gjithë kanë qenë me kuror, ku 4 prej tyre i kanë rregulluar marrëdhënjet bashkëshortore. Ndërsa 4 tjera janë në procedurë të shkurorëzimit, ndërsa për të gjitha rastet kontaktimet janë realizuar në QPS, ku gjatë këtij viti janë realizuar 33 kontakte fëmijë -prind.

Zyrtarët e shërbimeve sociale këto raste i vizitojnë dhe i kanë në monitorim të vazhdueshëm, duke ju ofruar këshilla psikosociale dhe rekomandime të vazhdueshme.

Vlen të përmendet bashkëpunim i ngushtë me policinë, strehimoret e ndryshme të cilat veprojnë në Kosovë dhe institucionet tjera si gjykata, shëndetësia etj.

Fëmijët dhe rinia me sjellje asocial

Një ndër problemet shqetësuese me të cilën ballafaqohet shoqëria është delikuenca e të miturve për të cilën kategori zyrtarët e shërbimit social pranë kësaj qendre ka punuar me rastet e tilla.

Fëmijë me sjellje asocial, kemi pasur nëntë (9) raste me të cilët është punuar dhe në bashkëpunim me prindërit dhe shkollën, ku kemi patur sukses në parandalimin, evitimin, ku kemi marr masa që faza latente mos të shëndërrohet në atë manifestuese.

Delikuent të mitur - kemi pasur 117 raste, prej tyre të trajtuar nga na e shërbimit Social duke ju ofruar këshillime psikosociale dhe duke bashëpunuar edhe me psikologë të shkollave deri në risocializimin e tyre.

Vlen të përmendet bashkëpunimi shumë i ngushtë me drejtorët e shkollave, psikologët, police QKMF dhe gjykatën dhe gjithë akterët tjerë të përfshirë në raste.

Kjo dukuri e këtyre të miturve vjen në shprehje për shkak të mungesës apo pa kujdesit prindëror ndaj fëmijëve të tyre ku prindërit janë në të shumtën e rasteve bashkëfajtorë për sjelljet dhe veprimet e fëmijëve të tyre.

Po ashtu kemi raste në rritje të të miturve të cilët përdorin supstanca narkotike dhe janë përdorues të tyre, kjo dukuri është shqetësuese dhe është në rritje, ku QPS-ja ka bërë referimin e 10 rasteve për trajtim në Institutin e Shëndetit Mendor në Ferizaj.

Shkaqet, faktorët të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprave kundër ligjore janë:
Rrethanat familjare, shoqërore, psikologjike ekonomike, mungesa e kujdesit prinderor dhe mbyqyrjes, konfliktet e vazhdueshme në familje, dhuna në familje etj.

Fëmijët me nevoja të veçanta FAKP

Çështje mjaftë serioze dhe e ndjeshme për shoqërinë është edhe çështja e fëmijëve me nevoja të veçanta FAKP. Gjatë vitit 2025 QPS –ja është përpjekur të bëjë evidentimin e të gjitha rasteve të fëmijëve dhe të rinjëve me nevoja të veçanta. Ku me ligjin për përkrahjen e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme kanë gëzuar të drejtën e ndihmës materiale në vlerë prej 150 euro në muaj 69 familje, (fëmijë) nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Këtë vit kemi pasur 16 aplikime të reja dhe 7 aktvendime për nderprerje, ku kanë mbushur moshën madhore, disa fëmijë vijnë mësimet në shkolla normale në gjithë teritorin e komunes sonë.

Duhet theksuar se zyrtarët e shërbimit social në vazhdimsi këshillojnë prindërit që këta fëmijë me nevoja të veçanta të vijnë mësimet në shkolla normale në vende ku edhe jetojnë.

Qendra Për Punë Sociale çdo 6 muaj bënë vizita të rregullta në këto familje ku bashkëbisedon me këta fëmijë, dhe prindërit e tyre, ju ipen sygjerrime dhe rekomandime për trajtimin e tyre.

Të moshuarit të vetmuar

QPS në Kacanik ofron shërbime sociale dhe mbrojtëse për të moshuarit pa perkujdesje familjare me qëllim sigurimin e mirëqenies, mbrojtjes dhe dinjitetit të tyre. Gjatë trajtimit të rasteve realizohet vlersim i gjendjes sociale shëndetsore dhe ekonomike të të moshuarve, si dhe identifikimi i nevojave të tyre specifike, kemi pasur 6 raste ku janë monitoru në vazhdimsi nga shërbimi jonë.

Në kuader të shërbimeve QPS ofron këshillime dhe mbështetje psikosociale ndihmë në realizimin e te drejtave ligjore dhe sociale, ndërmjetësim me institucione shëndetsore si dhe referim për vendosje në institucione perkujdesje afatgjate apo strehimore kur kjo është e nevojshme.

Po ashtu bëhet monitorim i vazhdueshëm i rasteve dhe bashkpunim me institucione relevante për të siguruar mbrojtje të qendrueshme për të moshuarit pa perkujdesje.

Të rriturit me probleme shëndetësore mendore

Gjatë kësaj perudhe Qendra Për Punë Sociale ka trajtuar gjithsej tetë (8) raste të të rriturve me probleme mendore. Të gjitha rastet janë vizituar në teren ku është bërë vlerësim i gjendjes psikosociale dhe nevojave të tyre. Pas vizitave rastet janë përcjell sipas procedurave ligjore, duke përfshirë referimin për shërbime përkatëse, këshillimin e familjareve dhe monitorimin e vazhdueshëm nga ana e QPS –ës me qëllim të mbrojtjes dhe përmirsimit të gjendjes së tyre.

Dhuna në familje

Gjatë vitit 2025 Qendra Për Punë Sociale në Kacanik ka trajtuar gjithsej 34 raste të dhunës në familje, një viktimë është dërguar në strehimoren “ My home” në Ferizaj, ku ju kanë dhënë të gjitha shërbimet brenda strehimores, ndërsa me 32 raste tjera viktimat kanë marrë të gjitha shërbimet e nevojshme profesionale deri në rehabilitimin e tyre, kto raste janë monitoruar në vazhdimsi nga QPS. Raporti paraqet të dhënat kryesore për rastet e evidentuar, nderhyrjet

profesionale, si dhe rekomandimet për përmisimin e shërbimeve dhe parandalimin e rasteve të dhunes.

Llojet e dhunes janë: psikologjike, fizike, ekonomike dhe dhuna ndaj fëmijëve .

Masat e ndermarra nga QPS

Qendra Për Punë Sociale ka ndërmarr veprimet si në vijim: Vlersimi social dhe psikologjik i të gjitha viktimave, plani i sigurisë për viktimat në rrezik të lartë, njoftim dhe kordinim me policinë për të gjitha rastet me rrezik, strehimi i viktimave, mbeshtetje psikologjike për viktimat, referim në shërbime tjera, përfshir shëndetësin dhe organizatat tjera, monitorim i rasteve me rrezik te perseritur.

Sfidat e hasura gjatë punes:

Ngurrimi i viktimave për të raportuar në kohë, varsia ekonomike nga dhunusi, ndikimi i opinionit të familjes dhe komuniteti, mungesa e mbeshtetjes së gjerë familjare, përsëritja e dhunës në disa raste te monitoruar.

Rekomandimet

Rritja e fushatave të vetëdisimit në komunitet, bashkëpunimi i afërt ndërinstitutional, polici, gjykat, shëndetësi, mbështetje ekonomike dhe punësim për viktimat, zgjerim i programeve të rehabilitimit për dhunuesit.

Përfundim

Rritja e raportimit dhe nderhyrjes së institucioneve mbetet thelbësore për parandalimin e dhunës në familje, QPS Kaçanik mbetet e angazhuar në ofrimin e mbështetjes profesionale për viktimat dhe familjet, si dhe ne promovimin e nje mjedisi te sigurt dhe pa dhunë.

Familjet strehnese:

Në komunën e Kaçanikut vazhdon të vërehet mungesa e familjeve strehuse, një shërbim ky i domosdoshëm për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve që gjenden në rrethana të rrezikut ose përkujdesje prindërore. Kjo situatë paraqet sfida të mëdha për institucionin përgjegjës dhe ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve që kanë nevojë për një mjedis të sigurt e të qëndrueshem.

Arsyet kryesore të mungesës së familjeve strehuse:

Shume qytetar nuk janë të informuar dhe njoftuar për rolin dhe rëndësin për të qenë familje strehuse, komuna dhe institucionet perkatese ende nuk kanë zhvilluar fushat të qëndrueshme që promovojnë kujdestari alternative, forcimi i bashkpunimit mes institucioneve tjera locale, shkolla dhe organizatave të shoqrisë civile, përgaditja e materialeve edukative për të shpjeguar procesin e familjeve strehuse.

Në Qender Per Punë Sociale leshohen edhe disa lloje te ndryshe te vertetimeve si :

Vertetime për zotësi veprimi për leje të armës - 211

Vertetime për zotësi veprimi për licencë - 3

Vertetim për lirim nga shtetësia e Kosoves - 4

Vertetim për perkujdesje - 2

Vertetim për udhëtim jashtë vendit - 16

Anamneza sociale - 41

Raporte të hetimit social për gjykata - 23

Deklarata të palëve - 96

Shënime zyrtare - 7

Pjesmarrje ne seanca gjygesore - 12 raste

Pjesmarrje në stacion policor për rastet e dhunës në familje, fëmijë me sjellje asocial dhe delikuent - 296 raste

Gjithsej Vizita në familje në teren për këtë vit janë 503 vizita në teren.

Gjatë këtij viti kemi inkasuar të hyra në Qendër Për Punë Sociale 2228 euro të hyra.

Shërbimi i Ndhimave Sociale

Qendra për punë sociale punët dhe detyrat e punës në lëminë e ndihmave sociale gjatë vitit 2025 i ka realizuar në harmoni me Ligjin e Skemës sociale, Nr.2003/15 i cili ka filluar të implementohet në Janar të vitit 2005, dhe udhëzimeve administrative. Në realizimin e mbrojtjes sociale Qendra për punë sociale, ka kryer këto detyra të punës nga fushëveprimtaria e Skemës së ndihmave sociale:

- ka organizuar dhe realizuar format e mbrojtjes sociale, dhe permanent ka shërbyer për qëllime mbrojtëse të pesonave dhe popullatës;
- ka evidentuar raste sociale, dhe u ka dalë në ndihmë të gjithëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për ndihmë sociale;
- ka përcjellur me kohë të gjitha lëndët në komision mjekësor;
- ju ka përgjigjur me kohë të gjitha ankesave të klientëve siq është e paraparë me Ligjin e skemës sociale etj.

Nëpunësit e skemës sociale janë të ndarë në bazë të terrenit, të cilin e mbulojnë 2 punëtorë, të cilët bëjnë evidentimin e një numri të konsiderueshëm të shfrytëzuesve të ndihmave sociale.

Obligim kryesor i zyrtareve për ndihma sociale për vitin 2025 ka qenë përcjellja e rasteve që e gëzojnë të drejtën në ndihmë sociale zbulimi dhe identifikimi i rasteve të reja që gjenden në situata të nevojave sociale.

Zbulimi i rasteve të reja për ndihmë sociale është një punë e përditshme dhe obligim i përheshëm i punëtorëve, si dhe verifikimi i rasteve të dyshuara se ndonjeri prej anëtarëve të familjes është

punësuar, por kemi marrë parasysh edhe iniciativat dhe rekomandimet e subjekteve tjera të cilat janë të interesuara për mbrojtjen sociale të qytetarëve të komunës.

Vështirësi gjatë punës së zyrtareve për ndihma sociale ka qenë se ka mjaftë familje që nuk i plotësojnë kriteret e ndihmës sociale në asnjërën kategori por vërtet janë raste sociale. Andaj në të ardhmen kërkojm nga institucionet tjera një bashkëpunim më të mirë me Qendrën për punë sociale që të ju ndihmohet edhe këtyre familjeve të cilat vërtet kanë nevojë për ndihma sociale.

Problem në vete ka paraqitur edhe mungesa e bugjetit të Qendrave për punë sociale për ndihma momentale në të holla për familjet dhe personat e rrezikuar materialisht të cilat kanë nevojë urgjente për ndihmë.

Zyrtaret e ndihmave sociale gjatë vitit **2025** kanë dërguar në komision mjekësor **376** kërkesa ku prej tyre **318 pozitive**, ndërsa janë refuzuar **56** dhe 2 plotsime.

Po ashtu gjatë këtij viti që po e lëmë pas janë shqyrtuar **02** ankesa (ankesa në shkallën e dytë) dhe të gjitha janë refuzuar, dhe 03 lënd janë percjell per gjykatë.

Zyrtaret e S.A.S-it gjat këtijë viti kanë lëshuar lloje të ndryshme të vertetimeve:

- Vërtetima të cilët janë shfrytëzues të SAS-it – 8
- Vërtetime që nuk janë shfrytëzues të SAS – 29
- Vërtetime për fitimin e shtetësisë së Kosovës - 169

Numri përfituesve të Asistences sociale për vitin 2025

Tabela e numrit të përfituesve të asistencës sociale

Nr.	Muajt	Nr i familjeve përfituese
1.	Janar	498
2.	Shkurt	498
3.	Mars	496
4.	Prill	491
5.	Maj	489
6.	Qershor	476
7.	Korrik	469
8.	Gusht	469
9.	Shtator	466
10.	Tetor	464
11.	Nëntor	460
12.	Dhjetor	455
13.	Mesatarje Mujore	467

Pilotimi i reformuar i Skemës së Ndihmës Sociale ka filluar në muajin Maj të vitit 2024, Projekt i prezentuar nga Ministria e Punës dhe Transfereve dhe i financuar nga Banka Botërore.

Qëllimi i këtij projekti është të krijohet një skemë e re e cila heq diskriminimin që ekziston në skemën aktuale, duke mos përjashtuar nga skema familjet që kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare dhe që e inkurajon punësimin në anën tjetër përmes bashkëpunimit me Zyrën Rajonale të Punësimit.

Përmes kësaj skeme testohet varfëria në familjet aplikuese përmes kalkulimit të testeve të të hyrave dhe diskriminimit të projektligjit aktual.

Fillimi i verifikimeve të rasteve ka filluar nga muaji Gusht, 2024 ku janë përcjellur listat me familjet të cilat kanë kaluar testin e të hyrave dhe aseteve për verifikim ku në listen e parë ka arritur numri në 165 familje, lista e dytë e aplikimeve ka qenë 178 familje, si dhe lista e tretë ka arritur deri në 116 raste.

Gjatë këtyre muajve jemi ballafaquar me punë jashtëzakonisht të ngarkuar, ngase ne si zyrtarë dhe në mungesë të stafit kemi punuar edhe me ligjin aktual, ku kemi pasur riaplikime të kategorive dhe vërtetime të shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe njëkohësisht verifikimet në teren të riaplikimeve online të këtij projekti.

Gjatë këtyre vizitave vlenë të theksohet se përfitues të këtij projekti në Komunën tone janë 120 familje që mendojmë të jenë në ndihmë sado pak e mjaftueshme për familjet e anueshme në Komunën tonë.

Gjatë viti 2025 janë verifikuar edhe 140 raste të reja, ku numri i përfituesve të familjeve kanë arritur në 176.

Ky projekt është ende funksional, ku ne si zyrtar jemi të angazhuar të bëjmë verifikimin e familjeve të përzgjedhura nga ana e komisioneve punuese në kuadër të këtij projekti, ku të dhënat që përcillen nga ana e Zyrtarëve të Skemës për Ndihmë Sociale që përcaktohen si familje përfituese.

Drejtoria e Arsimit

Aktivitetet kryesore për realizimin e prioriteteve - Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2025	
Aktivitetet kryesore për realizimin e prioritetit	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2025
1. Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor	
1.1 Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor; Arsimi parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3)	Funksionimi i sistemit arsimor, për nivelet e Arsimit parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3) në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-32 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-068 për arsimin më Komunitat e Republikës së Kosovës. Zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë e bazuar në kompetenca, përkatësisht promovimi i arsimit gjithëpërfshirës, cilësor dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet shkollore dhe përgatitja e tyre për sfidat e jetës.
1.2 Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta; respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale etj.	Gjithëpërfshirja ishte prioritet dhe synim për përfshirjen e të gjithë nxënësve/fëmijëve në procesin edukativ arsimor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Në këtë mënyrë, në institucionet tona arsimore është arrit shkallë e kënaqshme e gjithëpërfshirjes së fëmijëve duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, ndërkohë që pjesëmarrja/përfshirja e tyre duke mësuar së bashku me të tjerët e duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënësit ka qenë vlerë e njëkohësisht edhe proces që ka ndihmuar fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Gjithëpërfshirja është e drejtë e çdo fëmije të ndjehet i respektuar, i sigurtë, i mbrojtur dhe të zhvillojë plotësisht potencialin e vet.

2. Ngritja/Avansimi i cilësisë në arsim – Zbatimi i Kurrikulës në arsimin parauniversitar

2.1 Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim - Zbatimi i Kurrikulës së re të Kosovës

Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim mbetet prioritet, sikurse edhe ngritja e kapaciteteve të mësimeve por edhe përgjegjësisë në punë. Zbatimi i reformave në mësimdhënie dhe nxënie, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë, përkatësisht përmirësimi dhe avancimi i cilësisë, mësimeve dhe nxënies.

Zhvillimi profesional i mësimeve dhe avancimi i të nxënit përmes mësimeve cilësore duke zbatuar Kurrikulën e re të Kosovës të bazuar në pajisje teknologjike informative dhe pajisje tjera digjitale mjete tjera mësimore.

DKA, mbështet dhe përkrahë përkujdesjen për ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit tanë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë. Po ashtu, DKA vazhdimisht identifikon nevojat e mësimeve për trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku synohet aplikimi i shkathtësive të reja, por edhe zhvillimit të ngritjes profesionale, ndërkohë zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë dhe ngritja e sistemit efikas ofron mundësi për sigurimin e cilësisë dhe përgatitjen e nxënësve për sfidat e jetës.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, rritjes/shtimit të nivelit të përgjegjësisë dhe angazhimit më të madh në shkollë, përgjatë 5 ditëve (kryesisht vikendeve, e shtunë dhe e diel) është mbajtur një trajnim me temë: Programi për rishikimin/përmirësimin e teksteve shkollore, me mësimeve të arsimit fillor, mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

2.2 Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas UA Nr.06/2022, respektivisht i bazuar në rezultatet e të nxënit dhe reflektimi i performancës së nxënësit.	Janë zbatuar standardet në përputhje me dispozitat e UA për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar respektivisht ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas Kornizës kurrikulare të bazuar në rezultatet e të nxënit për kompetenca (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore RNL). Sipas Kornizës Kurrikulare qëllimi kryesor i vlerësimit është mbledhja e informacioneve për përkrahjen e nxënësve në zotërimin e rezultateve të të nxënit, arritjet individuale të nxënësve, përcaktimi i performancës dhe orientimi i tyre për shkollim të mëtejshëm.
2.3 Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë	Testi i Maturës 2025 kalueshmeria afati i Qershorit Në afatin e qershorit të mbajtur më 21 qershor Testit të Maturës iu nënshtruan gjithsej 224 (127 femra) maturant prej tyre 167 (112 femra) nga Gjimnazi “Skënderbeu” dhe 57 (15 femra) nga IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Nga gjithsej 224 maturantë sa iu janë nënshtruar Testit, 126 (75 femra) e kanë kaluar (56.24 %). Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 167 maturant, testin e kanë kaluar 106 (68 femra) nxënës apo 62.72 % dhe në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” nga 57 (15) sa iu janë nënshtruar testit, 20 prej tyre (7 femra) apo (35.08 %) e kanë kaluar atë. Rezultatet e Testit të Maturës 25 Afati i Gushtit Në Afatin e Gushtit të mbajtur më 28 gusht në Testin e Maturës kanë hyrë gjithsej 73 nxënës, ndërsa atë e kanë kaluar gjithsej 44 apo 60,27 %. Në Gjimnazin “Skënderbeu” kanë hyrë 53 nxënës, ndërsa e kanë kaluar 33 prej tyre apo 62.26 % dhe 20 nga shkolla profesionale prej të cilëve e kanë kaluar 11 apo 55 %. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHITI) i ka publikuar rezultatet e Testit të Arritshmërisë për nxënësit semimaturantë të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë. Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Emin Duraku” nga Kaçaniku ka arritur rezultatin më të mirë duke u radhitur e para me shkallë të kalueshmërisë prej 49.24 %, e dyta është radhitur shkolla “Jusuf Gërvalla” nga fshati Biçec me 47.73 %, e treta “Ali

	Asllani” nga Doganaj me 47.33 %, e katërta “Kadri Zeka” nga Dubrava me 46.96 % etj. Ndërsa, në nivel komunal është arritur kalueshmëria në shkallë prej 45,63 %. Ndërkaq në nivel individual, Uerda Bela nga SHFMU “Emin Duraku” arriti të marr gjithsej 86 pikë nga gjithsej 100 pikë sa ishin maksimale, e dyta është radhit nxënësjë Hana Jakupi (E.Duraku) me 80 pikë, në të tretin është radhitur Anesa Berisha, po ashtu e SHFMU “Emin Duraku, e pas saj janë radhitur dy nxënës: Erina Axhami, gjithashtu e SHFMU “Emin Duraku me 78 pikë sikurse edhe Diard Dalloshi nxënës i SHFMU “Idriz Seferi” me po aq 78 pikë etj. Sivjet, Testit të Arritshmërisë iu kanë nënshtruar gjithsej 421 semimaturantë nga 11 shkolla fillore amë. Vlen të theksohet se sivjet Testi i Arritshmërisë është mbajtur vetëm një ditë e jo si herave të kaluara në dy pjesë dhe ate në lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori dhe Gjeografi, Matematikë, Informatika, Fizika, Kimia dhe Biologji. Testi i Arritshmërisë ka për qëllim që t’i orientoj nxënësit në shkollimin e mëtejshëm në bazë të numrit të pikëve të fituara dhe arritja e rezultateve sa më të mira.
2.4 Trajnimi i mësimeve sipas fushave kurrikulare dhe furnizimi i shkollave me material pedagogjik dhe tekste shkollore	Trajnimet e vazhdueshme kanë qenë një komponentë e rëndësishme që kanë ndikuar pozitivisht në performancën e mësimeve, ndërkaq kualifikueshmëria në shkallë 100 % e stafit arsimor, në shkollat e fillore e të mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta, po ashtu është një tregues dhe faktor që ndikon në rritjen e rezultateve dhe efikasitetin në mësime e nxënie. Edhe sivjet, sikurse edhe dy vitet e kaluara, Ministria e Arsimit nuk ka bërë furnizimin e nxënësve me libra shkollore, ndërsa i ka subvencionuar me nga 80 euro nxënësit e nivelit 1 – 5, e po ashtu, me nga 80 euro edhe ata të nivelit 6 – 9, por jo edhe ata të nivelit para fillor. Furnizimi i nxënësve me libra ka qenë një nga sfidat e këtij fillim viti shkollos, sikurse që ishte edhe dy vitet e kaluara. Vlen të theksohet se ka shumë raste kur prindërit për shkaqe të ndryshme nuk kanë arritur të aplikojnë në sistemin e-Kosova, andaj edhe fëmijët e tyre kanë ngelur pa tekste shkollore, sikurse që ka edhe

	raste ku për shkaqe të panjohura akoma nuk është bërë pagesa respektivisht subvencionimi i librave për nxënës. Në Komunën e Kaçanikut nuk ka asnjë librari, kështu që prindërit dhe nxënësit janë detyruar të gjejnë alternativa për furnizim në qytetet tjera e madje edhe në një shitore ushqimore/minimarket, këtu brenda qytetit të Kaçanikut e cila po merret edhe me furnizimin e nxënësve me libra.
--	--

3. Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit i bazuar në transparencë dhe llogaridhënie – Funkzionimi i organeve të shkollës

3.1 Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit arsimor	Krijimi i disiplinës dhe rendit shkollor është bazë për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar duke zhvilluar një sistem funksional në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së drejtorëve të institucioneve shkollore për një shkollë moderne me nivel të lartë dhe edukim cilësor e po ashtu edhe ngritje e performancës së koordinatorëve të cilësisë dhe në përgjithësi të mësimeve për një sistem efikas arsimorë.
3.2 Funkzionimi i organeve të shkollës: Drejtori/zëvendësdrejtori i shkollës, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli pedagogjik/Këshilli i arsimtarëveAktivevet Profesionale, Task Forca në nivel shkolle e DKA, Koordinatorët e cilësisë, Këshilli i prindërve e Këshilli i nxënësve dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit dhe Këshilltari i karrierës, në nivel të ShFMU-ve.	Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, koordinimi dhe ndarja e punëve e përgjegjësi në përputhje me rolin dhe kompetencat e organeve të shkollës. Promovimi i mësimeve dhe avansimi i të gjitha fushave të cilësisë, respektivisht përmirësimi i mjedisit mësimor dhe kushteve të punës e njëkohësisht zvogëlimin në minimum të braktisjes së nxënësve në shkollë Nga shtatori i vitit 2025, Koordinatorët e cilësisë, pedagogjet dhe psikologët e shkollave, janë angazhuar në procesin e vlerësimit të

	performancës së mësidhënësve, në kuadër të procesit të Licencimit dhe ri-licencimit të mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit në Komunën tonë. Vlenë të përmendet, se janë kryer të gjitha procedurat për ndarjen/pavarësimin e shkollës së Kovaçecit nga SHFMU “Idriz Seferi” Bob. Procedurat për emërtimin e shkollës janë në fazën përfundimtare. Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues ndaj braktisjes është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë. Edhe gjatë vitit 2025, Ekipi Komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta ka identifikuar dhe vlerësuar 25 fëmijë me nevoja të veçanta, sipas kërkesave të prindërve. Për rastet e vlerësuara janë dhënë rekomandimet përkatëse si: sigurimi i asistëntes, sigurimin e transportit etj. Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë vitit shkollor 2025 – 2026 është duke i subvencionuar me nga 60 – 100 euro për muaj për 21 fëmijë me nevoja të veçanta, për periudhën shtator 2025 deri në Qershor 2026. Ndërkaq, është 760 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas.
4. Investimet në infrastrukturën shkollore	
4.1 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore Furnizimi i shkollave me pajisje shkollore	DKA edhe gjatë vitit që e lam pas, është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë, kabinete shkollore e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore e po ashtu edhe ndërtimin e palestrave sportive.

- Para fillimit të vitit të ri shkollor, në SHFMU “Jusuf Gërvalla” – Paralelja e ndarë në Nikaj është bërë lyerja e sipërfaqes së brendshme të objektit shkollor, ndërsa janë kryer edhe disa renovime në hapësirën e jashtme shkollore. Vlen të theksohet se ky aktivitet është bërë me mjete dhe punë vullnetare të komunitetit të fshatit.
- Renovime janë bërë edhe në SHFMU Emin Duraku”, objekti në Dushkajë, objekti i SHFMU “Idriz Seferi” në Bob dhe ai i SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj, ndërsa është shpenzuar shuma mbi 30 mijë euro, mjete nga buxheti komunal.
- Janë siguruar edhe 7 gjenerator në vlerë prej 51,849 euro, ku disa nga shkollat janë pajisut me nga një gjenerator, pastaj kabinetet e IAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka” në Kaçanik janë furnizuar me materiale në vlerë 13,641euro dhe, me kohë dhe mjaftueshëm janë furnizuar të gjitha shkollat me lëndë djegëse, pelet dhe dru.
- Ndërkaq, që gjatë muajit Tetor, në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob është përruruar Palestra sportive janë shpenzuar gjithsej 367 mijë euro, nga buxheti i komunës prej të cilave 200 mijë euro janë investuar vitin e kaluar (2024) dhe 167 mijë euro, gjatë vitit 2025. Po ashtu, Palestra sportive në shkollën e Bobit është furnizuar edhe me pajisje sportive në vlerë mbi 60 mijë euro, mjete të financuara nga MASHTI. Ndërkohë kanë rifilluar punët për ndërtimin e objektit shkollor në Doganaj i filluar më 2019, ndërsa ishte planifikuar të përfundontë më 2022, e po ashtu, janë duke u zhvilluar punët për ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në fshatin Rekë. Të dy këto projekte janë duke u financuar nga MASHTI, përkatësisht Qeveria e vendit.
- Nga subvencionet në arsim, janë ndarë 50 bursa për student në vlerë 500 euro.
- Këtë vit shkollor, investimet kapitale në fushën e arsimit kanë pësuar rënie pasi jemi munduar të kryejmë obligimet ndaj mësimdhënësve, respektivisht zbatimin e kontratës kolektive, ndërkohë që Komuna e jonë jemi në përmbyllje apo shlyerjen e obligimeve ndaj tyre.

4.2 Sigurimi i transportit për nxënësit e IAAP
“Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” dhe të tjerë

Edhe këtë vit shkollor 2025-2026 sikurse edhe tri vitet e kaluara shkollore (2022 – 2023, 2023 – 2024 dhe 2024 - 2025), Drejtoria e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimor dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Ferzi Guri dhe vëllezërit Çaka”. Mbi 14 mijë (14.375) euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, pastaj nxënësve të lokaliteteve Glloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijnë mësimet në Gjimnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të disa shkollave fillore të cilët udhëtojnë nga fshati Llanishtë në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, nxënësit e fshatit Semajë, të cilët udhëtojnë në shkollën e Elezajve dhe atyre të Sllatinës të cilët udhëtojnë në shkollën e Doganajve. E po ashtu edhe të dy nxënësve të fshatit Kotlinë që udhëtojnë në shkollën e fshatit Kovaçec dhe anasjelltas. Ndërkaq, është 760 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas. Ndërkaq, që pritet që edhe të gjithë nxënësve tjerë të cilët vijnë mësimet në Gjimnazin “Skënderbeu” të iu hiqen shpenzimet e udhëtimit, po ashtu nga buxheti i Komunës.

4.3 Kontrata kolektive- pajtimet gjyqësore

Drejtoria komunale e Arsimit, ka arritur marrëveshje me përfaqësuesit ligjor të mësimdhënësve, për pagesat që dalin nga Kontrata kolektive, në vlerë 1,167.549.46 euro.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Raporti i punës (aktiviteteve) për vitin 2025

I. Baza ligjore

Raporti i aktiviteteve të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për vitin 2025 është përgatitur në përputhje me kornizën ligjore që rregullon administrimin financiar komunal dhe procedurat buxhetore në nivel lokal.

Bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008, datë 25.09.2008), në dispozitat e Kapitullit VIII – Financat Komunale dhe Procedurat Buxhetore, përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në administrimin financiar të komunës.

Veprimtaria e Drejtorisë gjatë vitit 2025 është zhvilluar gjithashtu në përputhje me:

- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
- Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025
- Qarkoret Buxhetore të MFPT
- Rregulloret financiare dhe udhëzimet administrative në fuqi

II. Përmbledhje

Në përputhje me bazën ligjore të lartcekur, Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë vitit 2025 ka realizuar aktivitetet kyçe të planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit financiar, duke siguruar funksionimin e rregullt të proceseve buxhetore dhe kontabël, në koordinim të vazhdueshëm me Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe duke garantuar transparencë financiare ndaj qytetarëve dhe publikut.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të dy sektorëve: Sektori për Buxhet dhe Financa dhe Sektori i Tatimit në Pronë.

A) SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

1) Përgatitjet dhe organizimi për fillimin e vitit fiskal 2025

- U bënë përgatitjet për nisjen e vitit fiskal 2025
- U plotësuan formularët e emërimeve dhe fletëdeponimet e nënshkrimeve për zyrtarë autorizues të programeve/nënprogrameve buxhetore dhe zyrtarët me qasje në modulet e SIMFK. (FreeBalance).

2) Raportimi financiar

- U përgatit dhe u dorëzua Raporti Vjetor Financiar 2024, sipas afateve dhe kërkesave për dorëzim.
- U përgatitën raportet financiare tremujore (TM1, TM2, TM3) sipas kërkesave të raportimit dhe monitorimit.
- U bë plotësimi i Pyetësorit të vetë-vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

3) Planifikimi financiar, rrjedha e parasë dhe zotimet

- U përpilua plani i zotimeve dhe plani i shpenzimeve / rrjedha e parasë së gatshme (cash plan), sipas planifikimeve mujore të programeve buxhetore.
- U lëshuan deklarata për disponueshmërinë e mjeteve financiare për nisjen e procedurave të prokurimit (për Zyrën e Prokurimit).
- U krye menaxhimi i zotimeve dhe kërkesave për blerje (kërkesa nga drejtoritë komunale)

4) Pajtueshmëria kontabël dhe raportimi ndaj Thesarit

- U raportuan në baza mujore obligimet kontraktuale dhe detyrimet e papaguara në Departamentin e Thesarit.
- U realizua barazimi/ rikonsilimi mujor me Departamentin e Thesarit për të hyrat dhe shpenzimet, në të gjitha kategoritë ekonomike, si proces i pajtueshmërisë së librave kontabël.
- U trajtuan korrigjimet/ anulimet dhe mospërputhjet eventuale, me koordinim me Departamentin e Thesarit.

5) Operacionet e brendshme financiare dhe ekzekutimi i shpenzimeve

- U zhvilluan operacione të përditshme financiare: pranimi i kërkesave, krijimi i zotimeve, kërkesave për blerje dhe ekzekutimi i shpenzimeve sipas kodeve të planit kontabël.
- U konfirmuan ndryshimet në listën e pagave, bazuar në kërkesat e Zyrës së Personelit, Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- U siguria respektimi i procedurave financiare, disiplinës buxhetore dhe parimeve të menaxhimit të mirë financiar në çdo fazë të procesit të pagesave.

6) Komunikimi institucional dhe mbështetja për ekzekutivin komunal

- U zhvillua komunikim i vazhdueshëm me Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Buxhetit, përmes shkresave/ kërkesave zyrtare lidhur me operacionet e brendshme organizative, si:
 - kërkesa për bartje të mjeteve të pashpenzuara,
 - kërkesa për regjistrime të përfituesve,
 - kërkesa për alokim të të hyrave vetanake/ participimeve/ donacioneve,
 - kërkesa për anulime/ korrigjime dhe
 - kërkesa për transfere e rialokime,
- U bë raportim dhe informim në baza ditore/ javore, për menaxhmentin dhe mbajtësit e autorizuar të programeve buxhetore lidhur me të hyrat dhe shpenzimet e njësisë të tyre.

7) Planifikimi buxhetor për vitet në vijim

- U realizua hartimi dhe përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kaçanikut për periudhën 2025–2027, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe afatet e procesit buxhetor.
- Dokumenti përfshin projeksionet e të hyrave dhe shpenzimeve, prioritetet zhvillimore komunale, kufijtë buxhetorë për drejtoritë buxhetore, si dhe orientimet strategjike për planifikimin financiar afatmesëm.
- Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore është zhvilluar paralelisht me procesin e dëgjimeve buxhetore dhe konsultimeve publike, ku janë reflektuar kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve dhe akterëve lokalë.
- U përgatit propozim-buxheti për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028, në përputhje me udhëzimet dhe afatet e procesit buxhetor të përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në pajtueshmëri me Qarkoret Buxhetore 01/2026 dhe 02/2026 .
- Në kuadër të këtij procesi janë organizuar dhe mbajtur dëgjime buxhetore dhe konsultime publike me qytetarë, përfaqësues të këshillave lokal, zyrtarë komunalë, organizata të shoqërisë civile (OJQ) dhe përfaqësues të bizneseve lokale, lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale dhe propozim-buxhetin për vitin 2026.
- Gjatë këtyre takimeve janë prezantuar prioritetet zhvillimore, potenciali i të hyrave komunale dhe projektet kapitale të planifikuara, ndërsa janë evidentuar edhe kërkesat dhe propozimet e qytetarëve, të cilat janë trajtuar dhe inkorporuar në procesin e hartimit të buxhetit, sipas mundësive buxhetore dhe prioritetëve strategjike të komunës.

8) Auditimi dhe bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

- U realizua ndërmjetësimi dhe prezantimi i lëndëve përpara ekipës së ZKA-së, me qëllim mbështetje të procesit të auditimit dhe adresim të të gjeturave/rekomandimeve.

9) Transparenca buxhetore dhe publikimi i të dhënave

- U përgatitën dokumente dhe të dhëna financiare në formate të ndryshme (Excel/ PDF/ Word) për publikim në ueb-faqen e Komunës së Kaçanikut, si publikime të nevojshme për transparencë buxhetore ndaj qytetarëve dhe palëve të interesit, ku vlen të përmendet se në publikimin e Instituti GAP, 'Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave', Komuna e Kaçanikut është vlerësuar me 100 pikë (maksimumi), duke u renditur në mesin e komunave me transparencën buxhetore më të lartë në Kosovë.

10) Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit

- Gjatë vitit 2025, stafi ka marrë pjesë në punëtori, takime, trajnime dhe seminare të organizuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, donatorë dhe institucione të tjera.
- Trajnimet kanë trajtuar tema që lidhen me planifikimin buxhetor, ekzekutimin e buxhetit, raportimin financiar, menaxhimin e të hyrave, kontrollin e brendshëm financiar, auditimin, sistemet financiare (SIMFK/ FreeBalance) dhe legjislacionin në fuqi për financat publike.

11) Menaxhimi i pasurive jofinanciare komunale

- U realizua evidentimi dhe regjistrimi vjetor i pasurive jofinanciare komunale, në koordinim me njësitë përkatëse.

12) Procesi i certifikimit dhe aprovimit të pagesave (kontributi i Zyrtarit Certifikues & Aprovues)

Gjatë vitit 2025, në kuadër të kontrollit të brendshëm financiar, është realizuar kontrolli, verifikimi dhe certifikimi i pagesave, duke siguruar që dokumentacioni mbështetës të jetë i plotë dhe në përputhje me legjislacionin/procedurat në fuqi, si dhe duke adresuar paqartësitë/mospërputhjet eventuale në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse.

Sipas raportit të Zyrtarit Certifikues & Aprovues, shpenzimet e trajtuara gjatë vitit 2025 (sipas kategorive) përfshijnë:

- Mallra dhe Shërbime: gjithsej 1,526,440.62 €
- Shpenzime Komunale: gjithsej 242,698.40 €
- Subvencione dhe Transfere: gjithsej 567,073.51 €
- Investime Kapitale: gjithsej 4,250,254.46 €

13) Përfundimi i vitit fiskal 2025

- U kryen veprimet e nevojshme për mbylljen e vitit fiskal 2025, në koordinim me Departamentin e Thesarit.

B) SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

1) Faturimi dhe ngarkesat për tatimin në pronë

- Në bazë të legjislacionit në fuqi për tatimin në pronën e paluajtshme, gjatë vitit 2025 Zyra Komunale e Tatimit në Pronë është angazhuar me faturimin dhe ngarkesat për tatim për vitin 2025.

2) Shpërndarja e faturave

- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë është realizuar përmes Postës së Kosovës, sipas kontratës së nënshkruar.
- Me datë 24.03.2025 janë pranuar 5962 fatura nga Departamenti i Tatimit në Pronë, me vlerë totale 351,247.16€.

3) Inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë

- Inkasimi gjatë vitit 2025, nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi i ri i tatimit në pronë, për objekte dhe parcela ka qenë 271,700.21€.

4) Trajtimi i ankesave/ kërkesave për korrigjim

- Me ndryshimet ligjore është mundësuar që ankesat/kërkesat për korrigjim të bëhen gjatë tërë vitit.
- Për vitin 2025 janë pranuar gjithsej 6 ankesa/kërkesa për korrigjim, të cilat janë shqyrtuar dhe janë marrë vendimet nga Zyra e Tatimit në Pronë.

5) Shërbimet për qytetarët- vërtetime

- Gjatë vitit 2025 janë lëshuar gjithsej 581 vërtetime, kryesisht për rregullimin e ndihmave sociale dhe për nevoja personale të qytetarëve.

6) Sfidat teknike dhe ndikimi në raportim/ punë në terren

- Gjatë muajit Korrik 2025 janë paraqitur probleme me sistemin e Tatimit në Pronë për shkak të ndryshimit të programit/ sistemit.
- Për periudhën Korrik 2025- Janar 2026 nuk ka qenë e mundur të nxirren raporte, të realizohen ri-anketime, punë në teren dhe regjistrime të pronave të reja.

7) Auditimi, vlerësimi dhe inspektimet

- Zyra Komunale e Tatimit në Pronë është njoftuar dhe ka bashkëpunuar në procesin e auditimit për të hyrat nga Tatimi në Pronë.
- Gjatë muajit Tetor 2025 është pranuar nga MFPT – Departamenti i Tatimit në Pronë Raporti mbi Vlerësimin e përgjithshëm për prona Rezidenciale dhe Industriale Nr.349/2025, datë 29.10.2025.
- Është realizuar edhe inspektimi vjetor për vitin 2024 nga Departamenti i Tatimit në Pronë (MFPT), dhe raporti i inspektimit është pranuar në muajin Shtator 2025.

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Urbanizmit

Raporti i punës për vitin 2025

Gjatë këtij viti duke filluar nga 1 Janari 2025 e deri me 31 Dhjetor 2025 pranë sektorit të Urbanizmit. Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veç e veç të cilat gjatë ekzekutimit në total kanë gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej **199,342.96€ (euro)** dhe atë:

- Taksa për Lejet ndërtimore në vlerë ;160,393.48 €
- Taksa për Lejet Mjedisore në vlerë ;31,402.63 €
- Taksa për Legalizim në vlerë ;7,546.85 €

- **Këkesa për kushte ndërtimi 39**

1.1 Kushte ndërtimore të miratuara 30

1.2 Kushte ndërtimore të refuzuara 3

1.3 Në procedurë 6

- **Kërkesa për leje ndërtimi 32**

2.1 Të miratuara 29

2.2 Në procedurë 3

2.3 Nga Lejet e Ndërtimit, të cilat janë lëshuar: 6 i takojnë kategorisë së dytë

2.4 Leje për vendosjen e paneleve solare 1

- **Kërkesa për Legalizim 111**

3.1 Të miratuara 39

3.2 Në procedurë 72

- **Kërkesa për ndërrim destinim të tokës Bujqësore në Ndertimore 47**

4.1 Kërkesa të miratuara 42

4.2 Kërkesa të refuzuara 0

4.3 Në procedurë 5

- **Drejtoria ka lëshuar edhe:**

5.1 Leje mjedisore komunale 14

5.2 Njoftime me PZHK 5

5.3 Pëlqime paraprake për bujqësi dhe grante 4

- **Përditsimin sistemit të adresave**

6.1 Rreth 286 numra të vendosura në sistemin Aris

6.2 Verifikimi i objekteve të reja në Komunën e Kaçanikut 68

- **Drejtoria ka kryer punë për realizimin e projekteve kapitale sikurse:**

7.1 Investimi I paraparë për këto rrugë 277,533.12 €, ndësa të kryera janë 228,987.50 €

7.2 Aneks kontrata 27,648.05 €

"Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale - Kaçanik, kontratë njëvjeqare"					
Nr.	Emri i rrugëve	Gjersia	Gjatësia Asfalt	Gjatësia kubëza	Gjatësia Zhavor
1	Rruga në fsh. Kotlinë (asfalt)	3 m'	455 m'		
2	Rruga në lagj. Tupani fsh. Begracë (asfalt)	3 m'	210 m'		
3	Rruga në lagj. Gashi fsh. Begracë (asfalt)	3 m'	140 m'		
4	Rruga në lagj. Luzha fsh. Begracë (asfalt)	3 m'	280 m'		
5	Rruga në lagj. Mezraja fsh. Kovaçec (me kubëza)	3 m'	40 m'		
6	Rruga në lagj. Mezraja dhe Thaçi fsh. Kovaçec (asfalt)	3 m'	140 m'		
7	Rruga në lagj. Burniku fsh. Kovaçec (me Kubëza)	3 m'		65 m'	
8	Rruga për në verrezat e lagj. Koraqi dhe Muça fsh. Kovaçec (zhavor)	4 m'			145 m'
9	Rrugët në fsh. Llanishtë (zhavor)	4 m'	390 m'		
10	Rruga në lagj. te restaurant "Evropa 92"- fsh. Kaçanik i Vjetër (asfalt)	3 m'	153 m'		
11	Rruga në lagj. te Kotlin Lokt - fsh. Kaçanik i Vjetër (asfalt)	3 m'	410 m'		
12	Rruga "Çlirimtarët" (te Hagjia) - fsh. Kaçanik i Vjetër (asfalt)	3 m'	135 m'		
13	Rugicat në fshatin Gajre (4 degëzime të rrugës "Brigada 162 Agim Bjarami"-me kubëza, 7 degëzime të rrugës "Sakip Mulaku"-me kubëza, "Veteranët 1999"- me kubëza).	3 m'		685 m'	
14	Rrugicat në fshatin Bajnicë (asfaltimi i krahut të rrugës "Natyra"-asfalt, krahut të rrugës "10 Gushti"-asfalt, lagja "Fazliu"-asfalt, degëzimi i rrugës "Ukshin Hoti"-asfalt, rruga "Qamil Rexhepi"-asfalt , rruga "Xhemajl Salihu"-asfalt, parkingu para shkollës-kubëza, parkingu te oda e fshatit-mbushje).	3 m' dhe 4 m'	745 m'		
1	Rrugë të Asfaltuar gjithsejt metër gjatësi				8098.00m'
2	Rrugë të Kubza gjithsejt metër gjatësi				750.00m'
3	Rrugë të Zhavor gjithsejt metër gjatësi				145.00m'

- Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Soponicë, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Begrace, Kashan, Kukaj, Kotlinë, Biçec, Nikaj, Duraj-Gabricë, dhe Runjevë

8.1 Investimi I paraparë për këto rrugë 220,929.12 €, ndësa të kryera janë 150,558.65 €

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Soponicë, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Begrace, Kashan, Kukaj, Kotlinë, Biçec, Nikaj, Duraj-Gabricë, dhe Runjevë					
Nr.	Emri i rrugëve	Gjersia	Gjatësia Asfalt	Gjatësia kubëza	Gjatësia Zhavor
1	Rruga në fsh. Stagovë (asfalt)	3 m'	365 m'		
2	Rruga në fsh. Begracë (asfalt)	3 m'	285 m'		
3	Rruga në fsh. Soponicë (asfalt)	4 m'	575 m'		
4	Rruga në fsh. Dubravë (Zhavor)	4 m'			680 m'
5	Rruga në fsh. Bob (Zhavor)	4 m'			460 m'
6	Rruga në fsh. Kotlinë (Zhavor)	4 m'			490 m'
7	Rruga në fsh. Bajnicë (asfalt)	3 m'	294 m'		
8	Rruga në fsh. Gërllicë e Epërme (asfalt)	4 m'			582 m'
9	Rruga në fsh. Begracë (Zhavor)	4 m'			665 m'
10	Rruga në fsh. Rekë (Zhavor)	4 m'			308 m'
11	Rruga në fsh. Kaçanik i Vjetër (asfalt)	3 m'	460 m'		
12	Rruga në fsh. Rekë (Zhavor) Lagj. Hajdaraj	4 m'			280 m'
13	Rrugcat në fsh. Gjugjedell (Zhavor)	3.50m'			1130 m'
14	Rruga në fsh. Sllatinë (Zhavor)	4 m'			95 m'
15	Rruga në fsh. Doganaj (Zhavor)	4 m'			190 m'
16	Rruga në fsh. Soponicë (Zhavor)	4 m'			540 m'
1	Rrugë të Asfaltuar gjithsejt metër gjatësi				2114.00m'
2	Rrugë me Kubza gjithsejt metër gjatësi				00.00m'
3	Rrugë me Zhavor gjithsejt metër gjatësi				5420.00m'

- **Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Urbane - Kaçanik**

9.1 Investimi I paraparë për këto rrugë 145,501.40 €, ndësa të kryera janë 123,501.40 €

9.2 Aneks kontrata 14,500.00 €

"Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Urbane" - Kaçanik					
Nr.	Emri i rrugëve	Gjersia	Gjatësia Asfalt	Gjatësia kubëza	Gjatësia Zhavor
1	Rrugica te deg.i rruges "Komandant zefi"	3.50 m'	220 m'		
2	Rrugicat te "Remzi Zharku"	3.00 m'	228 m'		
3	Rruga "Xh.Femi Lladrovci" (Burmikt)	3.00 m'	252 m'		
4	Rruga "Dëshmorët e Kombit"	3.00 m'	113 m'		
5	Rruga "Jehona Raka"	3.00 m'	69 m'		
6	Rrugica te "Beteja e Kaçanikut"	4.50 m'	95 m'		
7	Rrugica te "Muhamet Zeneli"	3.00 m'	54 m'		
8	Rruga "Diaspora"	3.00 m'	78 m'		
9	Rrugica "Xhevë e Fehmi Lladrovci"	6.00 m'	60 m'		
10	Rruga te deg. "Kemajl Thaqi"	3.00 m'	80 m'		
11	Rruga te deg. "Bajram Breisha"	3.00 m'	269 m'		
12	Rruga "Avdurraman Shehu" (trotuar)	2.50 m'	50 m'		
13	Rruga "Mukadeze Lika-Muhaxheri"	3.50 m'			152.00 m'
	Rrugica te rruga "Mejdi Dalloshi"	4.50 m'			756.00 m'
	Rrugicat te rruga "Hasan Prishtina"	3.50 m'		124 m'	
	Rrugica te rruga "Avdurraman Shehu"	3.40 m'		65 m'	
14	Rrugica te rruga "Esat Axhami"	3.40 m'		63 m'	
1	Rrugë të Asfaltuar gjithsejt metër gjatësi				1568.00m'
2	Rrugë të Kubza gjithsejt metër gjatësi				252.00m'
3	Rrugë të Zhavor gjithsejt metër gjatësi				908.00m'

- **Ndërtimi i urës mbi Lumin Nerdome – faza II-të**

10.1 Kontratë njëvjeqare, për vitet kalendarike 2025/2026 investime të parapara 75,276.03€, për vitin 2025 janë shpenzuar 27,788.49 €.

- **Rrenimi i objekteve dhe mbyllja e deponive ilegale**

11.1 Kontratë njëvjeqare, për vitet kalendarike 2025/2026 investime të parapara 120,000.00€, ndërsa në vitin 2025 janë kryer 59,930.20 €.

- **Ndërtimi I murit mbrojtës të betonit të armuar në rrugën "Daut dhe Adem Rakoci"**

12.1 Investimi i paraparë 108,132.90 €, ndërsa të përfunduara janë 108,132.90 €.

Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përroskave

13.1 Kontratë njëvjeqare, për vitet kalendarike 2024/2025 investime të parapara 141,158.88€, gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 100,325.01€, ndërsa në vitin 2025 janë kryer 7,613.87 €.

13.2 Ndërsa punë të papërfunduar janë në vlerë prej: 33,320.00 €.

13.3 Punimet janë ndërprerë dhe është inicuar lënda për ndërprerje të kontratës.

- **Ndërtimi i objektit të mbulesës së nënkalimit hekurudhorë - Kaçanik**

14.1 Investimi i paraparë 53,999.45 €, ndërsa të kryera janë 45,892.20 €

- **Asfaltimi i rrugës: Gryka e Kaçanikut" në fsh. Kaçanik i Vjetër**

15.1 Kontratë njëvjeqare, për vitet kalendarike 2025/2026

15.2 Investimi në "Gryka e Kaçanikut" Investimi i paraparë 149,952.58 €, ndërsa të kryera janë 96,081.52 €.

- **Mbyllja e Deponive Ilegale dhe Rrënimi I Objekteve Pa Leje**

16.1 Kontratë njëvjeqare, për vitin kalendarik 2025-2026

16.2 Vlera e kontratës bazë 1200,000.00€

16.3 Të Shpenzuara gjatë vitit 2025 janë 59,960.20 €

- **Hartimi I Projekteve për Komunën e Kaçanikut**

17.1 Kontratë dyvjeqare, për vitet Kalendarike 2024-2025-2026

17.2 Vlera e Kontratës 120,000.00€

17.3 Aneks kontrata 30% e kontratës bazë

17.4 Ndërsa të shpenzuara në këtë projekt në vitin 2024 janë ; 56,463.69 €

17.5 Ndërsa të shpenzuara në këtë projekt në vitin 2025 janë ; 71,944,.50 €

- **Për vitin 2025 janë paraparë investime për projekte 1,160,083.00 €,**
- **Ndërsa janë realizuar 751,403.43 €.**

- **Drejtoria ka bërë menaxhimin e projekteve edhe të drejtorive të tjera:**

18.1 Mirembajtja dhe renovimi i Objekteve shkollore

18.2 Ndertimi i kanalit per ujitje

18.3 Ndërtimi i ballkanit panoramik

18.4 Rregullimi i hapsirave rekrative – shtegu i lirisë , faza I-rë

18.5 Rregullimi i parkut të qytetit

18.6 Ndërtimi i depos dhe Garazhës në QKMF

18.7 Rregullimi i rrugës Stagovë Runjevë

18.8 Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet: Kaçanik, Bëgracë dhe Kovaçec

18.9 Ndërtimi dhe rregullimi i kanaleve fekale

- **Po ashtu gjatë vitit 2025 janë kryer edhe këto punë:**

19.1 Mirëmbajtja dhe përrditsimi i sistemit të adresave

19.2 Dalje në teren sipas kërkesave dhe sipas punëve të Drejtorisë

19.3 Plotësimi i pyetësorëve të dërguara nga GIZZ për Planifikim Hapësinor për komunën tonë

19.4 Punë për kompletimin e të dhënave për hartimin e PZHK-së

19.5 Punë me palë për kërkesa të ndryshme.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siç janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Sektori i Mbrojtjes dhe Mjedisit

Raporti i punës për vitin 2025

- Gjatë këtij viti duke filluar nga 1 Janari 2025 e deri me 31 Dhjetor 2025 pranë sektorit të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë punur këto punë:
 - 1.1 Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për Raportim vjetorë në Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut për vitin 2025, në Agjensionin për Menaxhimin e Mbeturinave (AMMK).
 - 1.2 Identifikimi i Klientëve për futjen në sistem të shërbimit të mbeturinave, në të gjithë teritorin e Komunës së Kaçanikut.
 - 1.3 Përmirësimin e shërbimit për klientët dhe respektimin e orarit në mbledhjen e mbeturinave nga Kompanitë e kontraktuara.
 - 1.4 Identifikimi i deponive ilegale, dhe eliminimi i disa prej tyre, respektivisht janë identifikuar 19 deponi ilegale, prej tyre: 6 deponi të mëdha, 3 deponi të mesme, 3 deponi të vogla dhe 7 deponi të eliminuara.
 - 1.5 Takime pune të rregullta të grupit teknik, në Hartimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) të Regjionit Ferizaj dhe Gjilan, e që do vazhdojë edhe gjatë këtij viti kalendarik 2026, kur edhe pritet të përfundojë.
 - 1.6 Pjesëmarrje në Komisione të ndryshme, si vlerësim të ofertave dhe pranim të punëve të kryera.
 - 1.7 Poashtu edhe punë të tjera sipas urdhërit të Drejtorit të DUKMM-së.

Sektori i Kadastrit

Gjatë këtij viti duke filluar nga 1 Janari 2025 e deri me 31 Dhjetor 2025 pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar **dhe janë regjistruar 5523 lëndë**, ku nga ky numër janë zgjidhur 5473 ndërsa në pritje për ekzekutim janë edhe 50 lëndë kryesisht të RDPP-së që kanë të bëjnë me bartje të pronave si dhe legalizime të objekteve të pranura nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e **LIGJIT NR.08/L-237 PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME** dhe 11 Udhëzimeve Administrative si rrjedhojë e implementimit të ligjit në fjalë.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor përkundër fluksit të madh të kërkesave nga palet përfshir kryesisht mërgimtarët që don të thotë se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal.

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veq e veq të cilat gjatë ekzekutimit në total kanë gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej **51,354.00 € (euro)** dhe atë:

Sherbimet e ofruara sipas kërkesave të palëve:

• Fleta poseduese	2557 lëndë
• Kopje të planit	397 lëndë
• Çertifikata të gjendjes së pasurisë	547 lëndë
• Koordinata gjeodezike	433 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.)	26 lëndë
• Regjistri i RDPP-së	1563 lëndë

Regjistri i RDPP-së :

Lloji i Lendes ne RDPP	Totali
Bartja e posedimit - Ndarje fizike e pasurisë familjare	8
Bartja e posedimit - Blerje	287
Bartja e posedimit - Dhurim	475
Bartja e posedimit - Këmbim	19
Bartja e posedimit - Shpronësim	34
Bartja e posedimit - Trashëgimi	100
Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit	50
Bartja e posedimit – Ndërtimit/kompensim	9
Bartja e pronësisë - Ndarje fizike	1
Bartja e pronësisë - Blerja	25
Bartja e pronësisë - Dhurata	23
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	4
Bashkimi i prcelave kadastrale	69
Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme	75
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	21
Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit	1
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	2
Fshirja e njësisë Kadastrale	1

Fshirja e Vërejtjes me kërkes të palës	19
Fshirja e Vërejtjes me vendim të gjykatës	4
Fshirja e Vërejtjes pas skadimit të afatit	1
Modifikimi attributeve të parces	159
Modifikimi i attributeve të ndërtesës së përkohshme	1
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	126
Modifikimi i hipotekës	1
Ndarja fizike e parcelave kadastrale	266
Regjistrimi i hapësirave të përbashkëta	3
Regjistrimi i hipotekës	33
Regjistrimi i ndërtesës	43
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	15
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	7
Regjistrimi i servitutit I	3
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	5
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	31
Shërbimi i të dhënave – Vërtetimi që nuk posedon pronë	18

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkëshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të

registrojn pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyreve kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar të implementohet nga Marsi i vitit 2016 deri më Mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatuar edhe për një vit nga Prilli i vitit 2017 deri në vitin 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe tani është vazhduar edhe për 3 vite të tjera nga viti 2025.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siq janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi profesional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siq janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik.

Sektorinë për qështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzrpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike, Shpronësimit, Mbajtjes së evidences së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të mardhënjeve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Në kuadër të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimit të objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesen tekstuale të SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve të tjera ligjore në fuqi mbi Legalizimet.

Duhet cekur gjithashtu se gjatë këtij viti jemi në pritje të fillimit të projektit të RIK-ut nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për 2 zona kadastrale në Komunen tone të financuara nga projekti REGIP i Bankës Botërore. si dhe ekzekutimi i Elaboratit të Shpronësimit të Autostradës Prishtinë – Shkup e pranuar nga zyrtaret e kësaj agjensie për perfundimin e tij në programet zyrtare të pjesës grafike dhe tekstuale, ku përkundër asaj që një pjesë e madhe e këtij elaborati është kryer edhe nga zyrtarët profesional të sektorit të kadastrit në Kaçanik para dorëzimit tek autoritetet e Agjencionit Kadastral.

Vlenë të ceket se nga fillimi i muajit Dhjetor të viti 2025 e posaqërisht nga 5 Janari i vitit 2026 ka filluar edhe implementimi i platformës digjitale eKadastrit e cila ka të bëjë me pranimin e Kontratave të bartjeve të pasurive të paluajtshme nga zyrtarë noterialë në formë online digjitale ku qytetarët kryejnë të gjitha obligimet e bartjes dhe të regjistrimit të bartjes në regjistrat kadastrale tek noteri sipas programit zyrtar SIKTK të menagjuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

HYRJE

Ky raport paraqet aktivitetet dhe rezultatet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe gjatë vitit 2025, me fokus kryesor në menaxhimin dhe realizimin e projekteve kapitale. Raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar të investimeve në infrastrukturë dhe shërbime publike, duke përfshirë projektet e financuara nga buxheti komunal dhe nga granti i performancës. Përmes këtij dokumenti synohet të evidentohen përpjekjet e ndërmarra në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe drejtoritë e tjera, si dhe të tregohen rezultatet konkrete të implementimit të projekteve të infrastrukturës rrugore dhe të shërbimeve publike.

PROJEKTE KAPITALE

Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike, në kuadër të përgjegjësiave dhe aktiviteteve të saj, gjatë vitit 2025 ka qenë e përkushtuar në realizimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale të parashikuara në listën e projekt-buxhetit për investime kapitale për vitin 2025, të miratuar nga Kuvendi Komunal, si dhe të projekteve kapitale të financuara përmes grantit të performancës. Në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe drejtoritë e tjera, drejtoria ka angazhuar resurset për implementimin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, të cilat paraqiten si më poshtë:

➤ Ndërtim të objekteve të infrastrukturës publike

- Gjatë vitit 2025 është vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi i Objektit për Zjarrëfiksa”-faza e II-të ,i cili objekt është i finalizuar dhe i gatshëm për shfrytëzim si dhe është bërë furnizimi dhe punimi i inventarit të brendshëm të këtij objekti.
- Në implemmtim e sipër është dhe faza e parë e projektit : **Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë - Stagovë** , në vitin 2025 janë realizuar rreth 80% e punimeve që përfshijnë punët tokësore (hapjes së trasesë, gërmimit), punët e zhavorit dhe ndërtimi i lëshesës pllakore betonarme (tombinës) dhe mureve mbrojtëse nga betoni i armuar, ky projekt pritet të finalizohet në vitin 2026.

Nr.	Emërtimi	Nr.
1	Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti Restorant Natyra- Fusha e Pajtimit, Faza e II-të	1 projekt
2	Rregullimi i rrugës Bob-Kulla e Hasanit	1 projekt
3	Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën nacionale N2	1 projekt
4	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë -Stagovë (faza I-rë)	1 projekt
5	Ndërtimi i Objektit për Zjarrëfiksa-faza e II-të	1 projekt
6	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriqimit publik në rrugën Fadil Bunjaku-fshati Biçec	1 projekt
7	Furnizimi dhe punimi i inventarit të brendshëm te objekti i Zjarrfikseve	1 projekt
	Total	7 projekte

• **KANALIZIMET FEKALE DHE ATMOSFERIKE**

➤ **Rrjete të kanalizimeve fekale dhe atmosferike**

Në kuadër të kodit buxhetor "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike". Në vitin 2025 janë realizuar këto punime në këto lokacione:

Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale			
Nr.	Emërtimi	Profili i gypit	Gjatësia(m)
1	Kanalizimi fekal – në lagjen Dallosh-Soponicë,	Ø250	566m
2	Kanalizimi fekal – në lagjen Tushaj-Soponicë,	Ø200	396m
		Ø250	706m
3	Kanalizimi fekal – në lagjen Kovaç-Soponicë,	Ø250	801m
4	Kanalizimi fekal – në lagjen Hajdari-Dubravë,	Ø250	84m
5	Kanalizimi fekal-furnizim në fsh Biçec-lagjja Shorra	Ø250	78m
6	Kanalizimi fekal-furnizim në fsh K. Vjetër	Ø200	102m
7	Kanalizimi fekal-afër Shkollës Emin Duraku	Ø250	36m
8	Kanalizimi fekal-afër urës së Konakut –Përreth lumit Nerodime	Ø250	125.5m
9	Kanalizimi fekal në Vendbanimet Kashan dhe Gjurgjedell	Ø250	675m
10	Kanalizimi fekal – në lagjen Dushkaja-Kaçanik,	Ø250	106.5m
11	Kanalizimi fekal-furnizim në fsh Kovaçec-lagjja Muça	Ø200	138m
12	Kanalizimi fekal Biçec - rr.Fadil Bunjaku	Ø250	226m
13	Kanalizimi fekal Fsh Kaçanik i Vjetër, rr "Epopeja e UÇK-së" ,rr "Gryka e Kaçanikut" dhe lagjja Hoda	Ø250	1135m

14	Kanalizimi fekal furnizim - fsh Begracë, Dubravë- lagjja Qorraj	Ø250	300m
15	Kanalizimi fekal -Lamaj te tombina- magjistralla Avdyl Gafurr Luma	Ø250	72m
16	Kanalizimi fekal - lagje e re Kaçanik,	Ø250	200m
17	Kanalizimi fekal rr.Tefik Raka Kaçanik, shkolla fillore Emin Duraku,	Ø250	7 m
18	Kanalizimi fekal – Kashan-pjesa I-rë	Ø250	206m
	TOTALI		5960.00m

Ndërtim i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike

1	Kanalizimi atmosferik përreth magjistrale Ahmet Kaçiku –faza II-të	Ø600	140.50 m
		Ø400	169.50m
		Ø315	722.20m
2	Kanalizimi atmosferik në fsh.Elezaj	Ø1000	230m
	TOTALI		1262.20m

Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese të kanalizimeve fekale dhe atmosferike

1	Nivelizim dhe pastrimi i pusetave në Kaçanik të vjetër
2	Pastrimi i pusetave të kanalizimit atmosferik-Qytet

• HAPËSIRAT PUBLIKE

- Në vitin 2025 janë finalizuar punimet në projektin " **Ridizajnimi i hapësirës së parkut të qytetit përballë kalasë së qytetit**", projekt i realizuar për periudhën 2 vjeçare 2024-2025.
- Në vitin 2025 kanë filluar punimet dhe janë në realizim e sipër në projektin : **Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec**, me numër identifikues: 652-25-6048-5-2-1, projekt i cili është duke u realizuar në bashkëfinancim me MAPL sipas marrëveshjes nga grantin e performancës të fituar nga komuna , në vitin 2025 progresi i realizimit të punimeve është rreth 65% , punimet në këtë projekt pritet të finalizohen në vitin 2026.

Nr.	Emërtimi	Projekte
1	Ridizajnimi i hapësirës së parkut të qytetit përballë kalasë së qytetit	1
2	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	1
	Totali	2 projekte

• **NDRIÇIMI PUBLIK**

- Në kuadër të projektit : **Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën nacionale N2**, është punuar edhe rrjeti i ndriçimit publik.

- Në kuadër të projektit : **Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti Restorant Natyra- Fusha e Pajtimit, Faza e II-të**, me numër identifikues : KA652/25/008/ 521, është punuar edhe rrjeti i ndriçimit publik.

Nr.	Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes	Gjatësia (m)	Nr.trupave
1	Ndriçimi publik -trotuari dhe shtegu i çiklistëve në Rr."Ahmet Kaçiku"	1183m	41 cope
2	Ndriçimi publik - Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën nacionale N2	1365m	58cope
	Total	2548m	99cope

• **MENAXHIMI I MBETURINAVE**

- Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027-I **aprovuar**
- Hartimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave- **Në proces**
- Mbulueshmëria më shërbim në komunën e Kaçanikut është mbi **96%**.

• **KOMUNIKACIONI RRUGOR**

Gjatë vitit 2025 kujdes i veçant i është kushtuar sigurisë dhe krijimit të mundësive më të mira për pjesmarrësit në trafik në rrugët lokale të komunës sonë. Shenjëzim i vijave horizontale në rrugë dhe vendparkingje

Me kontratën "Rregullimi dhe mirëmbajtje e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" në vitin 2025 janë realizuar punime në këto lokacione:

1. Shenjëzimi i kthesës në rrugën "Beteja e 25 majit"
 - 4 shenja "3-63" (me shtylla)
 - 2 shenja "kthesë e rrezikshme" (me shtylla)
2. Para objektit të Komunës
 - 2 shenja "Parking" (me shtylla dhe tabela plotësuese)
 - 1 shenjë "STOP"
 - 2 shtylla
 - 4 riparime
3. Rruga "Vëllezërit Çaka"
 - 2 shenja "Fëmijë në rrugë" (me shtylla)
 - 2 shenja "Kufizim shpejtësie 30 km/h"
 - 1 shenjë "Kufizim shpejtësie 40 km/h" (me shtyllë)
 - 1 shenjë "Ndalim parkimi"
 - 1 shenjë "Rrugë me përparësi kalimi"
4. Rruga "Avdulla Baftiu"
 - 1 shenjë "Ndalohet hudhja e mbeturinave" (me shtyllë)
5. Rruga "Hetem Hasaj" - Sinjalizimi i rrethrrrotullimit
 - 3 shenja "3-63" (me shtylla)
 - 3 shenja "treëndësh në rreth" (me shtylla)
6. Rruga "UÇK" në lagjen Dallosh
 - Polic të shtrirë (L=6.0 m)
7. Rruga "Mynyr Thaqi" në lagjen Troni
 - Polic të shtrirë (L=5.0 m)
8. Rruga "Agim Bajrami"
 - 1 Pasqyre
 - 3 riparime
 - 1 shenjë "Drejtimit obliguar djathtas"
 - 1 shenjë "Ndalim parkimi"
9. Kryqëzimi i rrugës "Sadik Guri" me rrugën "UÇK"
 - 2 shenja "STOP" (me shtylla)
10. Rruga "Hamëz Jashari"
 - 3 shenja "Kufizim shpejtësie 40 km/h" (me shtylla)
11. Rruga "Mynyr Thaqi"
 - 1 shenjë "STOP" (me shtyllë)

12. Rruga "Izahir Troni"
 - 1 shenjë "Paralajmërim i kryqëzimit" (me shtyllë)
 - 1 shenjë "Kufizim shpejtësie 40 km/h" (me shtyllë)
 - 1 shenjë "STOP"
13. Rruga "Ismail Raka"
 - 4 shenja "STOP"
 - 3 shenja "Rrugë me përparësi kalimi"
 - 4 shenja "Vendkalim për këmbësor"
 - 7 shtylla
14. Rruga "Besnik Begunca"
 - 2 shenja "Kufizim shpejtësie 30 km/h"
 - 4 shenja "STOP"
 - 3 shtylla
15. Rruga "Qamil Ilazi"
 - 1 shenjë "STOP"
 - 2 shenja "Ndalim parkimi"
 - 1 shenjë "Kufizim shpejtësie 30 km/h"
 - 2 shenja "Fëmijë në rrugë"
 - 4 shenja (Kufizim shpejtësie 30 km/h)
 - 3 shtylla
16. Rruga "Skenderbeu"
 - 1 shenjë "Ndalim parkimi"
 - 1 shenjë (Kufizim shpejtësie 30 km/h)
17. Rruga "Raif Koraqi"
 - 1 shenjë "Pasqyre" (me shtyllë)
18. Rruga "Ismail Qemajli"
 - 1 shenjë "Ndalim parkimi"
19. Sh.f. në fsh. Nikaj
 - Polic i shtrirë (L=4 m)
20. Shenjëzimi horizontal në rrugën "Hamëz Jashari", L=2,590.00 m'
21. Shenjëzimi horizontal në rrugën "Vëllezërit Çaka", "Izahir Troni" dhe "Sadik Guri", L=5,715.00 m;
22. Vendosja e dy shenjave "Ndalim Parkimi" në rrugën "Nexhmush Fera"
23. Shenjëzimi i udhëkryqit në rrugën "Ismail Raka" (Te Shtëpia e Kulturës)

➤ Transportit publik i udhëtarëve

Transporti publik i udhëtarëve në komunën tonë ka funksionuar mirë. Jemi fokusuar në zbatimin e Rregullores komunale për Transportin Publik. Janë paisur me leje pune dhe janë vërtetuar rendet e udhëtimit për linjat urbano-periferike të gjithë operatorët që operojnë me autobus, kombi-bus dhe auto taksi. Aktualisht funksionon transporti publik i udhëtarëve në të gjitha vijat të cilat janë shpallur nga DSHPE-ja .

• **PROJEKTE TJERA**

Nr.	Emërtimi i projektit	
1	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	1 projekt
	Total	1 projekt

• **MIRËMBAJTJE INVESTIVE**

➤ **Mirëmbajtja e ndriçimit publik-2025**

Gjatë këtij viti sipas kontratës: Mirëmbajtja e ndriçimit publik, me numër identifikues:652-23-3214-2-2-1, është intervenuar në rrjetin e ndriçimit publik, duke i sanuar defektet dhe ndërrimin e llampave të prishura dhe defekteve tjera të paraqitura në rrjet gjatë viti 2025. Sipas kësaj kontrate në vitin 2025 janë realizuar punë në vlerë prej 32,006.45€.

NR	EMËRTIMI	Vlera për vitin 2025
1	Mirëmbajtja e ndriçimit publik, KA652/21/17/221	32,006.45€

➤ **Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara-KRM"Pastërtia"-Kaçanik**

Gjatë viti 2025 janë realizuar punë dhe shërbime në vlerë prej 61,548.70€ për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara dhe hapësira publike sipas marrëveshjes me KRM "Pastërtia"-Kaçanik, që përfshijnë aktivitetet e pastrimit, largimit të mbeturinave , zbrazjes së shportave , krasitjes së drunjëve dekorativ, kositjes, ujitjes etj në lokacionet:

- Hyrja e Qytetit
- Varrezat e Dëshmorëve
- Bulevardi "Ismail Raka"
- Shetitoret përgjatë lumit Nerodime nga Ura Hazirit deri te Ura e Konakut
- Shetitoret nga Shtëpia e Kulturës deri te Xhamia e Dëshmorëve
- Sheshi i Qytetit
- Parku në rr."Agim Bajrami"-Parku i Qytetit
- Parku në rr."Idriz Seferi"
- Parku në rr."Vëllezërit Çaka"
- Parku përreth Gjykatës Komunale

- Parku në fsh. Kaçanik të Vjetër
- Parku në lagjen Hajdari- fsh.Rekë
- Rruga Rruga Qamil Ilazi dhe Rruga Sali Bajra , Rruga Idriz Seferi, Rruga Vëllezërit Çaka, Rruga Skënderbeu, Nënkalimi nër Hekurudhë te ETC-ja.

➤ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe veteravëve të UÇK-së**

Gjatë vitit 2025 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaqërisht para çdo date të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjtë dekorativ (kositje e barit, ujitje dhe pastrim të hapësirave publike). Gjithashtu në çdo datë të përvjetorëve janë pastruar edhe pllakatat përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të ngritura në lokacione të ndryshme të komunës sonë.

➤ **Rregullim dhe pastrim i shtretërve të përrockave dhe lumenjëve**

Krahas rregullimit të shtretërve të lumenjëve dhe përrockave dhe këtë vit është vazhduar me traditën e pastrimit të shtretërve ekzistues të tyre nga prurjet e ndryshme dhe shkurret.

NR	EMËRTIMI	Gjatësia
1	Pastrimi i shtratit të lumit Nerodime-Kaçanik	1,578.50m
2	Pastrimi i shtratit të përroit në lagjen Rakoci-Kaçanik	440m
3	Pastrimi i shtratit të përroit në Rr. "Mejdi Dalloshi" - Kaçanik	110m
4	Pastrimi i shtratit të përroit në Rr. "Mynyr Thaçi" te Mulliri i Kuq -- fsh.Kovaçec	346.50m
TOTAL		2,475.00m

➤ **Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2025**

Gjatë vitit 2025, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinore gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujrave atmosferike, largimi i borës, hudhja e kripës industriale, etj), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavori dhe shtresë të re asfalti.

Punët e realizuara me projektin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale" 2025

- Pastrimi nga bora nëpër rrugët e teritorit të Komunës së Kaçanikut më data :16.11.2024, 21.11.2024, 29.11.2024, 30.11.2024, 01.12.2024, 21.12.2024, 23.12.2024, 24.12.2024, 25.12.2024, 26.12.2024, 27.12.2024, 28.12.2024, 29.12.2024, 30.12.2024, 01.01.2025, 02.01.2025, 03.01.2025, 04.01.2025, 05.01.2025, 12.01.2025, 13.01.2025, 14.01.2025, 17.01.2025, 20.01.2025, 06.04.2025 (Punimet e kryera në fund të viti 2024 të paraqitura këtu janë faturuar dhe paguar në fillim të vitit 2025)

- Hudhja e kripës së përzier me rërë nëpër rrugët e teritorit të Komunës së Kaçanikut më data :16.11.2024, 21.11.2024, 29.11.2024, 30.11.2024, 01.12.2024, 21.12.2024, 23.12.2024, 24.12.2024, 25.12.2024, 26.12.2024, 27.12.2024, 28.12.2024, 29.12.2024, 30.12.2024, 01.01.2025, 02.01.2025, 03.01.2025, 04.01.2025, 05.01.2025, 12.01.2025, 13.01.2025, 14.01.2025, 16.01.2025, 17.01.2025, 20.01.2025, 17.02.2025
- Riparimi i përkohshëm me kubza betoni i disa prerjeve në rrugën Besnik Begunca
- Sanimi i disa gropave me zhavor te vendkalimi i hekurudhës te ETC-ja
- Shtrimi me asfalt i pjesës së rrugës Skënderbeu te Nënkalimi- pjesa ka Stacioni i Trenit (L=90m)
- Riparimi i disa prerjeve me asfalt te Rruga "Komandant Bardhi" në kryqëzimin me magjistralen në drejtim Vitisë dhe një prerje te rruga në hyrje të fshatit Dubravë.
- Hapja e trasesë dhe shtrimi me zhavor i rrugës e cila shpie te vendi i rëniës së Dëshmorëve dhe masakrimit të viktimave civile në fshatin Kotlinë (L=430m)
- Largimi i shembjeve të dheut dhe gurëve rr.kryesore fsh Gajre
- Largimi i shembjeve të dheut dhe gurëve në rrugën kryesore të fshatit Gjurgjedell nga shembjet anësore të dheut dhe gurëve në rrugë(13.05.2025)
- Larja dhe pastrimi me ujë i rrugëve të qytetit me Autobot
- Rehabilitimi i rrugës Kadri Deda , ulja dhe përshtatja e niveletës (kycjes me rrugën magjistrale Ahmet Kaçiku) , gërmimi për uljen e niveletës dhe zhgjerimin e trasesë dhe punët e zhavorit (L=67m)
- Sanimi i gropave dhe prerjeve në rrugë me asfalt në lagjen Dushkajë (rr.Ejup Dushkaja, Rr.Dëshmorët e kombit, Rr.Remzi Zharku) dhe disa degëzime tjera.
- Sanimi i gropave dhe disa segmenteve të rrugës me asfalt në Rr. Besnik Begunca në Lagje të re.
- Sanimi i gropave dhe disa segmenteve të rrugës kryesore të fshatit Runjevë –Rr.Kemajl Thaçi me shtresë asfalti
- Sanimi i një segmenti me shtresë asfalti të rrugës Xhevë dhe Fehmi Lladrovci në fsh Runjevë
- Sanimi i disa segmenteve të rrugës së TMK-së në fsh Runjevë
- Riparimi i një grope me pllaka betoni në rr.Ismail Raka
- Në datën 03.10.2025 pastrimi rrugës nga bora segmenti Gajre (nga shkolla)-Ivajë-Strazhë

- Largimi i drunjëve nga rruga të lakuar nga reshjet e borës në rrugën kryesore të fashatit Begracë dhe në rrugën Malsor Dashi Stagovë në datën 03.10.2025.
- Pastrimi i lumit Lepenc te Ura e fabrikës së ish gëlqeres, pastrimi i prurjeve te ura dhe deblokimi i saj (në ditën që ka pasur vërshime rritje të nivelit të lumit Lepenc 19.11.2025)
- Largimi i shembjes së dheut dhe murit betonarme të prapëtuar në rrugën kryesore në fshatin Ivajë (27.11.2025).

➤ Spektori i Emergjencave

- Në këtë vit është finalizuar dhe miratuar Plani për Vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën e Kaçanikut , i cili plan është bazament dhe ju paraprin planeve tjera në fushën e emergjencave.

NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT- KAÇANIK														
KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2025														
	LIOJI I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gush.	Shta.	Tet.	Nënt.	Dhj e.	GITHS EJT
1	ZJARRE	3	36	15	21	1	13	69	45	34	4	5	5	251
2	INTERVENIME TEKNIKE	-	3	1		6	3	1	1	1	4	3	-	23
3	SHËRBIME	-	-	-	-	-	1	-	2	1	3	-	1	8
4	AKSIDENTE KOMUNIKACION I	-	-	-	-	-	-	2	1	2	1	-	-	6
5	VËRSHIME	-	-	-	-	2	-	-	-	-	2	3	-	7
6	ALARME TË RREJSHME	-	-	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	2
	Gjithsejt:	3	39	16	21	9	17	72	50	39	14	11	6	297

NDARJET ANALITIKE TË INTERVENIMËVE SIPAS MUAJVE PËR VITIN 2025														
		Jan.	Shku.	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gush.	Shta.	Tet.	Nënt.	Dhj	GITHS EJT
1.	Ndarja analitike e zjarreve në : OBJEKTE NDËRTIMORE													
1.1	Banesa – shtëpi	1	2	1	-	-	-	2	-	-	-	-	2	8
1.2	Objekte ndimëse	-	-	-	1	-	-	-	1	-	-	-	-	2
1.3	Shtalla të bagëtive	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
1.4	Objekte kolektive (banesa)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	1
1.5	Oxhaqe	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	2
1.6	Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	

	Gjithsejt:	1	2	1	2		1	2	1		1		3	14
2	Ndarja analitike e zjarreve në : OBJEKTE EKONOMIKE													
2.1	Publike	-	-	1	-	-	1	-	-	-	1	-	-	3
2.2	Objekte Biznesi	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	1	1	4
2.3	Objekte Indusiale	-	-	-	-	-	-	-	1	-	2	-	-	3
2.4	Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithësejtë:	-	1	1			1		2		3	1	1	10
3	Ndarja analitike e zjarreve në: PAISJE ELEKTRIKE													
3.1	Paisjet elektrike / trafo	-	3	-	-	-	1	2	-	-	-	-	1	7
3.2	Paisjet shpërndarëse	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
3.3	Gjenerator	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0
3.4	Të tjera Kablo elektrike	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	2	-	3
	Gjithësejtë:	1	3	1			1	2	1	-	-	2	1	12
4	Ndarja analitike e zjarreve në: SIPËRFAQE TË HAPURA													
4.1	Mal	-	7	5	10	-	2	25	12	10	-	1	-	72
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4.3	Bari i thatë	-	13	4	7	-	-	21	19	15		1	-	80
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4.5	Sipërfaqe bujqësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4.6	Sipërfaqja e djegur (hektar)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4.7	Të tjera (mbeturina sidomos)	1	10	1	2	1	4	18	9	9	1	-	-	56
	Gjithsejt:	1	30	10	19	1	6	64	40	34	1	2	-	208
5	Ndarja analitike e zjarreve në: AUTOMJETE TRANSPORT													
5.1	Automjete motorrike	-	-	-	-	-	1	1	1		1			4
	Gjithsejt:						1	1	1		1			4
6	Ndarja analitike: INTERVENIMEVE TEKNIKE													
6.1	INTERVENIME TEKNIKE	-	3	-	-	6	3	1	1	1	4	3	-	22
6.2	SHËRBIME	-	-	-	-	0	1	0	2	1	3	-	1	7
6.3	AKSIDENTE RRUGORE	-	-	-	-	0	-	2	1	2	1	-	-	6
6.4	VËRRSHIME	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	3	-	4

7	Të lënduar													
7.1	Zjarrfikës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7.2	Qytetarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsejt:	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	Të vdekur													
8.1	Zjarrfikës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8.2	Qytetarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsejt:	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

STATISTIKA - 2025		
1	Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti Restorant Natyra- Fusha e Pajtimt, Faza e II-të	1 projekt
2	Ndërtim i rrugës Bob-Kulla e Hasanit	1 projekt
3	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale	5960m
4	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike	1262.20m
5	Ndërtimi i Objektit për Zjarrëfiksa - faza II-të	1 projekt
6	Ndërtim i trotuareve për këmbësor	2483m
7	Ndërtim i shtigjeve për çiklistë	1183m
8	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	
9	Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën nacionale N2	1 projekt
10	Ridizajnimi i hapësirës së parkut të qytetit përballë kalasë së qytetit	1 projekt
11	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	1 projekt
12	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriqimit publik në rrugën Fadil Bunjaku-fshati Biçec	1 projekt
13	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë -Stagovë (faza I-rë)	1 projekt
14	Furnizimi dhe punimi i inventarit të brendshëm të objekti i Zjarrfikësve	1 projekt
15	Zgjerim i rrjetit të ndriqimit publik në kaudër të projekteve kapitale	2548m/99 trupa
16	Ridizajnimi i hapësirës së parkut të qytetit përballë kalasë së qytetit	1256.40 m ² Gjelbrim 984.84 m ² kubëza
17	Riparim (rehabilitim) me asfalt i rrugëve lokale të asfaltuara	4830.32m ²
18	Pastrim i përrockave dhe lumenjëve	2475m
19	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	1 projekt

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve	
Aktivitete kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/ performanca kyçe gjatë periudhës janar-qershor, të vitit 2025
Angazhimi në realizimin e misionit dhe objektivave të drejtorisë, shqyrtimi i kërkesave të pranuar nga palët dhe vendosja me kohë.	Si drejtori, aktivitetet tona kanë qenë të fokusuara në përmbushjen planit të punës dhe realizimit të misionit dhe objektivave të drejtorisë: mbështetjen e fermerëve për me projekteve të DBZHRP-së, me qëllim të krijimit të lehtësirave dhe rritjen e të hyrave shtesë për familjet, në zonat rurale. Gjithashtu si drejtori jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve për realizimin kërkesave të tyre, duke i shqyrtuar çdo kërkesë të parashtruar dhe vendosjen me kohë të tyre, për të cilat edhe janë informuar, jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve gjatë pranimit të aplikacioneve, duke i ofruar ndihmë në plotësimin e aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse, gjatë aplikimit për subvencione në projektet e ofruara nga MBPZHR.
Mbështetja e fermerëve, në kompletimin e dokumentacionit, për aplikim në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR dhe projekteve me mjete nga buxheti komunës	Nga Projektet e ofruara të MBPZHR, për subvencionim të fermerëve, kët vit kanë në zyre të DBZHRP-së, në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR, kanë aplikuar 440 fermerë: për subvencionim të kulturës së grurit, misrit, kulturave pemëtare, perimore dhe subvencionimit të fermerëve për lopë qumështore, viqave për majmëri, mëshqerrave deleve, dhive, bletëve si dhe shpezëve- pulave etj Fermerëve ju kemi ofruar mbështetje për plotësim me dokumentacion shtesë të kërkesave të tyre, në projektet e subvencionimit të MBPZHR. Mbështetja e ofruar fermerëve lidhur me marrjen e informacioneve për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuara nga zyrtarët e MBPZHR sipas kërkesave dhe përcjelljen e tyre me kohë tek zyrtarët MBPZHR, me qëllim që fermerët të mos ndëshkohen me humbjen e subvencioneve. Nga projektet e realizuara me mjete nga buxheti komunal dhe mjetet e bashkëfinancimit të fermerëve (participimi i fermerëve) kanë përfituar 183 fermerë , në shumë të përgjithshme të investimeve në subvencionimin e fermerëve prej 117,650.00€ . Nga projekti për mbështetje të ekonomive familjare me serra në sipërfaqe prej 50m ² kanë përfituar 103 familje, vlera e projektit 66,900.00€ , projekti i realizuar me mjete nga buxheti komunës 53,410.00€ dhe participimi i fermerëve 20 % e vlerës së projektit (13,490.00 €). Projekti për mbështetje të bletarëve me shkrirëse elektrike të dyllit, kanë përfituar 2 bletarë, vlera e projektit 7,900.00€ , projekt i realizuar me participimin e fermerëve 20% buxheti Komunës 6,320.00€ si dhe participimi i fermerëve 20% vlerës së projektit 1,580.00€ Nga projekti për mbështetjen e fermerëve me mekanizëm bujqësor: plugje për tërheqje me traktor, përfitues 30 fermerë, freza 1.6m, përfitues 10 fermerë, makina kositëse (10) dhe makina mbledhëse të sanës (10), përfitues gjithsejtë nga mekanizmi bujqësor përfituar 60fermerë, vlera e projektit 42,800.00€ , buxheti komunal 34,240.00 € , (20% participimi fermerëve 8,560.00€). Këtë vit kemi investuar 69,950.50€ për ndërtimin e kanaleve të hapura të ujitjes në fshatërat: Kovaçec- Bob, Kaçanik , Nikaj-Biçec, Rekë-Malësi dhe Doganaj.

Mbajtja e evidencës për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore në tokë ndërtimore	Jemi angazhuar në përcjelljen e gjendjen e kulturës së grurit që nga faza e mbirjes e deri në fazën e korrjeve, kemi përcjellë fushatën e korrje-shirjeve të grurit dhe për sipërfaqe e korrura, vazhdimisht çdo fundjavë deri në përfundimin e fushatës së korrjeve kemi raportuar në MBPZHR, lidhur me sipërfaqet e korrura dhe rendimentin mesatar të kësaj kulture (nga 550 ha sipërfaqe të korrura me grurë, kemi pasur një rendiment mesatarë prej 4300 kg/ha). Me kërkesë të MBPZHR kemi hartuar raportin për mbjelljet pranverore dhe mbjellje vjeshtore, të cilët i kemi përcjellë në MBPZHR. Kemi bërë monitorimin e fermerëve përfutues në kuadër të projekteve të subvencionimit të fermerëve me buxhet komunal, lidhur me keqpërdorimet eventuale të fermerëve. Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 45 kërkesa prej të cilave 42 janë të miratuara, dhe 3 kërkesë janë në proces Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është 24248 m² ap shprehur në hektar 2.42.48ha. Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej 14,244.61 € Me kërkesë të palëve janë lëshuar 57 vërtetime bletarëve, lidhur me numrin e kosherev me bletë, që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBPZHR. Gjithashtu sipas kërkesave të parashtruara nga palët kemi bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri, nga të reshurat e shiut, borës si dhe dëmet e shkaktuara nga ari bletarëve.
Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	Këtë vit kemi organizuar disa trajnime me fermerë, në kuadër të projekteve të MBPZHR departamenti i shërbimeve këshillimore, trajnime për kultivimin e kulturave lavërtar (përgatitja e tokës për kultivimin e grurit, zgjedhja e varieteteve të grurit, përdorimi plehrave si dhe kultivimi i perimeve në serra), në pemëtari – krasitja e pemëve – arrës në blegtori kemi organizuar trajnimin lidhur me mbarështimin e gjedheve kujdesi ndaj tyre në bletari kemi organizuar trajnimin me temën mbarështimi i bletëve. Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike me rastin e vizitave në terrenë gjithashtu fermerët janë mbështetur me këshilla individuale sipas kërkesave së tyre, lidhur me vështirësit dhe problemet që i kanë përcjellur, gjatë gjithë vitit.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. HYRJE

Ky raport paraqet aktivitetet, angazhimet dhe proceset e realizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport (DKRS) gjatë periudhës **janar – dhjetor 2025**, në fushën e kulturës, rinisë, sportit dhe trashëgimisë kulturore.

Raporti përfshin aktivitetet administrative, organizative, mbështetjen për OJQ-të dhe klubet sportive, realizimin e aktiviteteve kulturore e sportive, si dhe bashkëpunimet institucionale në nivel lokal dhe qendror.

2. AKTIVITETET SIPAS MUAJVE

JANAR

- Komisioni i monitorimit ka punuar lidhur me raportet e shpenzimeve të OJQ-ve për vitin 2024.
- Përgatitja e raportit të punës për vitin 2024 dhe Planit të Punës për vitin 2025.
- Përcjellja e formularit për përgatitjen e Planit Vjetor të Mbështetjes Financiare Publike për OJQ
- Mbajtja e kuvendeve zgjedhore dhe punuese të klubeve sportive.
- Përgatitja e thirrjes publike për subvencione në kulturë, rinë dhe sport.

SHKURT

- Marrja e vendimit për fituesin e logos së Muzeut të Qytetit të Kaçanikut nga DKRS, në emër të Këshillit për Funksionalizimin e Muzeut të Qytetit.
- Shënimi i 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës (kuiz diturie, ekspozitë figurative, program kulturor dhe sportiv).
- Organizimi i turneut në futboll për nxënës të shkollave fillore “Kupa e Pavarësisë”.
- Takim i rregullt mujor me Këshillin për Funksionalizimin e Muzeut të Qytetit.
- Takim me KVRL për koordinimin e aktiviteteve rinore për vitin 2025.
- Pranimi zyrtar i logos së Muzeut të Qytetit në formate të ndryshme digjitale.
- Takim informues me klube sportive, OJQ dhe organizata kulturo-artistike e rinore lidhur me procedurat e aplikimit për subvencione për vitin 2025.
- Përgatitja dhe publikimi i thirrjes publike për subvencione në Kulturë, Rinë dhe Sport.
- Organizimi i garave shkollorë në shah në bashkëpunim me sportin shkollor.
- Nxënës të shkollave “Qamil Ilazi” dhe “Emin Duraku” morën pjesë në aktivitetin “Drejt Malit” në Brezovicë, aktivitet i realizuar në bashkëpunim me MKRS dhe Federatën e Sportit Shkollor.

MARS

- Takim me zyrtarë të trashëgimisë kulturore në nivel regional.
- Vizitë nga QRTK për zonën arkeologjike në oborrin e komunës dhe dërgimi i kërkesës në MKRS.
- Ftesë publike për donacion vullnetar të artefakteve për Muzeun e Qytetit.
- Iniciativa për mbrojtjen e staneve të fshatit Bob si trashëgimi kulturore.
- Organizimi i finales së Kupës së Kosovës për Seniorë në Basketboll.
- Publikimi i përfituesve të subvencioneve në kulturë, rini dhe sport.
- Shoqërimi i SHKA “Gryka e Kaçanikut” në Festivalin “Flakadani i Karadakut” në Viti.
- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në festivalin “Boletini n’Plis të Bardhë” në Mitrovicë.
- Organizimi i garave shkollore në volejbol në bashkëpunim me sportin shkollor.
- Realizimi i videos promovuese për Ditën Ndërkombëtare të Muzeve.

PRILL

- Pjesëmarrje në diskutim publik për Rregulloren e Taksave dhe Tarifave Komunale.
- Organizimi i aktiviteteve për 22 Prillin – Dita e Tokës dhe 23 Prillin – Dita e Librit.
- Fillimi i punimeve arkeologjike në oborrin e komunës.
- Nënshkrimi i kontratave me OJQ-të përfituese të subvencioneve në kulturë, rini dhe sport.
- Organizimi i Kampionatit Individual të Kosovës në Mundje (U15 & U20).
- Formimi i grupeve joformale vullnetare të të rinjve.
- Angazhimi në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për subvencione.

MAJ

- Organizimi i Turneut Ndërkombëtar “Feriz Guri – Heroinat e Kaçanikut” në mundje.
- Pranimi i artefakteve për muze.
- Kamp përgatitor i mundjes për femra në Kaçanik.
- Organizimi i aktiviteteve sportive për fëmijë dhe të rinj.
- Finalja e Kupës së Kosovës në Basketboll U18 – fitues KB Kaçaniku.
- Pjesëmarrje në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare të SHKA-ve.
- Pjesëmarrja e mundëseve Elsa Nikoci dhe Kanita Spahija në Kampionatin Evropian të Mundjes.

QERSHOR

- Shënimi i 1 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Është mbajtur Festivali Kombëtar i SH.A.K.A. “Kaçaniku 2025”, i organizuar nga Qendra Kulturore “Kaçaniku”, si dhe janë realizuar aktivitete të tjera kulturo-artistike dhe sportive me rastin e përvjetorit të Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë.
- Pjesëmarrja e SHKA “Tingujt e Vendlindjes” në Festivalin Folklorik “Mozaiku Mesdhetar” në Tiranë.

- SHKA “Tingujt e Vendlindjes” morën pjesë në Festivalin “Eshkë e ndezur mbi Shkelzen” në Deçan.
- Pjesëmarrja e SHKA “Tingujt e Vendlindjes” në Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar “Hani i Elezit 2025”.
- Organizimi i turneut me shkollat e futbollit për nder të 11 Qershorit.
- Takime me KFOR-in polak për projekte rinore.
- Vendosja e artefakteve të para në Muzeun e Qytetit.
- Pranimi i raportit të gërmimeve në zonën e oborrit të komunës nga IAK dhe dërgimi i një ekipi nga ChEB për kryerjen e inçizimeve të nevojshme të strukturave të mbetura.
- Shënimi i Ditës Olimpike në bashkëpunim me Sportin Shkollor dhe KOK.
- Pjesëmarrja e mundëseve Lonisa Reka dhe Flutura Zeneli në Kampionatin Evropian të Mundjes.

KORRIK

- Vizita dhe dokumentimi i staneve në fshatin Bob për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- Pjesëmarrje në komisione për vlerësimin e subvencioneve (thirrja e tretë).
- Përgatitjet për 10 Gushtin – Ditën e Dëshmorëve.
- Angazhime për diskutimin publik për buxhetin 2026–2028 me të rinjtë.
- Pjesëmarrja e SHKA “Gryka e Kaçanikut” në Festivalin e Vallës Dyshe “Dyshja na bashkon” në Prishtinë.
- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në festivalin “Këngë Jeho” në Strugë.

GUSHT

- Organizimi i aktiviteteve në kuadër të Javës së Diasporës.
- Koncert folklorik dhe aktivitete edukative me fëmijët e diasporës.
- Organizimi i aktiviteteve për 10 Gushtin – Ditën e Dëshmorëve.
- Kamp përgatitor i Federatës së Mundjes së Kosovës në Kaçanik.
- Aktivitet për “Javën e Diasporës” në bashkëpunim me SHKA “Tingujt e Vendlindjes”.
- Pjesëmarrja e SHKA “Tingujt e Vendlindjes” në Festivalin “Pushka e Parë e Lirisë” në Podujevë.
- Program kulturo-artistik dhe sportiv: Turneu Memorial në Futboll me ekipet fituese të turneve memoriale për dëshmorët të mbajtura në Komunën tonë gjatë vitit 2025, për nder të 10 Gushtit – Ditës së Dëshmorëve në Komunën tonë.
- Prezantimi i projekt-propozimeve për zonën arkeologjike nga ChWB dhe përfaqësuesit e IAK.

SHTATOR

- Organizimi i aktiviteteve për Javën e Rinisë 2025 në bashkëpunim me KVRL dhe klubet sportive (aktivitete sportive në volejboll, shah, basketboll, vizita institucionale dhe lojëra argëtuese).
- Pranimi i donacionit të librave nga Biblioteka Kombëtare për Bibliotekën e Qytetit.
- Në Ditën e Kushtetutës së Kaçanikut janë pritur vizitorë të shumtë në Sallën e Kushtetutës.
- Shënimi i Javës Evropiane të Sportit në bashkëpunim me MKRS, Federatën e Sportit Shkollor, Sportin Shkollor Kaçanik dhe Klubin e Volejbollit “Kaçaniku” (femrat).
- Pjesëmarrja e SHKA “Tingujt e Vendlindjes” në Festivalin “Fest Folk Stublla 2025”.
- SHKA “Tingujt e Vendlindjes” performojnë në Festivalin Ndërkombëtar të Folklorit “Petla Söleni 3”, i organizuar në Inegöl, Bursa – Turqi.
- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në edicionin e 18-të të Lojërave Popullore në Shkodër.
- Qendra Kulturore “Kaçaniku” merr pjesë në Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar “Zani i Kombit”, edicioni IX – Drenas.
- Performanca e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në Festivalin Folklorik “Folk Fest” – Shtime.
- Kanita Spahija nga Klubi i Mundjes fiton medaljen e argjendtë në Kampionatin Ballkanik.
- Në kuadër të Ditëve të Trashëgimisë Kulturore është bërë hapja solemne e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

TETOR

- Ofrimi i shërbimeve për Kryqin e Kuq Komunal në organizimin e aktiviteteve sportive me karakter humanitar.
- Aktivitet kulturor në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, në bashkëpunim me Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës dega në Kaçanik..
- Organizimi i garave shkollore në Hendboll në bashkëpunim me Sportin Shkollor.

NËNTOR

- Aktivitete kulturore dhe sportive me rastin e festave të Nëntorit (vizitë në Shtëpinë Muze të Dëshmorit Ismajl Raka).
- Festival dyditor i Këngëve Popullore për Fëmijë “Kaçaniku 2025”, organizuar në bashkëpunim me SHKA “Gryka e Kaçanikut”.
- Pjesëmarrja në Festivalin e Këngëve dhe Valleve për Fëmijë “Ardhmëria Jonë” – Gjilan.

- Programi kulturo-artistik “Sali Bajra – Kryetari ynë”, në bashkëpunim me SHKA “Kastriotët” Ferizaj.
- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në Festivalin Ndërkombëtar të Folklorit Burimor “DUFLLA 2025”.
- Organizimi i garave shkollore në ping-pong në bashkëpunim me Sportin Shkollor.
- Organizimi i garave shkollore në futsal në bashkëpunim me Sportin Shkollor.
- Karnevalet Ilire nga Malsia e Sharrit Tetovë – aktivitet kulturo artistik i rganizuar në bashkpunim me MKRS .
- Është bërë realizimi i fletëpalosjeve për Muzeun e Qytetit.

DHJETOR

- Pjesëmarrja e SHKA “Gryka e Kaçanikut” në festivalin “N’Konak të Rahovecit na bashkon kënga shqipe”.
- Koncerti festiv “Kultura dhe Arti në Kaçanik”, i organizuar në bashkëpunim me Qendrën Kulturore “Kaçaniku” dhe i mbështetur nga MKRS.
- Pjesëmarrja e SHKA “Gryka e Kaçanikut” në koncertin festiv të organizuar nga Kori i Grave “Nexhmije Pagarusha” – Prishtinë.
- SHKA “Tingujt e Vendlindjes” pjesëmarrës në festivalin e këngëve dhe valleve “Talentët e Rinj” – Drenas.
- Pjesëmarrja e SHKA “Tingujt e Vendlindjes” në festivalin folklorik të këngës në Ferizaj.
- Në Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës Folklorike “Fest Folk” ka performuar edhe SHKA “Tingujt e Vendlindjes”.
- Organizimi i garave shkollore regjionale në shahl në bashkëpunim me Sportin Shkollor
- Janë pranuar raportet e OJQ-ve për subvencionet e vitit 2025 , ku komisioni përkatës do të merret me shqyrtimin e tyre.

3. PËRFUNDIM

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, DKRS ka realizuar me sukses një numër të madh aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore, duke kontribuar në zhvillimin e jetës kulturore dhe sportive të komunës së Kaçanikut, si dhe në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

ORGANIZATAT KULTURORE, RINORE E KLUBET SPORTIVE

Edhe këtë vit , organizatat kulturore , rinore dhe klubet sportive janë përkrahur me subvencione sipas thirrjeve publike, të ndara nga komisioni i themeluar përkatës. Janë përkrahur dhe ndihmuar me subvencione organizatat kulturore, rinore e sportive :

1. Klubi Futbollit “Lepenci”
2. Fondacioni Bonevet,
3. Klubi Basketbollit “Kaçaniku”,
4. Klubi Futbollistik i Femrave “Bazelli 2015”
5. Klubi i Basketbollit “Lepenci”
6. Klubi i Mundjes “Kaçaniku”
7. Klubi i Taekwondos “Kaçaniku 2000”
8. Klubi i Volejbollit “Kaçaniku” (femrat)
9. Klubi i Volejbollit “Kaçaniku” (meshkujt),
10. Këshilli i Veprimt Rinor Lokal,
11. Motokros “Kaçaniku”,
12. Qendra Kulturore “Kaçaniku”,
13. Shoqata Bjeshkëtare Alpiniste “Kaçaniku 2015”,
14. Shoqëria Kulturo Artistike “Tingujt e Vendlindjes”,
15. Shoqëria Kulturo Artistike “Gryka e Kaçanikut”,
16. Shoqata e Peshkatarëve Rekreativo Sportiv “Trofta e Lepencit”
17. Sporti Shkollor Kaçanik.
18. OJQ Kampi i Artistëve Mural,
19. Organizata e Pensionistëve të Kosovës –Dega Kaçanik.
20. Enduro “Kaçaniku”

OBJEKTET SPORTIVE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), gjatë këtij viti, ka vazhduar angazhimet dhe kërkesat e saj drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), lidhur me përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës sportive në komunën tonë. Pavarësisht kërkesave të shumta të adresuara, si dhe ndërprerjes së punimeve nga operatori i kontraktuar për realizimin e punimeve të mëhershme (me kërkesë të MKRS-së), edhe gjatë këtij viti nuk ka pasur vazhdim të punimeve për ndërtimin e tribunave në Stadiumin e Qytetit “Besnik Begunca”, përpos një in tervenimi në rrethoja dhe kabinat mbrenda fushës (investim i realizuar me buxhet komunal). Aktualisht, Stadiumi i Qytetit “Besnik Begunca” shfrytëzohet për zhvillimin e stërvitjeve dhe ndeshjeve nga Klubi i Futbollit “Lepenci”, si dhe nga të gjitha shkollat e futbollit që veprojnë në territorin e komunës sonë.

Palestra Sportive, shfrytëzohet nga të gjitha klubet sportive aktive në komunë, të cilat garojnë në ligat përkatëse. Gjithashtu, fusha me bar sintetik, fushat e jashtme sportive dhe

stazës rekreative të vrapimit në hapësirën e Palestrës Sportive janë në shfrytëzim të klubeve sportive dhe të qytetarëve të komunës për aktivitete rekreative dhe sportive .

Sa i përket investimeve në zonat rurale, sivjet janë realizuar projektet e fushës sportive në lokalitetet Duraj dhe Soponicë

Ky raport paraqet gjendjen aktuale të infrastrukturës sportive dhe angazhimet e vazhdueshme të DKRS-së për përmirësimin e saj, në funksion të zhvillimit të sportit dhe aktiviteteve rekreative e sportive në në komunën tonë.

SHTËPIA E KULTURËS “XHELADIN KURTAJ”

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, së bashku me stafin mbështetës të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”, ka qenë e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e detyrave, shërbimeve dhe aktiviteteve të ndryshme, me qëllim të funksionimit të rregullt dhe zhvillimit të jetës kulturore në komunë.

Në kuadër të angazhimeve kryesore, janë realizuar këto aktivitete:

- Përkujdesja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e hapësirave të objektit të Shtëpisë së Kulturës.
- Ofrimi i shërbimeve për lexuesit, si dhe për të gjitha asociacionet dhe organizatat lokale, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre jokomerciale, duke përfshirë aktivitete kulturore-artistike, letrare, përkujtimore, politike, fetare, humanitare, sportive, garuese dhe manifestime të tjera.
- Gjatë këtij viti, në lokalet e Shtëpisë së Kulturës kanë vazhduar të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe shoqëritë kulturore-artistike dhe organizata të ndryshme, si:
SHKA “Gryka e Kaçanikut”, Qendra Kulturore “Kaçaniku”, grupe dhe asociacione të ndryshme, NKMDLNJ, Kryqi i Kuq, KVRL, OMM “Gjethi”, shoqatat e dala nga lufta, Shoqata e Bjeshkatarëve Alpinistë “Kaçaniku 2015”, si dhe dy qendrat rinore: “Shtëpia e Shpresës” dhe “Discovery Lab”.
- Po ashtu, gjatë këtij viti është hapur për vizitorë edhe **Muzeu i Qytetit**, i cili tashmë është në funksion dhe kontribuon në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të komunës.
- Ky raport pasqyron angazhimin e vazhdueshëm institucional për ruajtjen, funksionalizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj”, në shërbim të qytetarëve dhe komunitetit lokal.

SHËNIM

Gjatë vitit raportues janë organizuar dhe mbështetur një varg aktivitete dhe programesh të tjera kulturore, rinore dhe sportive, të cilat janë zhvilluar në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” dhe në Palestrën e Sportit në Kaçanik, në bazë të kërkesave të grupeve, shoqatave dhe organizatave të ndryshme joqeveritare, rinore dhe sportive.

DKRS ka marrë pjesë dhe është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në shënimin e përvjetorëve dhe ceremonive përkujtimore, përfshirë vizitat në pllakat përkujtimore të të rënëve për të gjitha datat e rënies së Dëshmorëve në Komunën tonë.

Në bashkëpunim me Sportin Shkollor, janë organizuar gara sportive në të gjitha disiplinat, për kategoritë e meshkujve dhe femrave, në nivel lokal dhe regional, ku ekipet fituese kanë përfaqësuar komunën tonë në garat regjionale dhe republikane.

Përfaqësuesit e DKRS-së kanë qenë pjesëmarrës dhe të angazhuar drejtpërdrejt në komisione të ndryshme në kuadër të Komunës, sipas kompetencave përkatëse.

Shoqëritë Kulturore-Artistike (SHKA) kanë marrë pjesë në festivale të ndryshme brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, duke përfaqësuar Komunën tonë në mënyrë dinjitoze dhe duke u vlerësuar me çmime të shumta.

Në Palestrën Sportive janë zhvilluar stërvitjet dhe ndeshjet kampionale për të gjitha klubet sportive të Komunës, në rangje të ndryshme garash. Po ashtu, palestra ka shërbyer për organizimin e aktiviteteve kulturore e rinore, si dhe ka qenë në funksion të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve lokale dhe parlamentare.

Janë mbajtur në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe Shoqatën Handikos ,aktivitetet sportive dy herë në muaj në moton “We are Equal”

Gjatë këtij viti, DKRS ka pasur në dispozicion edhe mjetet e transportit (minibusin dhe kombin), të cilat janë shfrytëzuar nga organizatat joqeveritare kulturore, rinore dhe klubet sportive për realizimin e aktiviteteve të tyre.

INVESTIMET KAPITALE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë vitit 2025, ka qenë e përkushtuar në realizimin dhe menaxhimin e investimeve kapitale, bazuar në listën e projekteve kapitale të përfshira në Projekt-Buxhetin për vitin 2025, i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal.

Në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe ekzekutivin , janë realizuar këto projekte kapitale:

1. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së (projekt në vazhdimsi);
2. Rregullimi i tereneve sportive në lokalitetet Soponicë dhe Duraj

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm duke u mbështetur në Planet Strategjike Komunale si dhe Planin e Punës për vitin 2025, ka vazhduar me përkushtim realizimin e aktiviteteve dhe detyrave të saj, duke kontribuar në përmbushjen e prioritetëve dhe duke pasur në fokus të veçantë mirëqenien e qytetarëve të komunës tonë.

Pavarësisht sfidave të vazhdueshme në fushën e çështjeve ekonomike DZHET ka arritur të zbatojë planin e punës të paraparë për këtë vit dhe të kryejë me përgjegjësi detyrat që bien në kuadër të kompetencave të saj.

Të gjitha aktivitetet e realizuara, si dhe ato që janë ende në proces, janë të përfshira dhe të paraqitura në këtë raport vjetor.

Në kuadër të drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit funksionojnë: Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit .

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat me potencial të lartë për zhvillimin e turizmit në Kosovë, veçanërisht turizmit malor. Duke u bazuar në këtë potencial, gjatë këtij viti jemi angazhuar në promovimin e tij përmes bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve konkrete, me synim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe promovimin e vlerave historike, kulturore dhe natyrore të vendit tonë.

Gjatë këtij viti është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm me nivelin qendror, komunat fqinje si dhe organizata të ndryshme joqeveritare si: AZHR-Lindje, Demos, Giz si dhe KFOR-in me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit. Kryesisht kë bashkëpunime janë konkretizuar me marrëveshje më shumë në fushën e turizmit.

Po ashtu gjatë këtij viti kanë vazhduar bashkëpunimet me Drejtorinë për Planifikim dhe Menaxhim të Parkut Nacional "Sharr" ku në kuadër të kësaj kemi dërguar propozimet tona të cilat duhet të përfshihen në Planin e ri Kombëtar "Sharr". Propozimet tona lidhen me zhvillimin e turizmit dhe krijimin e një zone të re turistike të qasshme me infrastrukturë dhe projekte të tjera të nevojshme për zhvillimin e kësaj pjese.

Gjithashtu, bashkëpunimi ka vazhduar me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamentin e Turizmit, ku kryesisht janë zhvilluar bashkëpunime në hartimin e dokumenteve të reja, me rëndësi strategjike dhe zhvillimore.

Gjatë vitit 2025, jemi angazhuar në procesin e finalizimit të hartimit të "Planit Strategjik për Zhvillim Lokal". Për realizimin e këtij dokumenti është formuar një grup punues, i cili ka punuar në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e këtij dokumenti, duke shqyrtuar nevojat zhvillimore të komunës, analizuar gjendjen ekzistuese dhe përcaktuar prioritetet kryesore, me qëllim që plani të shërbejë si dokument udhëzues për planifikimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Kaçanikut.

Ne, si Drejtori për Zhvillim Ekonomik, kemi zhvilluar takime me biznese që operojnë në komunën tonë për të kuptuar më mirë sfidat dhe nevojat e tyre. Këto takime kanë mundësuar të diskutojmë mbi mënyrën e mbështetjes dhe bashkëpunimit duke krijuar mundësi konkrete për të përmirësuar funksionimin dhe rritjen e sektorit lokal.

Në kuadër të politikave tona zhvillimore ekonomike, ku si prioritet kemi pasur dhe do të kemi rritjen e numrit e të punësuarve, kemi identifikuar dhe do të vazhdojmë të identifikojmë hapësira

të përshtatshme për krijimin e zonave për vendosjen e parqeve industriale, inkubatorëve të biznesit dhe zonave të reja turistike, me qëllim të ofrimit të kushteve infrastrukturore për investitorët dhe nxitjen e tyre për të investuar në Komunën tonë. Përmes të këtij procesi, presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës, si dhe rritje të zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Në kuadër të pronave komunale që mund të jepen në shfrytëzim, gjatë vitit 2025 kemi vazhduar kontaktet me investitorë potencial, me qëllim të informimit të tyre për kushtet e krijuara për zhvillimin e biznesit në komunën tonë. Interesimi i investitorëve ka qenë i vazhdueshëm, duke reflektuar përkushtimin institucional për krijimin e një klime të favorshme për biznes.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar aplikimi i tarifës zero për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve, si një masë mbështetëse me qëllim të lehtësimit të barrës financiare për bizneset ekzistuese dhe ato të reja. Kjo politikë ka synuar nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal, rritjen e numrit të bizneseve aktive dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për ndërmarrësi.

Për kundër vështirësive që kemi hasur gjatë realizimit të aktiviteteve, si pasojë e mundësive të kufizuara financiare të komunës sonë, kemi vazhduar me realizimin e shumë aktiviteteve dhe projekteve në dobi të komunës dhe qytetarëve tanë. Një pjesë e tyre ka përfunduar me sukses, me qëllim të përmirësimit shërbimeve dhe krijimit të kushteve më të mira.

Disa nga projektet konkrete që janë në fazë të realizimit, si dhe ato që kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe, paraqiten më poshtë të shoqëruara me përshkrime dhe detaje përkatëse:

Projektet kapitale

- Projekti me titull sipas kontratës: **“Ndërtimi i kioskave për biznese”** me numër identifikues: **KA652/25/057/521**, është projekt që ka filluar në këtë vit raportues i cili vazhdon edhe në vitin 2026.
- Projekti me titull sipas kontratës: **“Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi gurin e shpuar”** me numër identifikues: **KA652/23/010/521**, implementimi i këtij projekti ka filluar në vitin 2023 dhe punimet kanë përfunduar në vitin 2025.
- Projekti me titull sipas kontratës: **“Rregullimi i hapësirave rekreative, Faza e I – rë”** me numër identifikues: **KA652/24/050/521** ka përfunduar në këtë vit raportues.
- Projekti me titull sipas kontratës: **“Ndërtimi i ballkonit panoramik”** me numër identifikues **KA652/25/031/521**, është projekt që po ashtu ka filluar dhe mbaruar në vitin 2025.


Qendra Komunale Për Regjistrim të Biznesit


Në funksion të biznesit lokal vepron Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit, e cila ofron mundësi për regjistrimin dhe themelimin e veprimtarive biznesore brenda një periudhe të shkurtër kohore, si dhe ofron informata për investitorët potencial, po ashtu jepen edhe këshilla për bizneset fillestare dhe ato ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve sipas nevojës. Kjo zyrë ka një

bashkëpunim të veçantë me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, ku kontakti me këtë institucion është pothuajse i përditshëm.

Gjatë periudhës raportuese kjo zyrë ka pranuar gjithsej 563 lëndë të cilat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Gjatë këtij viti janë regjistruar 150 biznese të reja, prej tyre 86 SH.P.K (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe 63 B.I (Biznese individuale). Nga këto shifra 114 biznese menaxhohen nga meshkujt ndërsa 36 nga femrat.

Qendra komunale për regjistrimin e biznesit	
Lloji i kërkesës	Numri
Biznese të reja	150
Shuarje të biznesit	08
Ndryshime në biznes	58
Çertifikatë dublikatë	19
Çertifikatë e re	11
Informata të biznesit	312
Vërtetim për biznese që nuk posedojnë taksë komunale	00
Vërtetime individuale	05
Kërkesë për zgjatje të orarit të punës	00





Veprimtaritë e bizneseve të reja kanë qenë të ndryshme por më shpeshta kanë qenë, shih tabelën më poshtë:

Aktiviteti	Numri i bizneseve
Punime për veshjen e dysHEMEVE dhe mureve	19
Tregëtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël	17
Aktivitete të tjera të specializuara ndërtimi p.k.t.	15
Tregtia e automjeteve tjera	14
Punime suvatimi	14
Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore	14
Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave	13
Aktiviteti i shërbimit të pijeve	13
Tregtia me pakicë në dyqane ku mbizotëron ushqimi dhe duhani	13
Tregtia me pakicë e mobilie dhe artikuj të tjerë shtëpiak	12
Aktivitete të tjera	06

Subvencionimi

Gjatë vitit 2025 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm ka ndarë subvencione për 18 biznese. Shuma totale e subvencioneve ka qenë 50.302.00, duke mbështetur bizneset e reja, nxitjen e ndërmarrësisë dhe krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik lokal. Kjo mbështetje ka ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë për sipërmarrësit, duke i ndihmuar ato të realizojnë idetë e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunës. Në kuadër të mbështetjes Start Up, përparësi në përfitim kanë pasur të rinjtë dhe gratë, me qëllim fuqizimin e tyre ekonomik dhe rritjen e përfshirjes në aktivitet ndërmarrës.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore në Komunën e Kaçanikut funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe në përbërje të saj ka tre zyrtar : Udhëheqësin/Menaxherin e personelit dhe dy zyrtar të lartë të personelit, të cilët zhvillojnë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me fushën e burimeve njerëzore të të gjithë të punësuarve në kuadër të Komunës, sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik .

Në fillim të vitit 2025, në kuadër të objektivave të përcaktuara për këtë vit janë caktuar edhe aktivitetet konkrete me të cilat do të merremi përkatësisht, është përgatitur plani i punës për vitin e ri kalendarik.

Poashtu, është hartuar edhe Draft Planit i personelit, i cili është aprovuar nga Kryetari i Komunes dhe MPB/DMZP. Në kuader të këtij plani janë përfshirë të gjitha titujt e vendeve të lira të punës në kuader të organizatës buxhetore të cilat duhet të plotësohen , përfundimet e marrëdhënies së punës, plani i trajnimeve etj.

Sipas Legjislacionit në fuqi dhe Planit të personelit për vitin 2025 nga zyra e personelit përmes sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ –së), janë zhvilluar 26 procedura të rekrutimit të cilat janë publikuar përmes portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe web-faqes së Komunës.

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore ka lëshuar aktemërime për nëpunësit civil dhe ka hartuar kontrata të punës për zyrtarët e shërbimit publik, vendime për kompensimin e zyrtareve publik, 7 vendime për udhëtime zyrtare jashtë vendit, vendime për pagë retroaktive, 24 vendime të pushimit të lehonisë së zyrtarëve publik, 5 vendime për pushim pa pagesë, 6 vendime për pezullime politike, vendime për qasje në dokumente publike, 1 vendim për ushtrues detyre, 46 vendime për ndërprerje/përfundime të marrëdhënies së punës, 3 përgjigje në ankesat e paraqitura në KPMSHCK, janë lëshuar edhe vërtetime mbi përvojën e punës dhe dëshmi për masë disiplinore sipas kërkesave të zyrtareve dhe kandidatëve si dhe vendime tjera për Kryetarin e komunës.

-NJMBNJ- ka njoftuar ekzekutivin e komunës për veprimet që duhet t'i ndërmarrin për zbatimin e Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe i ka ofruar raporte të rregullta lidhur me zhvillimin e të gjitha procedurave të burimeve njerëzore.

- NJMBNJ-merr pjesë në të gjitha komisionet komunale të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e procedurave të burimeve njerëzore dhe kryen detyrat si sekretari i tyre sipas Rregulloreve përkatëse në fuqi.

Sa i përket Komisioni disiplinor është zhvilluar një procedure disiplinore për të cilën është caktuar një masë disiplinore. Ndërsa në Komisionin e ankesave janë shqyrtuar 16 ankesa prej tyre 1 – e miratuar, 13 të refuzuara dhe 2 të hedhura poshtë.

Poashtu, ka shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike.

- NJMBNJ-në vazhdimësi bën kompletimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit në mënyrë fizike dhe elektronike (SIMBNJ) dhe rifreskimin e tyre.

NJMBNJ- ka përgatitur të gjithë formularët e ndryshimeve të pagave të zyrtareve publik në kuader të administratës komunale, zjarrfikësve dhe Kuvendit Komunal.

NJMBNJ- ka qasjen edhe në sistemin e pagave, në të cilin sistemi procesohen të gjitha ndryshimet në paga dhe përmes tij shkarkojmë listat e pagave dhe raportin financiar, të cilat iu dërgohen personelit për nënshkrim dhe zyrtarëve përgjegjës për kontrollimin e tyre.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Kaçanikut të cilët kanë marrë pagë nga buxheti i Komunes, në fund të vitit, respektivisht në muajin dhjetor 2025, është 797 të punësuar,

në të cilin numer jane te perfshire zyrtaret publik ne administraten komunale (115), sektorin e arsimit (524), sektorin e shëndetësisë (116) , sherbimin e zjarrfikjes (15) dhe Kuvendit Komunal (27 anetar).

Numri i përgjithshëm i të punësuarëve 2025--ne administraten Komunale, arsim dhe shendetesi(QKMF)						
Kategoria e zyrtarëve /Viti		Administrata komunale	Arsimi	Shendetsia	Gjithsej	
2025	Gra	38	278	85	401	
	Burra	77	246	31	354	
	Gjithsej	115	524	116	755	

Nëpunësit civil sipas nivelit të arsimit (ju lutem vendosni nivelin më të lartë të arsimit që ka një nëpunës)								
Kategoria funksionale	Arsimi i mesëm	Shkolla e lartë	Bachelor/ fakultet			Master	Doktoratë	totali
			3 vjeçar	4 vjeçar	5vjeçar			
Kategoria e Lartë Drejtuese	0	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria e Mesme Drejtuese	0	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria e Ulët Drejtuese	0	1	3	9	1	3	0	17
Kategoria e Specialistëve	0	0	8	0	1	1	0	10
Kategoria profesionale	8	1	23	11	0	13	1	57
Gjithsej	8	2	34	20	2	17	1	84

Të dhëna mbi të punësuarit në institucion gjatë vitit 2025

Numri i të punësuarve të përhershëm në institucion sipas gjinisë						
Kategoria e zyrtarëve /Viti		Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës Teknik dhe mbështetës	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Zyrtarë të Kabinetit
2025	Gra	5	20	4	0	3
	Burra	2	5	4	0	1
	Gjithsej	7	25	8	0	4

Zyra e Prokurimit

RAPORTI VETOR PËR KONTRATAT E NËNSHTRUARA PËRRIKË

Kontrakti nr. 17/2025 për shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.

PILSA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES			
Emri i autoritetit kontraktues	KONKUNA		
Adresa	Kompani Publike K.A652		
Adresa e kontaktit	Rruga "Agim Bajrami" P.n.		
Adresa e kontaktit	71000		
Adresa e kontaktit	0290 380 922		
Adresa e kontaktit	Izmir Kuka		
Adresa e kontaktit	izmir.kuka@ks.gov.mk		
Adresa e kontaktit	www.ks.gov.mk		

PILSA II. KONTRATAT E NËNSHTRUARA PËRRIKË																													
Lloji i Prokurimit	Në Prokurim	Të Hija Vetanake (1) ose Bushi i Konat Kosovës (2) ose Donacion (3)	Numri i tenderit i prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP)	Të Hija Vetanake (1) ose Bushi i Konat Kosovës (2) ose Donacion (3)	Data e nisimit të aktivitetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimit data e njoftimit për anulim)	Afati për implementimin e kontratës (shkruaj datën e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përmbylljes së kontratës (data e pranimit të përkrahshëm/preliminar)	Vlera e përcaktuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri i OE të cilin i është dhënë kontrata	OE vendor (1); Jo vendor (2)	Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara	Numri i ofertave të refuzuara (shkruaj vetëm ato me çmimin më të ulët në krahasim me fituesin)	Afati i kohës normal (1) Afati i kohës i shkurtuar (2)	Çmimi më i ulët (1) Tëndër ekonomikisht më i favorshëm (2)	Afati i kohës për dhënie kontrate	Afati i kohës për dhënie kontrate		
001	5	2	5	45	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2024	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
002	16	1	0		Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2024	15.01.2025			07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
003	2	3	6	45	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
004	5	2	1	45	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
005	3	2	5	45	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
006	1	2	1	25	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
007	5	2	5	45	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
008	5	2	1	45	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				
009	1	2	1	20	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	Regulim dhe shërbime të ndërtimit të rrugës në fshat Durrës, bashkia e Durrësit.	24.01.2025	15.01.2025	20.02.2025	21.02.2025	07.02.2025 - 11.03.2025	27.02.2025	€ 3,900.00	€ 27,240.00	€ 27,240.00				REMA COMPANY Shtp	100	100	1	0				

2	071	1	3	6	17	Furnizim me untkoma për rrevolet e punitorëve të OKMF-së	07.02.2025	08.11.2025	09.12.2025	08.12.2025	08.12.2025	08.12.2025	23.12.2025	23.12.2025	€ 5,300.00	€ 3,057.00	€ 3,057.00	"RIMI ALTEX"	1.00	17.00	2	0	1	1
12	072	1	2	5	20	Furnizim me lende qezave Pabai	04.04.2025	29.05.2025	24.11.2025	02.12.2025	02.12.2025	01.01.2026	24.12.2025	24.12.2025	€ 39,000.00	€ 39,000.00	€ 39,000.00	"LALAY" Shpk	1.00	1.00	1	0	1	1
						Furnizim me shërbime qortike për punëtorët e Komandës dhe Institutit të Përkrahjes	10.07.2025	11.11.2025	24.12.2025	26.12.2025	26.12.2025	29.12.2025	28.12.2025	28.12.2025	€ 80,000.00	€ 55,179.50	€ 0.00	"INTER GRAP" L.L.C.	1.00	14.00	3	0	1	1
12	073	1	2	1											€ 999.00	€ 999.00	€ 999.00	Blerëria Kasa Allu	1.00	3.00	1	0	1	1
2	074	1	4	7	93	Vizatimi i marutit	27.10.2025	11.11.2025		17.11.2025	17.11.2025	15.12.2025	25.11.2025	25.11.2025	€ 999.00	€ 999.00	€ 999.00		1.00	3.00	1	0	1	1
12	075	3	3	8	20	Furnizim me shërbime për emetimet e letës	30.10.2025	14.11.2025	09.12.2025	09.12.2025	09.12.2025	09.12.2025	19.12.2025	19.12.2025	€ 13,500.00	€ 9,153.00	€ 9,153.00	"KOSPROD" Shpk	1.00	25.00	3	0	1	1
	076	1	4	7		Furnizim me material për zyrë	23.11.2025	26.11.2025		01.12.2025	01.12.2025	01.12.2025	03.12.2025	03.12.2025	€ 998.00	€ 994.00	€ 994.00	"LIBRARIJA" TILINDIA	1.00	3.00	1	0	1	1
	077	1	4	7		Furnizim me internet për shërbime për kërkim dhe analizë	15.09.2025	27.11.2025		08.12.2025	08.12.2025	08.12.2025	04.12.2025	04.12.2025	€ 990.00	€ 990.00	€ 990.00	"ELEKTRA" L.L.C	1.00	3.00	1	0	1	1
12	078	3	2	3	45	Rikartimi dhe rregullimi i letrësve sipas nevojës të Komandës dhe Institutit të Përkrahjes	14.10.2025	27.11.2025	10.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	22.12.2025	22.12.2025	€ 25,595.00	€ 25,595.45	25,595.45	"NMP" A.T.C. COH"	1.00	1.00	1	0	1	1
12	079				45	Furnizim me shërbime të qortike për punëtorët e Komandës dhe Institutit të Përkrahjes	13.11.2025	09.12.2025	11.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	12.12.2025	€ 83,100.00	€ 83,100.00	€ 83,100.00	"NTSH" DARDANAI	1.00	2.00	2	0	1	1
2	080	1	4	7	93	Furnizim me material për zyrë për QEPAP	26.11.2025	11.12.2025		15.12.2025	15.12.2025	15.12.2025	17.12.2025	17.12.2025	€ 990.00	€ 990.00	€ 990.00	Osman Berisha BI	1.00	3.00	1	0	1	1
12	081	5	2	5	45	Rikartimi i letrësve sipas Komandës dhe Institutit të Përkrahjes	29.10.2025	11.12.2025	16.12.2025	17.12.2025	17.12.2025	08.01.2026	23.12.2025	23.12.2025	€ 13,915.43	€ 13,915.15	€ 13,915.15	"PLUS TRADE" L.L.C	1.00	1.00	1	0	1	1
12	082	5	3	5	45	Rikartimi i letrësve sipas Komandës dhe Institutit të Përkrahjes	01.09.2025	11.12.2025	16.12.2025	17.12.2025	17.12.2025	17.12.2025	23.12.2025	23.12.2025	€ 4,900.00	€ 4,896.50	€ 4,896.50	"NTSH" PAR DRIT"	1.00	1.00	1	0	1	1
2	083	1	4	7		Shërbimet e zellit për festat e mëdha	01.12.2025	11.12.2025		15.12.2025	15.12.2025	15.12.2025	16.12.2025	16.12.2025	€ 999.00	€ 998.50	€ 998.50	NSH "FBT"	1.00	3.00	1	0	1	1
						TOTALI									€ 3,589,699.24	€ 3,325,085.80	€ 0.00	€ 0.00	€ 2,452,131.53					

Zyra Ligjore

Ky raport ofron një pasqyrë të hollësishme të aktiviteteve ligjore që janë zhvilluar gjatë këtij viti, duke përfshirë lëndët civile, penale, përmbartimore dhe administrative që kanë qenë në trajtim nga Komuna e Kaçanikut. Gjatë këtij viti, përfaqësuesi-Zyra Ligjore ka pasur një angazhim të madh dhe ka luajtur një rol kyç në mbrojtjen e interesave të Komunës.

Aktivitete kryesore të realizuara

Në periudhën janar-dhjetor 2025, Zyra Ligjore ka qenë e angazhuar në shumë procedura gjyqësore, me qëllim mbrojtjen e të drejtave ligjore të Komunës së Kaçanikut. Gjatë këtij viti, janë mbajtur gjithsej **102 seanca të ndryshme gjyqësore** në gjykatat e Republikës së Kosovës. Këto seanca kanë përfshirë një gamë të gjerë çështjesh, të cilat kanë kërkuar vëmendje të theksuar dhe përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një zgjidhje të drejtë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka qenë **dhënia e 114 përgjigjeve në padi**, ku Zyra Ligjore ka trajtuar paditë që kanë ardhur gjatë këtij viti. Përgjigjet janë ofruar me qëllim të mbrojtjes së interesave të Komunës dhe për të garantuar që vendimet gjyqësore të jenë në përputhje me ligjin.

Po ashtu, janë **paraqitur 42 ankesa në Gjykatën e Apelit**, duke kërkuar rishikimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për këtë arsye, Zyra Ligjore ka vazhduar të angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që çdo vendim që ndikon në të drejtat e Komunës të shqyrtohet dhe të rivlerësohet, në përputhje me parimet e drejtësisë.

Një tjetër aspekt që ka pasur një rëndësi të veçantë këtë vit kanë qenë **3 Revizionet në Gjykatën Supreme të Kosovës**, ku janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe me ndikim të gjerë për administratën komunale. Këto revizione kanë kërkuar një analizë të thellë të vendimeve të mëparshme dhe kanë pasur për qëllim sigurimin e një vendimmarrjeje të drejtë dhe të barabartë.

Po ashtu, janë realizuar **shumë pajtime gjyqësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj–Dega Kaçanik**, duke siguruar që lëndët të zgjidhen me marrëveshje dhe pa shkuar në faza të mëtejshme gjyqësore. Këto pajtime kanë kontribuar në kursimin e kohës dhe burimeve (financave).

Në fushën e përmbartimit, janë realizuar **20 propozime për përmbartim, përgjigje në prapësime dhe prapësime**, duke u siguruar që çdo kërkesë për zbardhjen e detyrimeve ligjore të përmbushet në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë. Për më tepër, Zyra Ligjore ka ofruar këshilla të vazhdueshme për zyrtarët dhe drejtorët e ndryshëm të Komunës, me qëllim të përmirësimit të procedurave dhe praktikave ligjore brenda administratës komunale.

Lëndët më të shpeshta dhe sfidat ligjore

Një nga fushat më të theksuara gjatë vitit 2025 kanë qenë paditë që lidhen me **Kontratën Kolektive në Arsim dhe Shëndetësi**. Paditë për kompensim kualifikimi, për kompensim të shujtave, për kompensim të udhëtimit, si dhe paditë për kompensim të pagave jubilarë janë kategorizuar si më të shpeshtat. Këto çështje kanë kërkuar një trajtim të veçantë dhe një angazhim të vazhdueshëm.

Një tjetër grup padish që ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në aktivitetet e Zyrës Ligjore janë **paditë për vërtetim pronësie**, të cilat kanë kërkuar një shqyrtim të detajuar të dokumenteve dhe pasurisë së Komunës.

Një tjetër kategori e padive ka qenë **paditë për kompensim dëmi**, sidomos ato që lidhen me projektet e shtrimit të rrugëve që ka realizuar Komuna e Kaçanikut. Qytetarë të ndryshëm kanë ngritur padi për dëmtimin e pronave private gjatë realizimit të këtyre projekteve infrastrukturore. Zyra Ligjore ka pasur një rol të rëndësishëm në trajtimin e këtyre padive dhe në mbrojtjen e interesave të Komunës.

Përfundimi dhe angazhimi i vazhdueshëm

Në përfundim, Përfaqësuesi i Komunës-Zyra Ligjore e Komunës së Kaçanikut ka realizuar një punë të jashtëzakonshme gjatë vitit 2025, duke mbrojtur interesat e Komunës nëpërmjet angazhimeve të vazhdueshme ligjore dhe përpjekjeve për të siguruar një përfaqësim dhe mbrojtje të Komunës sa më të mirë. Aktivitetet ligjore të realizuara gjatë këtij viti kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në menaxhimin e çështjeve ligjore dhe në sigurimin e zbatimit të ligjit.

Zyra Ligjore mbetet e përkushtuar që edhe në të ardhmen të vazhdojë me të njëjtin intensitet dhe përgjegjësi në mbrojtjen e interesave të komunës, në përmirësimin e proceseve ligjore dhe në mbështetjen e zhvillimit institucional të Komunës së Kaçanikut.

Zyra e Inspektoratit

Spektori i Inspektoratit

Spektori i inspektoratit është organ i administratës, fushë - veprimtaria e së cilit është përcjellja, monitorimi dhe marrja e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve administrative, në funksion të mbikëqyrjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi.

Spektori i inspektoratit vepron në kuadër të zyrës së kryetarit.

Spektori i inspektoratit në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi të saj, ushtron aktivitetet e mbikëqyrjes inspektuese nga:

- Inspektori i Komunikacionit,
- Inspektori i Tregut,
- Inspektori i Mjedisit,
- Inspektori i Shërbimeve Publike,
- Inspektori i Ndërtimit,

Gjatë vitit 2025, kemi pasur shumë sfida dhe të cilat kemi arritur t'i tejkalojmë në bashkëpunim të ndërsjellë me ekzekutivin e komunës, përfshirë kryetarin e komunës, nënkryetarin e komunës, drejtoritë komunale, policinë e Kosovës por edhe me palët e ndryshme në terren.

Kemi pasur inspektime të përbashkëta edhe me policinë e Kosovës, ku kemi bërë largimin e shitësve ambulant nëpër disa rrugë të qytetit, pastaj kemi bërë lirim të disa parkingjeve ilegale nëpër rrugë të qytetit, ku ne si inspektorat paraprakisht kemi bërë identifikimin e veturave të parkuara në kundërshtim me ligjin e trafikut. Njëkohësisht kemi bërë lirim të vend parkimeve të caktuara për taksit, por që nuk respektohet nga ngasësit e tjerë në komunikacion.

Inspektime kemi pasur edhe me inspektorët sanitar që janë nën kompetencë të nivelit qendror, ku kemi kryer inspektime duke filluar nga furrat e bukës, markete të ndryshme etj.

Inspektime kemi pasur ndaj operatorëve me autobusë, kombi taksit, auto taksit, inspektime në mosrespektimin e orarit të punës nga disa biznese, inspektime të çmimoreve të artikujve të ndryshëm, inspektime për afat të skadimit – artikujve të ndryshme, inspektime në mbrojtjen e mjedisit – hedhja e mbeturinave, inspektime të ndërtimeve të objekteve pa leje komunale, ndërhyrje të ndryshme në infrastrukturë komunale pa leje paraprake nga organet komunale dhe probleme të ngjashme.

Sipas planit të paraparë të punës për vitin 2025, kemi arritur të kryejmë inspektime pas orarit të rregullt të punës (gjatë muajit të ramazanit) – inspektime pas iftarit.

Kemi pasur inspektime pothuajse të rregullta në orët e mbrëmjes në sezonin veror, pra në sezonin kur në pushime kemi mërgimtarët.

Kemi zbatuar planin vjetor të punës së sektorit të inspektoratit për vitin 2025, ku të parapara kanë qenë inspektimet jashtë orarit të rregullt të punës por edhe ditëve të pushimit.

Vlen të potencohet se policia e Kosovës na u kanë përgjigjur sa herë kemi kërkuar nga ta që të na asistojnë.

Njëherit ju njoftojmë se policia e Kosovës, përmes raporteve të oficerit na njofton për raste të ndryshme që qytetarët i paraqesin në policinë e Kosovës, e që për të vepruar është e domosdoshme

të mirret inspeksioni komunal e ku pastaj inspektorë të lëmive përkatëse marrin veprime konkrete ndaj shkelësve të këtyre rregulloreve komunale apo ligjeve në fuqi.

Kemi raste që nga policia e Kosovës pranojmë raporte të ndryshme oficeri, që nuk janë nën kompetenca të inspeksionit, por këto lëndë me shkresa përcjellëse i adresojmë nëpër drejtori komunale varësisht prej kompetencave, ku pastaj drejtoritë mirren me rastet që i takojnë.

Inspektori i Komunikacionit

Gjatë këtij vitit janë kryer 100 inspektime të vazhdueshme në transportin publik të udhëtarëve, në lëminë e komunikacionit rrugorë dhe 38 inspektime të përbashkëta me inspektorët komunal të lëmive të ndryshme si dhe kemi kryer punë tjera shtesë të angazhuara me vendime.

Në lëminë e transportit publik të udhëtarëve kemi 15 procesverbale të ndryshme, prej tyre:

01 – procesverbal me vërejtje për ndërprerjen e veprimtarisë pa leje pune, konfiskim shenja taksi - e kryer,

03 – procesverbale identifikimi i dokumentacioneve - të kryera,

02 – procesverbale – urdhëresë për kryerjen e kontrollës teknike periodike - të kryera,

04 – procesverbale – urdhëresë për plotësim dokumenteve, certifikatën e mjekut, çmimoret dhe fletë urdhëresën e rrugës, aparatën për fikjen e zjarrit – të kryera,

01 – procesverbal – urdhëresë për plotësim të dokumentacioneve si: leje pune, regjistrim të autobusit, certifikatë të mjekut, aparati për fikjen e zjarrit – e kryer,

02 – procesverbal – urdhëresë për vazhdimin e lejes së punës, kontrollë teknike periodike, aparatën për fikjen e zjarrit, kryerjen e shërbimit brenda stacionit të autobusëve – të kryera,

02 – procesverbal – urdhëresë për ndërprerje të ushtrimit të veprimtarisë pa u pajisur me leje pune dhe rend të udhëtimit – të kryera,

06 – vërejtje verbale për kryerjen e kontrollimit teknik periodik, certifikata të mjekut, aparatën për fikjen e zjarrit – të kryera,

04 – gjoba mandatorë me aktvendim - të kryera (03),

01 – propozim për përmbarim – procedure.

Kemi pranuar një ankesë, e cila është shqyrtuar.

Kemi bërë një kërkesë Inspektoratit qendror të punës – të njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje.

Kemi pranuar dy raporte mujore nga stacioni i autobusëve në Kaçanik rreth operimit të operatorëve të transportit publik të udhëtarëve.

Në lëminë e komunikacionit rrugor - Sinjalizimi horizontal dhe vertikal, ngarkim dhe shkarkim të mallrave - kemi 12 procesverbale:

01 – procesverbale për mosrespektim të shenjës së komunikacionit, (03) gjoba të lëshuara nga ana e policisë së Kosovës – stacioni policor në Kaçanik – e kryer

01 – procesverbal për ndërhyrje në shenjat e komunikacionit – e kryer,

01 – procesverbal – urdhëresë për largimin e pengesës (policë të shtrirë) në rrugë pa leje komunale - e kryer,

09 – procesverbale – urdhëresa për pajisje me leje për ngarkim dhe shkarkim të mallrave – të kryera,

02 – Inspektime të kryera në parkingje publike, njërin prej tyre në bashkëpunim me policinë e Kosovës,

03 – vërejtje verbale për pajisje me leje për ngarkim shkarkim të mallrave – të kryera,

02 – gjoba mandatorë me aktvendim - të kryera,

Kemi lëshuar një urdhëresë për rregullim të shenjave të komunikacionit – e kryer,

Kemi lëshuar një pëlqim për pengesë në rrugë (Policë të shtrirë),
 Kemi pranuar tre raporte të oficerit nga stacioni policor në Kaçanik – për ndërhyrje dhe vendosjen e shenjave të komunikacionit si dhe eliminim të parkingjeve- iu kemi përgjigjur,
 Kemi bërë një kërkesë KRU Bifurkacionit – njësia Kaçanik, që gjatë zhvillimeve të punimeve në rrugë të bëjnë shënimin me sinjalizim përkatës të punimeve në rrugë.
 Kemi bërë 06 kërkesa DESHP-së, për rregullimin e shenjave të komunikacionit, ku prej tyre janë identifikuar 10 shenja të dëmtuara dhe prej tyre iu kanë përgjigjur dy (02) kërkesave,
 Kemi dhënë një njoftim në stacionin policor në Kaçanik lidhur me një shenjë të dëmtuar.
 Futja në databazë e shenjave horizontale dhe vertikale të dëmtuara-të rregulluara në teren.

Punë tjera:

Një inspektim i përbashkët me Inspektorët komunal me procesverbal, përgjigje kërkesës së ATK-së,

Komision në angazhimin e punës për performancë komunale, për fushën e transportit publik të udhëtarëve,

Komision për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Transport Publik të Udhëtarëve,

Komision për vlerësimin e mundësisë së shfrytëzimit të një rruge alternative nga operatorët e gurëthyesve që qarkullojnë në rrugën e fshatit Gajre - Kaçanik – për të cilin kemi dhënë rekomandime,

Komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën komunale, gjatë zhvillimit të punimeve në projektin e ndërtimit të hekurudhës së Kosovës,

Kemi asistuar edhe te inspektorët e lëmive tjera si të Shërbimeve Publike – 17 asistime, Ndërtimit – 5 asistime, Tregut – 2 asistime, Mjedisit – 4 asistime, Menaxherit të sinjalizimit - 5 asistime dhe me Policinë e Kosovës - 4 inspektime të përbashkëta,

Trajnim – seminar të organizuar nga Zyra e Inspektoratit të Përgjithshëm me temën: Krijimi i modulit MIS (Managment Information System).

Inspektori i Tregut

Përmes kësaj shkrese ua dërgojmë raportin e punës së Inspektorit të Tregut për vitin 2025;

➤ Gjoha mandatore	06
➤ Shuma e gjobave mandatore	1600€
➤ Inspektime për parandalimin e ekonomisë jo formale	148
➤ Pranime teknike	09
➤ Aktvendime	15
➤ Urdhëresa	82
➤ Njoftim dhe shkresa zyrtare.....	02
➤ Intervenime rreth vendosjes së orarit të punës dhe mbishkrimit të firmës.....	25

- Plan operativ për mbykqyrjen e respektimit të kujdestarisë së natës nga Barnatoret Farmaceutike
 - Inspektim gjatë natës dhe në muajin e ramazanit;
- Plan Operativ lidhur me transportin e mallrave pa dokumente
 - Inspektimet janë kryer së bashku edhe me Policinë
- Dalja dhe kontrollimi rreth rrespektimit të orarit të punës edhe gjatë natës në bashkëpunim me policinë.
- Inspektim i subjekteve të cilat veprojnë me karburante lidhur me licencat për gaz dhe karburant si dhe dokumentacionet tjera.
- Inspektim rreth zbatimit të ligjit për duhan.

Largimi duhanit nga shitja në vende të ekspozuara,

Largimi i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo ushqimore e të ngjajshme me duhanin,

- Inspektimi i vendosjes së deklaracionit të artikujve ushqimorë,
- Largimi i shitësve ambulant.
- Kontrollimi i të gjitha furrave të bukës në Komunën e Kaçanikut si dhe matja e peshës së bukës,
- Kontrollimi i vendosjes së çmimeve për artikujt ushqimor,
- Kontrollimi i ciëlsisë së mallit me Inspektorin sanitar dhe konfiskimi i mallit.

Inspektori i Shërbimeve Publike

- Ka kryer inspektime nga më të ndryshmet, duke filluar nga:
- Largimi i barrierave – pengesave nëpër rrugë të vendosura pa leje komunale,
- Largimi i shitësve ambulant të cilët mallin e tyre e ekspozojnë nëpër hapësira të ndaluara,
- Largimin e reklamave të vendosura nëpër hapësira publike nga qytetarët, pa pëlqim paraprak nga organet komunale.
- Ka intervenuar në kompanitë transportuese të cilat gjatë bartjes me cisterna të betonit, shpesh ka ndodhur që të bie betoni nga mbushja e tepërt e cisternës dhe të bie nëpër rrugë të asfaltuara.
- Ka kryer inspektime në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit ku shpeshherë kemi pasur raste që pasi kemi identifikuar problemin e rrjedhjes së ujit, kanalizimit apo rrjedhje të ujërave atmosferike nëpër hapësira publike, rrugë të asfaltuara, rrugë të pa asfaltuara etj, dhe kemi urdhëruar kompaninë K.R.U “Bifurkacioni” e të cilët kanë arritur të bëjnë intervenimin dhe zgjidhjen e problemeve në terren.
- Megjithatë problem në vete po na paraqet pajisja me leje për ndërhyrje në infrastrukturën komunale, ku kompania që po e kryen punën e vet duke bërë prerjen dhe dëmtimin e shtresës së asfaltit dhe në fund vend punishtja mbetet e mbushur me dheun apo zhavorin por që nuk po asfaltohet e që me kalimin e kohës këto ndërhyrje po bëhen të gjitha gropa në rrugë apo në trotuare dhe që paraqesin rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.
- Inspektori i shërbimeve publike ka marr masa për lirim të trotuareve duke bërë largimin e karrigeve dhe tavolinave të vendosura pa leje komunale.

- Inspektori i shërbimeve publike në bashkëpunim me inspektorë tjerë dhe në asistim të policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Kaçanik, ka bërë zbatimin e planit për inspektime, i hartuar nga sektori i inspektoratit.
- Inspektori i shërbimeve publike ka kryer gjithsej 65 inspektime, prej tyre 52 procesverbale kurse 23 inspektime kanë qenë asistim ndaj inspektorëve të lëmive tjera.
- Inspektori i përgjithshëm pothuajse tërë kohën ka qenë në inspektim të përbashkët me inspektorin e shërbimeve publike por edhe në zëvendësime të inspektorëve tjerë.

Inspektori Mjedisor

Përmes këtij raporti po ju njoftojmë, për punën dhe aktivitetet të cilat i kemi realizuar gjatë kësaj gjatë vitit 2025 në lëminë e mjedisit.

Ujërat

Për vitin 2025 nuk kemi pasur asnjë rast të eksploatimit ilegal të zhavorrit në lumenj dhe gjendja e lumenjve është nën kontroll.

Problematika kryesore e lumenjve mbetet shkarkimi i ujërave të zeza pa asnjë trajtim adekuat në lumin Lepenc dhe lumin Nerodime nga vendbanimet e komunës sonë dhe komunat fqinje.

Një problematikë tjetër është shfrytëzimi i resurseve ujore në mënyrë të pakontrolluar, kryesisht burimeve ujore për nevojat e amvisërisë në pjesën e maleve të Sharrit.

Mbeturinat

Komuna e Kaçanikut në vazhdimësi ka arritur të përmirësoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave, aktualisht shërbimi i grumbullimit të mbeturinave mbulon pothuajse tërë vendbanimeve të komunës sonë.

Një sfidë në këtë drejtim mbetet mbulimi, ofrimi dhe futja në sistemin e shërbimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët në zonat ku ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave.

Përkundër përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave një nga problematikat kryesore të menaxhimit të mbeturinave mbetet mos funksionalizimi i një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.

Pyjet

Pyjet janë pasuri e jashtëzakonshme e një vendi, shfrytëzimi racional dhe i kontrolluar i tyre ndikon në zhvillimin e turizmit, blegtorisë, industrisë. Mirëpo fatkeqësisht në komunën tonë prerja dhe degradimi i pyjeve është në gjendje shumë shqetësuese. Kjo vjen si pasojë e menaxhimit të dobët dhe mos llogaridhënies nga institucionet të cilat menaxhojnë me pjesën e pyjeve në Parkun Nacional Sharri. Përkundër se komuna ka kompetenca shumë të kufizuara në pjesën e Parkut Nacional Sharri, vazhdimisht e ka ngritur si shqetësim duke drejtuar shkresa te të gjitha institucionet për prerjen e pyjeve, mirëpo këto kërkesa asnjëherë nuk janë trajtuar me prioritet.

Krahas prerjes ilegale të pyjeve, në zonën e Lubotinit një dukuri e cila po merre përmasa mjaft shqetësuese është aplikimi i sporteve ekstreme, gjë që përdorimi i pajisjeve motorike (motokrosave, motorave me 4 rrota) të cilat krijojnë zhurmë dhe djegie të gazrave ndikon negativisht në mjedis duke cenuar ekuilibrin e zonës strikt të mbrojtur.

Po ashtu, kjo ndikon negativisht edhe te numri i turistëve dhe qytetarëve që bëjnë ecje në natyrë.

Resurset natyrore

Komuna e Kaçanikut është mjaft e pasur me resurse natyrore e në veçanti me gur gëlqeror. Në komunën tonë operojnë 10 operatorë të licencuar të cilët merren me shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror.

Licencat dhe kontrollin për shfrytëzimin e resurseve minerale e bën Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Inspektorati komunal në vazhdimësi kryen kontrolle të përbashkëta me Inspektoratin e KPMM-së në këtë fushë.

Pra, edhe ky sektorë është nën kontroll dhe nuk kemi raste të shfrytëzimit ilegal të resurseve natyrore.

Zonat e mbrojtura

Komuna e Kaçanikut njihet për malet, lumenjtë, grykën e Kaçanikut dhe peizazhin e mrekullueshëm.

Janë të evidentuara dhe të mbrojtura 14 monumente natyrore: 9 prej të cilave janë monumente me karakter botanik, 2 monumente me karakter spelologjik, 2 monumente me karakter gjeomorfologjik si dhe 1 kompleks i pishave si peizazh i mbrojtur.

Kompleksi i pishave gjendet në zonën turistike të fshatit Strazhë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 25 ha. Peizazhi ka vlera natyrore turistike, rekreative dhe estetike.

Sipas rekomandimeve të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, komuna e Kaçanikut është e obliguar që të hartojë një plan për menaxhimin e peizazhit të mbrojtur si dhe të bëjë rrethojën e saj.

- Lëndët - gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar 28 lëndë
- Procesverbalet - gjatë vitit 2025 janë hartuar 15 procesverbale
- Gjjobat - janë shqiptuar 2 mandatore në vlerë prej 1500€

Aktivitete të tjera: inspektime të përbashkëta me inspektorët e lëmive të tjera, urdhëresa dhe vërejtje verbale për qytetarë për eliminimin e shkeljeve të ndryshme, pjesë e grupit punues për hartimin e Planit Strategjik për Zhvillimin Ekonomik Lokal të komunës së Kaçanikut (2025-2030).

Sfidat brenda institucionit

Puna dhe aktivitetet e inspektoratit komunal janë të ndërlidhura edhe me projektet, lejet apo pëlqimet që lëshohen nga komuna. Sfidat me të cilat është ballafaquar inspektorati si pasojë e aktiviteteve nga vet institucioni janë:

Deponite e mbeturinave – Inspektorati komunal ka identifikuar lokacione në territorin e komunës së Kaçanikut, ku si pasojë e hedhjes së materialeve inerte nga implementimi i projekteve të ndryshme nga vet komuna e Kaçanikut, janë krijuar deponi ilegale të mbeturinave.

Këto deponi kryesisht janë krijuar gjatë rikonstruimit të rrugëve dhe rrënimit të objekteve të ndryshme.

Rekomandimet

Duke u analizuar gjendjen e mjedisit në komunën e Kaçanikut është e nevojshme të ndërmerren këto hapa:

- Komuna e Kaçanikut të pajiset me leje mjedisore për çdo projekt i cili ka ndikim në mjedis. Komuna të pajiset me leje për çdo projekt që sipas legjislacionit në fuqi duhet ti nënshtrohet lejeve mjedisore, lejeve komunale mjedisore, lejeve ujore apo vlerësimit të ndikimit në mjedis, ngase realizmi i projekteve të caktuara ka ndikuar në ndotjen dhe degradimin e mjedisit.
- Të trajtohet me prioritet funksionalizimi i lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte, ngase si pasojë e mos funksionalizimit të këtij lokacioni po krijohen deponi ilegale. Shpeshherë krijimit të këtyre deponive ilegale i kontribuon edhe vet komuna si institucion gjatë realizmit të projekteve të ndryshme siç janë: punimi i rrugëve (deponimi i asfaltit të larguar nga rruga në hapësira publike), rrënimi i objekteve të ndryshme dhe hedhja e materialeve inerte në hapësira publike.
- Largimi i mbeturinave ilegale të mbeturinave të bëhet në bashkëpunim me Inspektoratin Mjedisor, të jemi të informuar së cilat deponi ilegale të mbeturinave janë larguar brenda vitit. Dhe pastaj ato hapësira do të monitorohen në vazhdimësi nga inspektorati mjedisor.
- Hartimi i një plani operativ për mbulimin e 100% të ekonomive familjare dhe bizneseve në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në zonat ku ofrohet ky shërbim.
- Të organizohen takime dhe të bëhen hapa konkret duke e rrit presionin te institucionet përgjegjëse për menaxhimin e Parkut Nacional Sharri për ndalimin e prerjes dhe degradimin e pyjeve me ritme shumë shqetësuese.
- Drejtoritë komunale të hartojnë planet komunale të cilat dalin si obligim nga legjislacioni mjedisor.

Inspektori i Ndërtimit

Përmes këtij raporti vjetor, paraqitet puna e inspektorit të ndërtimit, ku gjatë vitit 2025 kemi pasur sfida të ndryshme e që kemi arritur t'i përfundojmë me sukses.

Bazuar në autorizimet ligjore, inspektori i ndërtimit ka marrë të gjitha masat e duhura për pengimin e ndërtimeve pa leje në teritorin e Kaçanikut, kontrollimin e të gjitha objekteve të pajisura me leje ndërtimore, materialit ndërtimorë, kushteve ndërtimore, dokumentacionit teknik të objekteve si dhe mbrojtja e shëndetit publik me rastin e kryerjes së punëve ndërtimore.

Të gjitha kërkesat e parashtruara pranë zyrës së inspektorit të ndërtimit, janë kryer në afatin ligjor dhe sipas detyrës zyrtare.

Janë kryer kontrollime të objekteve ndërtimore, në bazë të kërkesave të investitorëve, me qëllim të kontrollimit të armaturës dhe betonit si dhe produkteve ndërtimore ku iu është urdhëruar edhe

marrja e mostrave të betonit, respektimi në përgjithësi i projektit dhe mbajtja me rregull e librit dhe ditarit ndërtimorë si dhe rrethimi i vendpunishtes.

Kemi pasur raste të ndërprerjeve të punimeve pa leje paraprake nga organet komunale.

Njëkohësisht nëpër këto objekteve kemi bërë vendosjen e shiritave dhe shenjave me të cilat i kemi ndaluar punimet pa leje paraprake.

Kemi pasur disa intervenime për ndërprerje të punimeve pa leje ndërtimi:

Informatë - se në fshatin Strazhë janë duke u ndërtuar tri vila pa leje në pronë shtetërore – Me të pranuar informatën, së bashku me policinë e krimeve mjedisore nga Prishtina, me inspektorë të ministrisë së mjedisit dhe inspektorët komunal – inspektori i ndërtimit dhe inspektori mjedisor kemi dal në vendin e ngjarjes dhe kemi hasur në punime pa leje paraprake komunale, por që prona ishte private dhe nuk ishte pronë shtetërore. Inspektori i ndërtimit së bashku me inspektorin mjedisor kanë marr masa duke bërë ndërprerjen e menjëhershme të punimeve pa leje, kanë vendosur shiritat për ndërprerje të punimeve, ku inspektori i ndërtimit ka shqiptuar gjobë ndaj pronarit i cili kishte aplikuar për tu pajisur me leje, por që ende nuk ishte pajisur me leje ndërtimi. Me këtë lëndë janë të informuar edhe policia - departamenti e krimeve të rënda ekonomike - Ferizaj, pasi që po të njëjtit e kishin njoftimin (sikur edhe ne inspektorati) për punime pa leje në fshatin Strazhë.

Këtë rast e kemi inspektuar kohë pas kohe dhe në momentin e pajisjes së pronarit me leje ndërtimi, inspeksioni e ka lejuar pronarin që të vazhdoj me punimet.

Njëkohësisht inspektori i ndërtimit ka bërë ndërprerjen e punimeve të 05 vilave në Strazhë të filluara nga një pronarë, për të cilët inspektori i ndërtimit ka bërë edhe ri – inspektime. Ka shqiptuar gjobë pronarit për moszbatim të urdhëresës së inspektorit dhe në fund ka kompletuar lëndën dhe e ka dërguar në prokurori.

Njëjtë ka vepruar edhe me një ndërtim tjetër pa leje në Strazhë, ku pronari ka filluar punimet pa u pajisur me leje, e që të njëjtë i shqiptohet gjoba dhe lënda i dërgohet në prokurori.

- Gjatë kësaj periudhe (2025) janë kryer gjithsejtë 42 inspektime dhe 22 inspektime me inspektorët tjerë.
- Janë bërë 23 procesverbale me urdhëresa për ndërprerje të punimeve dhe kontrolleve sistematike të punëve.
- Kemi pas shtatë ankesa , të cilat i kemi trajtuar menjëherë dhe kemi marr masat e nevojshme sa na përket neve si inspektion.
- Janë shqiptuar gjoba në total 750 euro për mos informim dhe punim pa leje ndërtimi, të cilat janë paguar në afatin prej 7 ditësh dhe janë konfirmuar me flet pagesë nga pala.
- Një rast të ndërprerjes së punës me asistim të policisë dhe inspektoratin e ministrisë së ambientit.
- Kemi bërë inspektime dhe ri inspektime sipas kërkesave për inspektim, kontrolla të cilësisë dhe kontrollim i dokumentacioneve me listë kontrolli.

Rekomandim: Drejtoria e Urbanizmit të respektoj ligjin e ndërtimit në lëshimin e vendimeve të lejeve të ndërtimit të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shkresat të unifikohen sipas formave të përcaktuara në udhëzimin administrativ për lëshimin e lejes ndërtimore.

Zyra e Teknologjisë Informative dhe Zyra e Informimit

Sektori për Komunikim me Publikun dhe Sektori për Teknologji Informative, i cili funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2025 ka shënuar suksese domethënëse në fushën e informimit publik dhe të teknologjisë informative, në shërbim të aktiviteteve të Komunës së Kaçanikut.

Gjatë këtij viti, ky sektor ka arritur të sigurojë shpërndarjen e rregullt, të saktë dhe në kohë të informacioneve që lidhen me aktivitetet e Zyrës së Kryetarit të Komunës, të drejtorive komunale si dhe Kuvendit Komunal.

Pasqyrimi i drejtë dhe i paanshëm i ngjarjeve që zhvillohen për dhe nga Komuna e Kaçanikut është përmbushur si mision themelor i Sektorit për Komunikim me Publikun dhe Teknologji Informative, përmes përcjelljes dhe publikimit të plotë të veprimtarisë së organeve të administratës komunale, pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ.

Sfida kryesore gjatë vitit që lamë pas ka qenë bartja e dokumentacionit nga uebfaqja e vjetër në uebfaqen e re të Komunës, proces i cili është shoqëruar me mungesë të theksuar të dokumenteve të fshira nga uebfaqja e mëparshme. Pavarësisht këtyre vështirësive, Zyra për Teknologji Informative ka arritur të publikojë dhe ripublikojë qindra dokumente me rëndësi të veçantë për qytetarët në uebfaqen e re zyrtare.

Në planin e dokumenteve strategjike, janë përmbushur të gjitha obligimet dhe kërkesat e nivelit qendror, përkatësisht të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), sa i përket miratimit të dokumenteve që kanë për synim nritjen e transparencës komunale.

Gjatë vitit 2025, Zyra ka organizuar konsultime publike, takime publike, dëgjime buxhetore dhe takime buxhetore me pjesëmarrje aktive të qytetarëve.

Janë mbajtur konsultimet publike si në vijim:

- Konsultim publik për Draft-Rregulloren për Transparencë të Komunës së Kaçanikut dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025–2028
- Draft rregullore për Taksa dhe Tarifa dhe ngarkesa komunale
- Draft Rregullore për Transportin Publik në territorin e Komunës

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjithsej 9 dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit të Komunës për vitin 2025, të zhvilluara në sallën e Kuvendit të Komunës si dhe në ambiente të tjera si tek Palestra Sportive dhe te Shtëpia e Kulturës, me grupe të ndryshme të interes.

Janë organizuar gjithashtu dy takime publike me qytetarë, ku Kryetari i Komunës së Kaçanikut, ka raportuar për punën gjashtëmujore dhe njëvjeçare të Komunës, si dhe ka prezantuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027.

Poashtu është zbatuar edhe Ligji për Qasje në Dokumente Publike, ku i është mundësuar qasja qytetarëve, ogazetarëve dhe organizatave të ndryshme në dokumentet të cilat i ka poseduar Komuna e për të cilat është kërkuar qasje më e detajuar.

Të gjitha dokumentet dhe materialet relevante, përfshirë mbledhjet e Kuvendit, procesverbalet, vendimet, marrëveshjet institucionale, raportet financiare, shpenzimet buxhetore, planet, konkurset, njoftimet, ankandet publike, listat e përfituesve të subvencioneve dhe projektet e realizuara apo në planifikim, janë të qasshme për publikun në uebfaqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Gjatë vitit 2025, zyrtari i Teknologjisë së Informacionit (IT) kanë qenë përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së IT-së për mbi 300 përdorues dhe pajisje në objekte të ndryshme komunale. Është ofruar mbështetje teknike ditore për stafin komunal dhe është realizuar me sukses përditësimi i pajisjeve nga Win 10 në Win 11.

Po ashtu, është rritur ndjeshëm siguria kibernetike përmes zbatimit të udhëzimeve të ASHI-t, si dhe është realizuar transmetimi live në platformën Facebook si dhe YouTube i të gjitha mbledhjeve të Kuvendit Komunal.

Synimet për vitin 2026 përfshijnë krijimin e lehtësirave të reja teknologjike për qasje më të shpejtë në informacione, rritjen e dukshmërisë së uebfaqes zyrtare, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe përdorimin e zgjeruar të kanaleve alternative të komunikimit me qytetarët.

Zyra për Komunitete dhe Kthim

Intervistimi i personave të riatdhesuar dhe futja e të dhënave në sistem në programin e Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH).

-Mbledhja të dhënave dokumentacionit të nevojshëm

- Orientimi i palës varësisht nga nevoja dhe kërkesat e tij

- Bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha instucionet relevantet komunës sonë të cilët merren me riatdhesimin e personave të kthyer dhe integrimi i tyre në shoqëri

- Monitorimi i rasteve të personave të riatdhesuar vizita familjare ofrimi i ndihmave varësisht nga rasti pako ushqimore, strehim, barna , kurse apo aftësimi i tyre për ndonjë biznes apo punë.

- Pajisja me dokumentacionin e nevojshëm lëshimi i vërtetimit nga zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Për vitin 2025 numri i personave të riatdhesuar ka qen më i vogël dhe varësisht nga kërkesat e programit për këta persona ZKKK i ka kryer me përpikëri detyrat e veta .

Zyra për Barazi Gjinore

Takim me Grupin e Grave Asambleiste të Komunës

Takime (2) me grupin e grave asambleistë diskutime rreth problemeve dhe sfidave të pozitës së gruas në shoqëri, angazhimi dhe bashkëpunimi nëpër aktivitete të ndryshme, Tryeza të rumbullakëta, pjesëmarrja në aktivitete në fushata të ndryshme sensibilizuese etj .

Shënimi i ditës së 8 marsit ditës ndërkombëtare të gruas

Edhe këtë vit një Ditë aktinizëm në bashkëpunim me DAK nëpër të gjitha shkollat e Komunës sonë, janë mbajtur ligjërata me temën - Roli i gruas në shoqërinë Kosovare dhe sfidat e saj. Vetëdisimi i nxënësve , Njohurit mbi aspektin gjinor (nga disa arsimtar nga klasa e 5 deri ne 9)

Ngritja e kapaciteteve profesionale , shkëmbimi i përvojave , etj

- Pjesëmarrja (shumë e vogël) në disa takime trajnime , debate dhe tryeza të organizuara nga OSCCE, USAID helevetas –Demoss Agjensioni për barazi gjinore , Mapl, My Hom.

Mekanizmi kundër dhunës në familje

- Takime me antarët e mekanizmit kundër dhunës në familje në Komunën tonë Diskutime dhe raportimi i rasteve të dhunës në familje , monitorimi i rasteve dhe varsisht nga nevojat marrja e masave të duhura si dhe pergaditja e planit të veprimt për 2026 .

Fushata - Trafikimi me qenëje njerëzore

- Në fsh Biqec 2 - ligjerat me nxënësit e shkollës JUSUF GERVALLA ku ishin të përfshirë 45 nxënës të klases 9 dhe 8.
- Në Bob ligjerata me nxensit e shkolles së meseme profesionale –Feriz Guri & Vllezrit Çaka. Ku moren pjesë 48 nxënë të klasës 10 dhe 11 dhe shkolla Idriz Seferi 42 nxënës te kl. 8 dhe 9.

Fushata kundër kancerit të gjirit – muaji rozë

- Ne bashkpunim me drejtorin per shendetsi dhe mirqenje socila si dhe drejtorin e QKMF – së u realizu edhe fushat vetdisuese per kancerin e gjirit , si shperndaraja e broshurave nëper qyetet , vendosja e kordeles roz ne shej solidarizimi në web faqe si dhe qytetarve , vizit nëpër ishtucionet që veprojn në komunën ton , defi

- Njoftimi i qytetarëve për mundsin e kontrollit pasi që tash në komunën tonë kemi aparatet e mamografisë.

2 -Tryeza

- Debate për fuqizimi i grave në shoqëri dhe vendimmarrje .
Pjesëmarrja e grave në trashëgimi dhe ndarje të pronës në bashkëpunimi me OJQ USAID pjesëmarrës ishin 30 gra.
- Pjesëmarrja e grave në ndarje të garantëve dhe subvencioneve , si dhe përkrahja e grave në krijimin e bizneseve ku pjesëmarrës ishin 32 gra të cilat kanë biznese të veta.

16 Ditë aktivizëm kundër dhunës në familje

- Vendosja e sloganit në hyrje dhe dalje të qytetit, me moton raportoj dhunën – dhuna është krim , raportoj 092
- Ligjëratë me temën, dhuna në familje mbajtur nga Bashkësia islame me iniciativën e ZBGJ nëpër të gjitha Xhamitë e Komunës sonë në ditën e xhuma janë mbajtur ligjëratat.,
- si dhe nga , sektori i gruas për nder të 16 aktivizëm , Ligjëratë me temën dhuna në familje pjesëmarrës ishin 32 gra
- 4 ligjëratë me nxënës të klasave të 9 - rreth dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore me moton "Sot dhe çdo ditë tjetër". pjesëmarrës ishin 83 nxënës.

Zyra për Integritet Evropian

1. Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Zyra e Integritetit Evropian e cila vepron brenda kabinetit të kryetarit të Komunës së Kaçanikut ka vazhduar angazhimin e saj në avancimin e proceseve integruese, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe forcimin e transparencës institucionale. Zyrtarja e IE ka marrë pjesë në të gjitha punëtoritë e organizuara nga MAPL dhe partnerët relevantë, duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në raportimet zyrtare mujore, dhe vjetore në institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës që trajtojnë integritetin evropian përmes platformave dhe formularëve të MAPL-së, *Obligimet e komunave nga agjenda evropiane plani gjithpërfshirëse i komunave Janar-Qershor 2025 nr.01-104/02-15668/25 data 07.07.2025, dhe Obligimet e komunave nga agjenda evropiane plani gjithpërfshirëse i komunave Janar-Dhjetor 2025 nr.01-104/02-857/26 datë 09.01.2026.*

Gjithashtu kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuar nga MAPL dhe Agjencia e Kosovës për Krahësim (AKK).

Në periudhën janar-dhjetor 2025, kemi mbajtur komunikim të vazhdueshëm dhe kemi përcjellë informacionet e kërkuara me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së, si dhe me ministritë përkatëse.

2. Objektivat Kryesore të Vitit 2025

1. Fuqizimi i procesit të raportimit dhe monitorimit në kuadër të kërkesave të MAPL dhe BE-së.
2. Rritja e koordinimit ndërmjet drejtorive komunale për çështje të integritetit evropian.
3. Pjesëmarrja aktive në punëtori, trajnime dhe sesione informuese të organizuara nga niveli qendror dhe partnerët ndërkombëtarë.
4. Avancimi i kapaciteteve profesionale të stafit.
5. Përmirësimi i transparencës dhe komunikimit publik rreth procesit të integritetit evropian.

3. Aktivitetet dhe Arritjet Kryesore

3.1 Pjesëmarrja në punëtori dhe ngritja e kapaciteteve

- Zyrtarja e IE ka marrë pjesë në të gjitha punëtoritë e organizuara nga:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),
- Agjencia për Koordinim të Integriteteve Evropiane,
- Organizatat partnere dhe donatorët.
- Temat e punës kanë përfshirë:
 - standardet e BE-së për qeverisje lokale,
 - menaxhimin e ciklit të projekteve,
 - raportimin e performancës,
 - harmonizimin e politikave lokale me acquis të BE-së.
- Pjesëmarrja ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së raportimit dhe planifikimit strategjik.

3.2 Raportimet zyrtare në MAPL

- Janë dorëzuar në kohë të gjitha raportimet e kërkuara zyrtare:
- Raportet e performancës komunale,
- Raportet e matjes së indikatorëve,
- Raportet mujore dhe vjetore të zhvillimit lokal,
- Formularët e vlerësimit të transparencës dhe qeverisjes së mirë.
- Komuna e Kaçanikut ka pasur përmirësime të dukshme në saktësinë dhe kohëzgjatjen e raportimit, falë bashkëpunimit të ngushtë me drejtoritë komunale.

3.3 Koordinimi i brendshëm institucional

- Është bërë koordinimi i rregullt me drejtoritë për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve për BE dhe MAPL.
- Janë realizuar takime të brendshme me fokus në zbatimin e objektivave të qeverisjes lokale dhe integriteteve.
- Zyrtarja e IE ka ofruar asistencë teknike drejtorive në hartimin e dokumenteve dhe raporteve.

3.4 Harmonizimi i Politikave dhe Dokumenteve Strategjike

- Është kontribuar në rishikimin dhe përafrimin e dokumenteve komunale me kërkesat e MAPL dhe standardet evropiane.
- Është dhënë mbështetje profesionale për plane zhvillimore të komunës.

3.5 Transparenca dhe komunikimi me publikun

- Janë publikuar informacione të rregullta në faqen zyrtare të komunës për aktivitetet dhe progresin e integriteteve.
- Është kontribuar në raportet e transparencës komunale dhe auditimet e performancës.

4. Sfidat e Hasura gjatë Vitit 2025

- Përgjigje të vonuara nga disa drejtorë në mbledhjen e të dhënave.
- Nevoja për më shumë staf teknik në disa fusha kyçe.
- Burime të kufizuara buxhetore për aktivitete shtesë të integritimeve.
- Sistemet dhe platformat e MAPL herë pas here kanë kërkuar përshtatje për përdorim optimal.

5. Prioritetet për Vitin 2026

1. Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave.
2. Rritja e pjesëmarrjes në projekte të financuara nga BE dhe donatorët.
3. Organizimi i trajnimeve të brendshme për drejtoritë komunale.
4. Përgatitja e raporteve më gjithëpërfshirëse dhe më analitike për MAPL.
5. Zhvillimi i mekanizmave të transparencës më të avancuar për publikun.

6. Përfundime

Zyra e Integritimeve Evropiane e Komunës Kaçanik ka realizuar një vit pune me përkushtim të lartë, duke përmbushur të gjitha obligimet dhe duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në proceset e integritimit evropian në nivel lokal. Pjesëmarrja në të gjitha punëtoritë e organizuara dhe raportimi i rregullt zyrtar në MAPL kanë qenë faktorë kyç për arritjet e këtij viti.

Zyra e Kuvendit Komunal

RAPORT PUNE I SEKTORIT TË KUVENDIT PËR VITIN 2025 TË LEGJISLATURËS SË 7

Punët dhe detyrat e punës në Sektorin e Kuvendit kryhen nga zyrtari i kuvendit (1) i punësuar në këtë sektor dhe nga asistentja e Kryesuesit të KK.

Për gjatë periudhës raportuese nga Sektori i Kuvendit të Komunës, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

1. Pranimin e çdo lënde të adresuar në emër të Kuvendit të Komunës, trupave punuese dhe zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme;
2. Përgatitjet e nevojshme për mbledhjen 08 mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës, 1 mbledhje e jashtëzakonshme, 2 mbledhje solemne dhe distribuimi i tyre;
3. Mbajtja dhe përpilimi i procesverbaleve të mbledhjeve rregullta dhe asaj të jashtëzakonshme të KK, atyre solemne, prezantimi për shqyrtim i proceseve të mbledhjeve të rregullta dhe asaj të jashtëzakonshme në mbledhje të KK;
4. Përgatitjet e nevojshme për 08 mbledhje të rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF; dhe distribuimi i tyre;
5. Mbajtja e procesverbalit për 08 mbledhje të rregullta të KPF dhe prezantimi i tyre për shqyrtim në mbledhjet e KPF;
6. Përgatitjet e nevojshme për 09 mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitete dhe distribuimi i tyre;
7. Mbajtja e Procesverbalit për 09 mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitet, prezantimi i tyre për shqyrtim në mbledhje të këtij komiteti;
8. Përpilimi i 27 vendimeve të KK, kryesisht në bazë të propozim vendimeve, përpilimi i shkresave 38 shkresave të tjera të dala nga mbledhjet e KK;
9. Përpunimin e 5 rregulloreve në bazë të Propozimit të Drafti të propozuar nga Kryetari i Komunës apo drejtoria përkatëse, njëra prej tyre është harmonizuar;
10. Dërgimin e akteve të KK për përkthim, tek zyrtari përkatës për përkthime;
11. Dërgimin e të gjitha Vendimeve të Kuvendi i Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë përkatëse ekzekutuese;
12. Dërgimin e të gjitha vendimeve të Kuvendit të Komunës, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës Ligjore të MAPL, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre, procedura e mëtutjeshme (publikimit apo procedurën e rishqyrtimit të aktit);
13. Dërgimin e të gjitha akteve dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës për Informim, respektivisht Zyrës së IT me qëllim të publikimit të tyre në faqen zyrtare të komunës;
14. Përpilimi i Informatës së Aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2025, dërgimi në publikim;
15. Përpilimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025, dërgimi në publikim;
16. Përpilimin e Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025, dërgimi në publikim;
17. Plotësimin e çdo Pyetësoi për vitin 2025, ashtu siç ka kërkuar MAPL me të dhënat lidhur me aktivitetin e Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të KK;

18. Përgatitjet e nevojshme për në debat publike me qytetarë, të organizuara nga Kryesuesi i KK, për buxhetin 2026-2028;
19. Përpilimin e çdo shkrese tjetër në emër të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
20. Përgatitjen e Buletinit për Aktivitetit e Kuvendit të Komunës të legjislaturës së 7, 2021-2025 (i ndërlidhur në formë elektronike me linjë). Publikimi i këtij dokumenti është bërë në faqen zyrtare edhe në programin Word, për me pasur mundësi me u ndërlidhur me secilin dokument të bashkangjitur përmes linkut.
21. Dërgimi në Arkiv sipas procedurës, materialet e legjislaturës së 6 të Kuvendit të Komunës, gjithsej 778 lëndë.

RAPORTI I PUNËS I SEKTORIT TË KUVENDIT PËR VITIN 2025 TË LEGJISLATURËS SË 8

Pas Certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit 2025 Republikës së Kosovës dhe certifikimit të rezultateve të 9 nëntorit për Kryetar të Komunave, nga Sektori i Kuvendit të Komunës, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

1. Përgatitjet e nevojshme për mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 08.12.2025, dhe për Vazhdimin e mbledhjes Inauguruese, mbajtur me 18.12.2025 dhe 1 mbledhje të rregullt të datës 30.12.2025 dhe distribuimi i tyre;
2. Përpilimi i shkresave për Inaugurim të Kuvendit të Komunës të Legjislaturës 8 dhe për Inaugurim të Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi, dërgimi i tyre në publikim;
2. Mbajtja dhe përpilimi i procesverbaleve të mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës dhe të Vazhdimit të mbledhjes Inauguruese, procedimi i tyre për shqyrtim në mbledhjen e rregullt të KK të datës 30.12.2025 dhe dërgimi i tyre në publikim;
4. Mbajtja e Procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të datës 30.12.2025;
5. Përpilimi i 2 vendimeve nga vazhdimi i mbledhjes Inauguruese të KK, të datës 18.12.2025 që kanë të bëjnë me Zgjedhjen e Kryesuesit të KK, përpilimi i 7 vendimeve të mbledhjes së parë të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.12.2025, dërgimi i tyre në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë;
6. Nga Sektori i KK janë kryer edhe punë tjera të nevojshme teknike e administrative që lidhen me punë të KK.

Kryetari i Komunës
Sabedin Vishi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Emri i organizatës buxhetore në gjuhen shqipe (Komuna KAÇANIK)
Emri i organizatës buxhetore në gjuhen serbe (shkruaj emrin e OB-së)

Kodi i Organizatës Buxhetore: 652

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

Protokolli dërgues i Organizatës Buxhetore

			REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA					
			KOMUNA E KAÇANIKUT					
			OPSTINA KAÇANIK					
I	Data	30.01.26	Vendi	KAÇANIK				
Nj. org.			Numri			Shtojcë		
	01		400/01-2592					

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

				REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO				Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo			
				Ministria e Financave / Ministri i Ekonomisë dhe Financës				Ministry of Finance			
				Thesari - Trezor - Treasury							
Njësia Org.		Org. Unit		Thesari		Nr. Prot.		Pr. Prot.		563	
Nr. i fletës		Drej. shifra		Mo. paget		Data		30.01.26		26	
Hyrja				PRISTINEJA							

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: Nysret KOCA, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: Sabedin Vishi, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

Gafurr Loku, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2025.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të institucionit **Komuna Kaçanik**.

Data: 30/01/2026

(Nënshkrimi i ZKA)

Datë: 30/01/2026

(Nënshkrimi i ZKF)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Emri i organizatës buxhetore në gjuhen shqipe **(Komuna KAÇANIK)**
Emri i organizatës buxhetore në gjuhen serbe (shkruaj emrin e OB-së)

Kodi i Organizatës Buxhetore: 652

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Për: **Nysret KOCA, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Sabedin Vishi, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

Gafurr Loku, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2025.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të institucionit **Komuna Kaçanik**.

Data: 30/ 01/ 2026

Datë: 30/ 01/ 2026

(Nënshkrimi i ZKA)

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Komuna KAÇANIK

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

		2025	2024	2023
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK '000	BKK '000	BKK '000
Shënim				
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
	Granti qeveritar	12,132.70	10,831.51	10,345.46
	Të hyrat vetanake	1,640.60	1,045.70	809.44
	Të hyrat e dedikuara			
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	170.98	255.72	4.78
	Financimet nga huamarrja			
	Klauzola e investimeve			
	Fondi zhvillimor në mirëbesim			
	Pranimet tjera			
Gjithsej		13,944.28	12,132.93	11,159.68
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
	Operacionet			
	Paga dhe shtesa	2 7,357.82	6,557.22	6,157.97
	Mallra dhe shërbime	3 1,526.44	1,430.94	1,540.81
	Shpenzime komunale	4 242.70	200.56	147.74
		9,126.96	8,188.72	7,846.53
	Transferet			
	Transfere dhe subvencione	5 567.07	507.42	360.28
	Shpenzime kapitale			
	Prona, ndërtesa dhe pajisje	6 4,250.25	3,436.78	2,952.87
	Pagesa tjera	7		
Gjithsej		13,944.28	12,132.93	11,159.68

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Komuna KAÇANIK

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

		2025				2024	2023
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shënime							
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8	271.64	430.75	430.75	159.11	310.63	444.00
Të hyrat jo tatimore	9	526.80	519.65	519.65	(7.15)	432.96	440.22
Të hyrat e dedikuara	10				-		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	136.86	136.86		-	287.07	7.55
Tjera	12				-		
Gjithsej Pranimet		935.30	1,087.26	950.40	151.96	1,030.67	891.77
DALJA E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe shtesa	2	7,357.82	7,366.88	6,865.27	9.07	6,557.22	6,157.97
Mallra dhe shërbime	3	1,526.44	1,566.54	1,514.23	40.09	1,430.94	1,540.81
Shpenzime komunale	4	242.70	250.40	225.00	7.71	200.56	147.74
Transfere dhe subvencione	5	567.07	588.66	514.16	21.58	507.42	360.28
Shpenzime kapitale	6	4,250.25	4,527.96	3,473.58	277.71	3,436.78	2,952.87
Rezerva					-		
Tjerat	7				-		
Gjithsej pagesat		13,944.28	14,300.44	12,592.24	356.16	12,132.93	11,159.68

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën D (neni 14), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojnë ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës ndryshimit.

Shënimi 2 – Paga dhe shtesa (D = 9.07)

Buxheti fillestar për kategorinë Paga dhe shtesa për vitin 2025 ishte 6,865,265.00 €.

Në fund të vitit 2024, në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, u bë rritja e koeficientit për të gjithë zyrtarët publik për vitin fiskal 2025, me këtë dinamikë:

- 0.5 njësi koeficienti për periudhën janar–qershor 2025;
- 1.0 njësi koeficienti për periudhën korrik–dhjetor 2025.

Si rezultat, buxheti për këtë kategori u rrit nga buxheti fillestar në buxhetin final, në shumë 7,366,883.92 €. Këto ndryshime do të mbuloreshin nga vendimet e Qeverisë.

Megjithatë, gjatë ekzekutimit të pagave në fundvit 2025, një pjesë e mjeteve të alokuara për këtë qëllim nuk u shpenzuan, duke rezultuar me mbetje të pashpenzuara në shumën 9,066.83 €, e cila paraqitet si suficit dhe në pajtim me rregullat buxhetore, kthehet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Shënimi 3 – Mallra dhe shërbime (D = 40.09)

Buxheti fillestar për kategorinë Mallra dhe shërbime për vitin 2025 ishte 1,514,233.00 €.

Në vitin 2025, realizimi ishte 1,526,440.62 €, buxheti final 1,566,535.09 €, me mosrealizim prej 40,094.47 € (gjitha fondet).

Dallimi lidhet me kursime në prokurim (kontrata/çmime më të ulëta se planifikimi), si dhe me mosrealizim të plotë të disa shërbimeve brenda vitit. Një pjesë e kërkesave/faturave janë pranuar në fund të vitit, pas përmbylljes së vitit fiskal dhe trajtohen sipas rregulloreve financiare (p.sh. përmes detyrimeve të vitit 2025).

- Mjetet e pashpenzuara nga Granti Qeveritar (Fondi 10) në shumën 1,684.36 €, paraqiten si suficit dhe kthehen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake (Fondi 21) në shumën 31,709.18 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake të vitit të kaluar (Fondi 22 – viti 2025) në shumën 4,300.93 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve në shumën 2,400.00 €, bartën në vitin fiskal vijues (2026).

Shënimi 4 – Shpenzime komunale (D = 7.71)

Buxheti fillestar për kategorinë Shpenzime komunale për vitin 2025 ishte 225,000.00 €.

Në vitin 2025, realizimi për shpenzime komunale ishte 242,698.40 €, ndërsa buxheti final 250,403.42 €, me mosrealizim prej 7,705.02 € (gjitha fondet).

Dallimi është krijuar kryesisht për arsye të kohës së faturimit: një pjesë e shërbimeve komunale faturohen pas konsumit. Për shembull, konsumi i muajit dhjetor (energji, ujë, mbeturina) zakonisht fakturohet në janar, ndërsa disa fatura të tjera kanë ardhur pas përmbylljes së vitit fiskal. Si rrjedhojë, këto shpenzime nuk janë reflektuar në pagesa brenda vitit 2025 dhe ndikojnë në mosrealizimin e paraqitur në kolonën D.

- Mjetet e pashpenzuara nga Granti Qeveritar (Fondi 10) në shumën 2.04 €, paraqiten si suficit dhe kthehen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake (Fondi 21) në shumën 7,698.33 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake të vitit të kaluar (Fondi 22 – viti 2025) në shumën 4.65 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).

Shënimi 5 – Transfere dhe subvencione (D = 21.58)

Buxheti fillestar për kategorinë Transfere dhe subvencione për vitin 2025 ishte 514,157.00 €.

Në vitin 2025, realizimi ishte 567,073.51 €, buxheti final 588,656.49 €, me mosrealizim prej 21,582.98 €.

- Mjetet e pashpenzuara nga Granti Qeveritar (Fondi 10) në shumën 0.04 €, paraqiten si suficit dhe kthehen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake (Fondi 21) në shumën 15,026.27 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake të vitit të kaluar (Fondi 22 – viti 2025) në shumën 6,542.67 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve në shumën 14.00 €, bartën në vitin fiskal vijues (2026).

Shënimi 6 – Shpenzime kapitale (D = 277.71)

Buxheti fillestar për kategorinë Shpenzime kapitale për vitin 2025 ishte 3,473,583.00 €.

Në vitin 2025, realizimi i shpenzimeve kapitale ishte 4,250,254.46 €, ndërsa buxheti final 4,527,963.72 €, me mosrealizim material prej 277,709.26 €.

Ky dallim rezulton kryesisht nga dinamika e realizimit të projekteve kapitale, përfshirë: vonesa në procedurat e prokurimit, realizim më i ngadalshëm i punimeve dhe mosdorëzim i situacioneve deri në fund të vitit. Si rezultat, një pjesë e mjeteve mbeten pa u ekzekutuar brenda vitit fiskal.

- Mjetet e pashpenzuara nga Granti Qeveritar (Fondi 10) në shumën 1.64 €, paraqiten si suficit dhe kthehen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake (Fondi 21) në shumën 169,447.03 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga të Hyrat Vetanake të vitit të kaluar (Fondi 22 – viti 2025) në shumën 108,113.74 €, bartën në buxhetin komunal në vitin fiskal vijues (2026).
- Mjetet e pashpenzuara nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve në shumën 146.85 €, bartën në vitin fiskal vijues (2026).

Shënimi 8 – Të hyrat tatimore (D = 159.11)

Në vitin 2025, realizimi i të hyrave tatimore (që në këtë rast paraqet Tatimin në Pronë) ishte

271,644.70 €, ndërsa buxheti final i planifikuar ishte 430,752.00 €, me mosrealizim prej 159,107.30 €.

Dallimi lidhet me nivel më të ulët të arkëtimit krahasuar me planifikimin vjetor. Në këtë rënie ka ndikuar edhe heqja e praktikës së mëparshme të kushtëzimit të qytetarëve me pagesën e Tatimit në Pronë gjatë regjistrimit të automjeteve. Me largimin e kësaj dukurie, është zvogëluar pagesa në kohë dhe rrjedhimisht ka rënë realizimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë gjatë vitit 2025.

Shënimi 9 – Të hyrat jo tatimore (D = -7.15)

Në vitin 2025, realizimi i të hyrave jo tatimore, ishte 526,799.98 €, ndërsa buxheti final i planifikuar ishte 519,649.00 €, duke shënuar arritje të planifikimit dhe tejkalim prej 7.150.98 €.

Tejkalimi është rezultat i arkëtimeve më të larta se parashikimi në disa nënkategori të të hyrave jo tatimore. Në tërësi, kjo kategori ka reflektuar dinamikë më të mirë të arkëtimit dhe kërkesë më të lartë për shërbimet/lejim komunale gjatë vitit 2025.

Shënimi 11 – Grantet e përcaktuara të donatorëve

Në vitin 2025, realizimi i granteve të përcaktuara të donatorëve ishte 136,857.60 €, ndërsa buxheti final po ashtu 136,857.60 €, prandaj nuk ka dallim material në kolonën D (B-A).

Kjo kategori përfshin grante të përcaktuara të donatorëve (GPD), të cilat nuk planifikohen në buxhetin fillestar, sepse varen nga marrëveshjet dhe konfirmimet gjatë vitit. Ato inkorporohen në buxhet vetëm pasi të konfirmohen/ nënshkruhen marrëveshjet përkatëse dhe pastaj realizohen sipas projekteve dhe kushteve të donatorëve.

Fondi 10 – Buxheti (Granti Qeveritar):

Buxheti ishte 12,143,455.92 €, shpenzimi 12,132,701.01 €, me mbetje 10,754.91 €. Kjo mbetje paraqet mjete të pashpenzuara nga granti qeveritar; sipas rregullave buxhetore, trajtohet si suficit dhe kthehet në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo mbetje vjen nga këto kategori ekonomike: Paga dhe shtesa 9,066.83 €, Mallra dhe shërbime 1,684.36 €, Shpenzime komunale 2.04 €, Transfere dhe subvencione 0.04 € dhe Shpenzime kapitale 1.64 € .

Fondi 21 – Të hyrat vetanake:

Buxheti ishte 950,401.00 €, shpenzimi 726,520.19 €, me mbetje 223,880.81 €. Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake barten në vitin fiskal vijues dhe mbesin në dispozicion të komunës për financimin e aktiviteteve/ projekteve sipas planifikimit buxhetor.

Fondi 22 – Të hyrat vetanake nga viti i kaluar:

Buxheti ishte 1,033,041.11 €, shpenzimi 914,079.12 €, me mbetje 118,961.99 €. Kjo mbetje paraqet mjete të bartura nga vitet e kaluara që nuk janë ekzekutuar brenda vitit dhe barten në buxhetin e vitit vijues, për realizim sipas prioriteteve dhe projekteve të planifikuara.

Fondi 31 – Granti i donacioneve të brendshme:

Buxheti ishte 23,691.90 €, shpenzimi 23,531.05 €, me mbetje 160.85 €.

Fondi 39 – Kryqi i Kuq:

Buxheti ishte 2,400.00 €, shpenzimi 0.00 €, me mbetje 2,400.00 €. Mjetet janë alokuar për aktivitet/mbështetje të planifikuar, por pagesa/realizimi nuk është ekzekutuar brenda vitit fiskal; për rrjedhojë, mjetet mbeten të pashpenzuara dhe trajtohen për bartje/realizim në vitin vijues sipas marrëveshjes dhe destinimit.

Fondi 61 – Qeveria Zvicerane:

Buxheti ishte 147,452.71 €, shpenzimi 147,452.71 €, me mbetje 0.00 €. Kjo tregon se fondet e donatorit janë realizuar plotësisht brenda vitit, në përputhje me marrëveshjen/projektin.

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS) – 2017, përkatësisht standardit “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, dhe i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007, si dhe Ligjin 08/L-183 për Mbështetjen e Punëve Publike. Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me bazën “cash” (të hyrat dhe shpenzimet njihen në momentin e arkëtimit dhe të pagesës), ndërsa regjistrimi dhe raportimi financiar është realizuar përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave Publike (SIMFK/FreeBalance), duke respektuar strukturën e planit kontabël në fuqi dhe klasifikimet buxhetore.

Në kuadër të MFK-së, Komuna Kaçanik ka zbatuar kontrole të brendshme dhe ndarje të përgjegjësi në proceset kryesore financiare, duke siguruar që çdo transaksion të jetë i autorizuar, i mbështetur me dokumentacion të plotë, i kontrolluar paraprakisht dhe i regjistruar saktë, në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe procedurat përkatëse. Pagesat janë realizuar vetëm pas verifikimit të rregullsisë formale dhe financiare, ndërsa është siguruar ruajtja e evidencave për qëllime raportimi dhe auditimi.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Komuna e Kaçanikut është njësi e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës dhe ushtron kompetencat e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe legjislacionin tjetër përkatës që rregullon organizimin dhe funksionimin institucional, administrimin publik dhe menaxhimin e financave publike. Në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, Komuna planifikon dhe zbaton politika dhe shërbime publike lokale, administron asetet publike komunale dhe menaxhon burimet financiare në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies.

Misioni i Komunës së Kaçanikut është ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të barabarta për qytetarët, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik e social dhe përmirësimi i mirëqenies në territorin e komunës, përmes qeverisjes së mirë, menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve publike dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Vizioni i Komunës së Kaçanikut është të jetë një komunë e zhvilluar, e sigurt dhe funksionale, me administratë moderne dhe transparente, me infrastrukturë dhe shërbime të avancuara, që krijon kushte të favorshme për investime, punësim dhe një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët.

Entiteti i sektorit publik Komuna e Kaçanikut ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007, si dhe në përputhje me aktet nënligjore dhe udhëzimet përkatëse në fuqi.

Sipas LMFP-së, të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Komuna e Kaçanikut, organizatë buxhetore me kod: 652, gjatë vitit fiskal 2025, aktivitetet buxhetore i ka realizuar duke u mbështetur në legjislacionin e përgjithshëm nga fushëveprimtaria e financave të sektorit publik.

Janë zbatuar të gjitha procedurat dhe fazat e përcaktuara për përgatitjen dhe miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025, duke respektuar me përpikmëri kalendarin kohor të përgatitjeve deri në fazën e aprovimit në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, rëndësi i është kushtuar harmonizimit dhe rregullimeve në ndarjet buxhetore dhe menaxhimit të lëvizjeve/transfereve të mjeteve brenda organizatës buxhetore, përmes: lëvizjes/bartjes së mjeteve nga një program/nënprogram në program/nënprogram tjetër, nga një projekt në projektin tjetër, lëvizjeve nga një kategori ekonomike në tjetrën, si dhe rialokimit të mjeteve brenda së njëjtës kategori ekonomike, gjithmonë duke respektuar bazën ligjore dhe procedurat përkatëse.

Është zbatuar legjislacioni në fuqi, përfshirë: Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime), Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (me ndryshime), Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

Po ashtu, është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme plani kontabël në fuqi për vitin 2025, ashtu siç është konceptuar dhe kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zyrtari Kryesore Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuar nga LMFP								Buxheti përfundimtar SIMFK € '000	Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000
	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit Nr. 08/L-332) për vitin 2025 € '000	Vendimi i Qeverisë 03/261 € '000	Vendimi i Qeverisë 02/281 € '000	Ndryshimi		Të hyrat vetanake- Bartja e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2024 € '000	Grantet e percaktuara te donetoreve € '000	Burime tjera te financimit € '000		
				Ndryshimi III € '000	Ndryshimi IV € '000					
Hyrjet										
Të hyrat tatimore	430.75					154.96			585.71	35.97%
Të hyrat jo tatimore	519.65					878.08			1,397.73	168.98%
Të hyrat e dedikuara									-	
Grantet e percaktuara të donatorëve							171.14		171.14	
Huamarrjet									-	
Tjera									-	
Gjithsej	950.40	-	-	-		1,033.04	171.14	-	2,154.59	126.70%
Daljet										
Paga dhe shitesa	6,865.27	296.87	204.75						7,366.88	7.31%
Mallra dhe shërbime	1,514.23					49.90	2.40		1,566.54	3.45%
Shpenzime komunale	225.00					25.40			250.40	11.29%
Transfere dhe subvencione	514.16					50.95	23.53		588.64	14.49%
Shpenzime kapitale	3,473.58					906.78	147.45		4,527.82	30.35%
Rezerva									-	
Kthimi i huamarrjeve									-	
Tjerat									-	
Gjithsej	12,592.24	296.87	204.75	-		1,033.04	173.38	-	14,300.28	13.6%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë

Daljet (shpenzimet)

a) Paga dhe shtesa

Buxheti fillestar 2025 ka qenë 6,865,265 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 7,366,883.92 €, me rritje 501,618.92 € (7.31%). Rritja është rezultat i vendimit të Qeverisë për ngritjen e koeficientit në + 0.5 njësi koeficienti për periudhën janar– qershor 2025; + 1.0 njësi koeficienti për periudhën korrik– dhjetor 2025, për secilin zyrtar publik.

Ndryshimi I: 296,872.54 € - Vendimi i Qeverisë 03/261, i datës 05.06.2025- (Mbledhja Nr. 261/2025- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=106461>) dhe

Ndryshimi II: 204,746.38 € - Vendimi i Qeverisë 02/281, i datës 24.12.2025- (Mbledhja Nr. 281/2025-, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=114703>), ndryshime të realizuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

b) Mallra dhe shërbime

Buxheti fillestar ka qenë 1,514,233.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 1,566,535.09 €, me rritje 52,302.09 € (3.45%), si rezultat i:

- Bartjes së mjeteve të të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 (fondi burimor 22): 49,902.09 €
- Bartjes së mjeteve tek Grante të përcaktuara të donatorëve – Kryqi i Kuq i Kosovës (fondi burimor 31): 2,400.00 €

c) Shpenzime komunale

Buxheti fillestar ka qenë 225,000.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 250,403.42 €, me rritje 25,403.42 € (11.29%), si rezultat i:

- Bartjes së mjeteve të të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 (fondi burimor 22): 25,403.42 €

d) Transfere dhe subvencione

Buxheti fillestar ka qenë 514,157.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 588,642.49 €, me rritje 74,485.49€ (14.49%), si rezultat i:

- Bartjes së mjeteve të të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 (fondi burimor 22): 50,954.44 €
- Bartjes së mjeteve tek Grantet e të përcaktuara të donatorëve (fondi burimor 31): 1.05 €
- Grante të përcaktuara të donatorëve (fondi burimor 31)- participime të qytetarëve: 23,530.00 €, për projektet nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (1. Mbështetja e bletarëve me shkrirëse dyelli; 2. Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor; 3. Ndërtimi i serrave me sipërfaqe prej 50 m²).

e) Shpenzime kapitale

Buxheti fillestar ka qenë 3,473,583.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 4,527,816.87, me rritje 1,054,233.87 € (30.35%), si rezultat i:

- Bartjes së mjeteve të të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 (fondi burimor 22): 906,781.16 €
- Bartjes së mjeteve tek Grante të përcaktuara të donatorëve – Qeveria Zvicerane (fondi burimor 61*): 34,125.11 €, për projektin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës (1. Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti Restorant Natyra - Fusha e Pajtimit)
- Grante të përcaktuara të donatorëve (fondi burimor 61*)- participim nga DEMOS- Helvetas Kosovo: 113,327.60 €, për projektin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (1. Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj- Soponicë dhe Duraj)

*Fondi burimor 61- Qeveria Zvicerane, paraqesin participimin nga DEMOS- Helvetas Kosovo, mjete që vijnë si rezultat i Grantit të Performancës.

*Totali i mjeteve tek Grante të përcaktuara të donatorëve – fondi burimor 61 (Qeveria Zvicerane / DEMOS–Helvetas Kosovo, Grant i Performancës) është: 147,452.71 €

Gjithsej daljet

Në total, buxheti fillestar për vitin 2025 ka qenë 12,592.239.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është 14,300.442.64 €, me rritje 1,708,203.64 € (13.60%).

Shënimi 2 Paga dhe shtesa

Përshkrimi	2025									2024	2023	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat	FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD	Final			Buxheti - Pagesat
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000			€ '000
11111 - Paga Neto	5,733.67				5,723.67	10.00					5,042.07	5,208.35
11121 - Tatimi Në Të Ardhurat Personale	387.26				387.26						349.67	342.20
11131 - Kontributi Pensional - Punëtori	350.37				350.37						309.89	293.08
11151 - Sindikatat	22.01				22.01						18.51	14.88
11152 - Odat Profesionale	5.20				5.20						4.30	3.52
11211 - Përvoja E Punës	338.21				338.21						297.19	
11311 - Kontributi Pensional - Punëdhënësi	350.37				350.37						309.89	293.08
11611 - Shtesat Tranzitore	1.47				1.47						6.61	
11900 - Vendimet Gjyqësore	-										49.07	2.86
Paga dhe shtesa	7,357.82	-	-	-	7,347.82	10.00	-	-	7,366.88	9.07	6,557.22	6,157.97

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Shënimi “Paga dhe shtesa” përfshin shpenzimet për kompensimin e punonjësve (pagat neto, shtesat, si dhe detyrimet që burojnë nga paga – tatimi në paga, kontributet pensionale dhe ndalesat tjera). Për vitin 2025, pagesat e realizuara në këtë kategori janë 7,357,817.09 €, të financuara nga Granti Qeveritar 7,347,817.09€ dhe Të Hyra Vetanake 10,000.00 € (të alokuara).

Buxheti final është 7,366,883.90 €, ndërsa dallimi Buxheti Final – Pagesat është 9,066.83 €, (mjete të pashpenzuara brenda vitit).

Shpenzimet për “Paga dhe shtesa” në vitin 2025 janë 7,357,817.09 €, krahasuar me 6,557,217.56 € në vitin 2024, paraqesin rritje prej 800,599.53 € (12.21%); krahasuar me 6,157,974.77 € në vitin 2023, shpenzimet e vitit 2025 shënojnë rritje prej 1,199,842.32 € (19.48%).

Rritja është rezultat i vendimit të Qeverisë për ngritjen e koeficientit në + 0.5 njësi koeficienti për periudhën janar– qershor 2025; + 1.0 njësi koeficienti për periudhën korrik– dhjetor 2025, për secilin zyrtar publik.

Shënimi 3 Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	2025										Ndryshimi		2024	2023
	Gjithsej	FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD	Buxheti Final	Buxheti - Pagesat				
	Pagesat										Pagesat			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
13140 - transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit	1.23				1.23									
13142 - akomodimi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	-											21.41		
13143 - shpenzimet e tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	0.84				0.84							0.17	0.61	
shpenzimet e udhëtimeve zyrtare brenda vendit	-												4.10	
13310 - interneti	0.97				0.97							1.02	0.53	
13320 - telefonia mobile	4.78				4.40	0.38						5.70	5.13	
13330 - shërbimet postare	5.12				5.11	0.00						5.08	9.81	
13410 - shërbimet e arsimit dhe trajnimit	0.20				0.20									
13420 - shërbimet e përfaqësimit për avokaturë	-											0.75	6.54	
13430 - shërbimet e ndryshme shëndetësore	2.70				2.70							3.94	3.52	
13440 - shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale	32.02				25.82	6.20						22.91	3.60	
13445 - shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	36.17				30.08	6.09						17.50		
13450 - shërbimet e shtypjes/printimit	0.71				0.71							0.94		
13460 - shërbimet kontraktuese të tjera	36.04				25.25	10.79						102.98	205.55	
13470 - shërbimet teknike	9.43				8.44	0.99						9.73	8.19	
13471 - softuerët- licencat dhe mirëmbajtja e tyre	-											0.40		
13475 - sigurimi fizik i objekteve publike	122.43				102.60	19.83						96.98		
13480 - shpenzimet e anëtarësimit	6.00				6.00							6.00	6.00	
13501 - mobiljet	4.00				4.00							44.39	46.33	
13503 - kompjuterët	18.82				17.45	1.37						29.40	5.90	
13504 - pajisjet e tjera të teknol.informative dhe të komunikimit	3.49				3.49							0.21		
13505 - makinat fotokopjuese- multifunksionale	-											4.30	13.27	
13506 - pajisjet specialistike mjekësore	26.83				26.83							6.00	12.98	
13509 - pajisjet e tjera	63.84				63.84							32.03	28.61	
13610 - furnizimet për zyrë	28.70				28.24	0.46						46.14	37.35	
13620 - furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	14.61				14.61							23.16	28.91	
13630 - furnizimet mjekësore	18.43				18.43							43.74	39.95	
13640 - furnizimet e pastrimit	15.69				15.69							19.03	19.92	
13650 - furnizimi me veshmbathje	8.36				8.36							6.50	3.45	
13710 - vaji	0.23				0.23							0.15	0.34	
13720 - nafta për ngrohje qendrore	8.05				8.05							13.80	3.96	
13730 - vaji për ngrohje	-											1.60	0.40	
13760 - drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	155.04				155.04							200.65	160.59	
13780 - derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	39.53				35.91	3.62						44.70	52.38	
13810 - avancë (paradhënia) për para të imëta	0.50				0.50							0.50	0.50	
13917 - provizion bankar- nlb banka	-												0.04	
13950 - regjistrimi i automjeteve	2.84				2.26	0.59						2.94	2.91	
13951 - sigurimi i automjeteve	7.54				6.20	1.34						8.35	8.68	
13954 - kontrollimi teknik i automjeteve	0.35				0.35							0.61		
14010 - mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	20.24				19.78	0.46						15.47	21.87	
mirëmbajtja e ndërtesave	-												74.62	
14020 - mirëmbajtja e ndërtesave të banimit	-												2.82	
14022 - mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	3.19				0.09	3.10						20.27	21.64	
14023 - mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	85.44				82.67	2.76						54.68	141.76	
14024 - mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	5.13				5.13							2.29	121.58	
14026 - mirëmbajtja e objekteve sportive	10.01				7.37	2.64								
14030 - mirëmbajtja e autorrugëve	-												8.42	
14032 - mirëmbajtja e rrugëve lokale	366.88				315.85	51.03						252.43	334.50	
14050 - mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	27.81				27.81							21.05	17.85	
14060 - mirëmbajtja rutinore	123.15				104.66	18.49						76.52	49.56	
14130 - qiraja për pajisje	4.99				4.46	0.53						0.33	3.60	
14310 - kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	13.98				10.65	3.33						13.77	2.36	
14410 - vendimet gjyqësore	190.61				172.12	18.49						41.83	6.64	
14415 - pagesat për tarifa - vendimet gjyqësore/përmbartimore	0.04				0.04							108.94	0.65	
14210 - reklamat dhe konkurset	-											0.12		
14230 - shpenzimet për informim publik	-												0.99	
14450 - pagesa- gjoba ndërinstitucionale	-												3.70	
kompensimi për inflacion	-												8.70	
	1,526.94	-	-	-	1,374.44	152.50			1,566.54	39.59	1,431.44	1,541.31		

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Shënimi “Mallra dhe shërbime” përfshin shpenzimet operative për furnizime, shërbime kontraktuese, komunikim, transport, mirëmbajtje, karburante, si dhe shpenzime të tjera të natyrës së funksionimit të institucionit.

Për vitin 2025, pagesat e realizuara në këtë kategori janë 1,526,940.62 €, të financuara nga Granti Qeveritar 1,374,439.64 € dhe Të Hyra Vetanake 152,500.98 €. Buxheti final në SIMFK është 1,566,535.09 €, ndërsa ndryshimi Buxheti Final – Pagesat është 39,594.47 € (mjete të pashpenzuara brenda vitit).

Në vitin 2025, shpenzimet (pagesat) në kategorinë “Mallra dhe shërbime” janë përqendruar kryesisht në disa zëra, ku dallohen: mirëmbajtja e rrugëve lokale (24.03% e totalit), vendimet gjyqësore (12.48%), drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje (10.15%), mirëmbajtja rutinore (8.07%) dhe sigurimi fizik i objekteve publike (8.02% e totalit). Këta pesë zëra së bashku përbëjnë rreth 62.75% të shpenzimeve totale të kësaj kategorie për vitin 2025, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në shërbime të tjera operative, furnizime, mirëmbajtje të objekteve dhe shpenzime funksionale të institucionit.

Shpenzimet për “Mallra dhe shërbime” në vitin 2025 janë 1,526,940.62 €, krahasuar me 1,431,444.24 € në vitin 2024, që paraqet rritje prej 95,496.38 € (6.67%). Krahasuar me vitin 2023, respektivisht 1,540,810.11 €, shpenzimet e vitit 2025 shënojnë ulje prej 13,869.49 € (0.90%).

Shënimi 4 Shpenzime komunale

Përshkrimi	2025									2024	2023	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi Buxheti -
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000			Pagesat € '000
13210 - Energjia Elektrike	174.85				129.37	45.48					134.92	103.79
13220 - Shërbimet e Ujësjiellësit dhe Kanalizimit	15.01				9.74	5.27					10.49	7.98
13230 - Mbeturinat	34.69				26.34	8.35					34.97	31.73
13250 - Telefonia Fikse	5.06				4.17	0.89					4.68	4.25
13260 - Pagesat - Vendime Gjyqësore	13.09					13.09					15.50	
Shpenzime komunale	242.70	-	-	-	169.62	73.08	-	-	250.40	7.71	200.56	147.74

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Këto shifra paraqesin shpenzimet e kategorisë ekonomike “Shpenzime Komunale”, të shpalosura në detaje për secilin kod ekonomik.

Shpenzimet komunale përfshijnë: energjinë elektrike (për objektet komunale dhe ndriçimin publik), ujësjellësin dhe kanalizimin, shërbimet e mbeturinave, telefoninë fikse, si dhe pagesa sipas vendimeve/pajtimeve gjyqësore.

Në vitin 2025 janë realizuar pagesa gjithsej 242,698.40 €, ndërsa Buxheti Final është 250,403.42 €, me dallim Buxheti Final – Pagesat 7,705.02 € (mjete të pasqyruara brenda vitit). Financimi i këtyre pagesave është bërë nga Granti Qeveritar 169,616.96€ (69.89%) dhe Të Hyra Vetanake 73,081.44 € (30.11%).

Shpenzimet komunale në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, paraqesin rritje prej (21.01%); ndërsa krahasuar me vitin 2023 paraqesin rritje prej (64.28%). Rritja kryesisht ndërlidhet me rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe shpenzimet e energjisë elektrike, të cilat janë rritur për shkak të kërkesave më të larta të konsumit, përfshirë shtrirjen/mbulueshmërinë e ndriçimit publik.

Shënimi 5 Subvencione dhe transfere

Përshkrimi	2025									2024	2023
	Gjithsej								Buxheti		
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	CPD € '000	Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	
21110 - Subvencionet për Entitetet Publike	-										
21200 - Subvencionet për Entitetet Jopublike	415.69				314.09	79.65		21.95			226.85
22202 - Transferet për Përfitues Individual Tjerë	86.56				35.07	49.91		1.58			133.44
22210 - Pensionet Bazë	-										
22215 - Pensionet Bazë Kontributdhënëse	-										
22220 - Pensionet për Personat me Aftësi të Kufizuara	-										
22232 - Pensionet për Veteranët E Luftës	-										
22235 - Pensionet për TMK	-										
22236 - Pensionet për FSK	-										
22298 - Pagesat për Shërbimet e Varrimit	64.83				40.00	24.83					10.27
22300 - Vendimet Gjyqësore	-										35.78
Subvencione dhe transfere	567.07	-	-	-	389.16	154.39	-	23.53	588.66	21.58	360.28

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Këto shifra paraqesin shpenzimet e kategorisë ekonomike “Subvencione dhe Transfere”, të shpalosura në detaje sipas kodeve ekonomike.

Për vitin 2025 janë realizuar pagesa në vlerë totale 567,073.51 €, ndërsa Buxheti Final është 588,656.49 €, me dallim Buxheti Final – Pagesat 21,582.98 € (mjete të pashpenzuara brenda vitit).

Financimi i pagesave në total është bërë nga Granti Qeveritar 389,156.96 €, Të Hyra Vetanake 154,385.50€ dhe nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve 23,531.05 € (participim nga vetë qytetarët).

Ndarja dhe realizimi i këtyre subvencioneve dhe transfereve është bërë në përputhje me Rregulloren Komunale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, si dhe Rregulloren MF – NR. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në rastet kur përfitues janë organizatat joqeveritare.

Gjatë vitit 2025, Zyra e Kryetarit ka mbështetur OJQ-të dhe shoqatat kryesisht përmes thirrjeve publike dhe marrëveshjeve, për programe që lidhen me: ruajtjen dhe promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së, këshillimin dhe mbështetjen e kategorive të dala nga lufta, si dhe iniciativa me fokus mbrojtjen dhe kujdesin ndaj grave dhe fëmijëve.

Në kuadër të transferëve për përfitues individual, bazuar në rregulloret dhe kriteret përkatëse, Komuna ka ndihmuar qytetarët me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, si dhe raste me gjendje të përkeqësuar shëndetësore, duke u bazuar në kërkesat dhe arsyetimet e paraqitura.

Në këtë kategori janë përfshirë edhe mbështetje për transportin e nxënësve, si pjesë e shërbimeve të domosdoshme për vijueshmërinë në arsim.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike janë kryer pagesat për shërbimet e varrimit të qytetarëve, të paraqitura në kodin ekonomik përkatës.

Nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes thirrjeve për aplikim dhe marrëveshjeve (përfshirë bashkëpunime me organizata si “Islamic Relief”), janë mbështetur bujqit me serra dhe mekanizëm bujqësor, përfshirë edhe participimet nga ta.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, përmes thirrjeve për aplikim, ka mbështetur me subvencione bizneset start- up në Komunën e Kaçanikut, me synim nxitjen e punësimit dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka mbështetur me subvencione, përmes thirrjeve publike, OJQ-të që ofrojnë shërbime mbështetëse dhe këshilluese për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si dhe ka ndihmuar qytetarë (përfshirë individual) me gjendje të rëndë sociale.

Drejtoria e Arsimit ka mbështetur transportin e nxënësve dhe ka subvencionuar studentët përmes bursave.

Ndërkaq, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes thirrjeve publike, ka përkrahur OJQ-të që zhvillojnë aktivitete kulturore, rinore dhe sportive, si dhe përfaqësojnë Komunën e Kaçanikut në gara dhe evente të ndryshme.

Shënimi 6 Shpenzime kapitale

Përshkrimi	2025									2024	2023	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000			Buxheti - Pagesat € '000
31110 - Ndërtesat e Banimit	-										43.98	200.00
31120 - Ndërtesat Administrative dhe Afarist	53.21				20.00	33.21					40.00	177.93
31121 - Ndërtesat Arsimore	-										112.78	459.54
31122 - Ndërtesat Shëndetësore	-										-	1.06
31123 - Objektet Kulturore	-										-	-
31124 - Objektet Sportive	200.00				200.00						304.55	8.39
31125 - Monumentet dhe Komplekset Memor	148.93				70.00	78.93					45.07	54.93
31126 - Rrethojat	108.13				100.00	8.13						
31128 - Garazhet	47.04				47.04						100.00	
31129 - Fushat Sportive	260.33				50.00	97.00		113.33			137.36	74.11
31136 - Urat	49.25					49.25					51.65	
31230 - Rrugët Lokale	1,156.52				843.07	313.46					809.05	493.56
31240 - Trotuaret	466.84				190.00	242.72		34.13			341.99	178.24
31250 - Rrjetet e Kanalizimit	154.64				122.80	31.84					170.44	279.64
31260 - Rrjetet e Ujësllësit	-										75.12	172.83
31610 - Pajisjet e Tjera të Tekn. Informativë dhe Komunikimit	9.34				9.34						20.00	10.00
31620 - Mobiljet	-											
31660 - Pajisjet Mjekësore	38.04				19.65	18.40					30.00	
31690 - Pajisjet e Tjera	121.85				101.85	20.00					1.54	102.11
31700 - Veturat Zyrtare	-										30.00	
31702 - Xhipat dhe Kombibusët	-											59.50
32110 - Shtretërit e Lumenjve	7.61				7.61						130.20	
32100 - Tokat	-											
32111 - Sistemet e Ujitjes	103.45				45.00	58.45					62.67	3.76
32140 - Parqet dhe Hapësirat Publike	206.17				90.00	116.17					419.23	
34000 - Pagesat sipas Vendimeve Gjyqësore	1,118.90				935.82	183.08					511.16	7.50
Kompensimi për Inflacion	-										-	8.64
Mirëmbajtja Investive	-											661.12
Shpenzime Kapitale	4,250.25	-	-	-	2,852.17	1,250.63	-	147.45	4,527.96	277.71	3,436.78	2,952.87

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Paraqesin shpenzimet e kategorisë ekonomike “Shpenzime Kapitale”, të shpalosura në detaje për secilin kod ekonomik. Në vitin 2025 janë realizuar pagesa gjithsej 4,250,254.46 €, ndërsa Buxheti Final është 4,527,963.72 € me dallim Buxheti Final – Pagesat 277,709.26 €. Pagesat janë financuar nga Granti Qeveritar 2,852,170.36 € (67.11%), Të Hyra Vetanake 1,250,631.39 € (29.42%) dhe nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve 147,452.71 € (3.47%).

Zërat kryesorë, në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vitin 2025 janë përqendruar kryesisht në: rrugët lokale me 1,156,520.66 € (27.21%), pagesat sipas vendimeve gjyqësore me 1,118,900.79 € (26.33%), trotualet me 466,844.03 € (10.98%), fushat sportive me 260,327.60 € (6.13%) dhe parqet/hapësirat publike me 206,168.24 € (4.85%). Këta pesë zëra së bashku përbëjnë 75.50% të totalit të shpenzimeve kapitale për vitin 2025.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet kapitale të vitit 2025 paraqesin rritje prej (23.67%), kurse, krahasuar me vitin 2023, shënojnë rritje prej (43.94%).

Edhe në vitin 2025, në kuadër të kategorisë “Shpenzime Kapitale”, Thesari i Kosovës ka ekzekutuar pagesa sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore.

Këto pagesa në pjesën më të madhe lidhen me lëndë që rrjedhin nga Kontrata Kolektive në Arsim, të cilat realizohen jashtë kontrollit të planifikimit të zakonshëm buxhetor.

Si rezultat, këto obligime krijojnë vështirësi në planifikimin e saktë dhe në realizimin e buxhetit, duke ndikuar në orientimin e mjeteve kapitale nga projektet e planifikuara drejt ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Shënimi 7 Tjera

Natyra e pagesës	2025	2024	2023
	€ '000	€ '000	€ '000
83140 - Depozitat për shpronësim	58.00	58.00	58.00
Depozita 2			
Depozita 3			
Depozitat tjera			
Gjithsej	58.00	58.00	58.00

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shuma e paraqitur prej 58,000.00 € i referohet procesit të shpronësimit të zhvilluar nga Komuna për një objekt privat. Ky objekt ishte privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe më pas ishte blerë nga një qytetar.

Me Vendim të Kuvendit Komunal, ky objekt ishte shpallur me interes publik. Komuna e ka zhvilluar dhe përfunduar procedurën e shpronësimit, mirëpo qytetari ende nuk është pajtuar me vlerën e përcaktuar të kompensimit, e cila është caktuar në bazë të vlerësimit të pronës të bërë nga Departamenti i Shpronësimeve në MFPT.

Në këtë kuadër, mjetet në vlerë prej 58,000.00 € janë të deponuara në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), në Fondin e Mirëbesimit.

Shënimi 8 Te hyrat tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2025	2024	2023	% e totalit 2024	% e ndryshimit nga 2023
		€ '000	€ '000	€ '000		
Tatimi në Pronë- Objektet	40110		181.95	338.75	%	%
Tatimi në Pronë- Parcelat	40110	271.64	128.68	105.25	%	%
Të hyrat tatimore 3						
Të hyrat tatimore 4						
Gjithsej		271.64	310.63	444.00	-12.55%	-38.82%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Rënia e të hyrave nga Tatimi në Pronë në vitin 2025 (271,644.75 €). krahasuar me vitin 2024 (310,632.83 €), -12.55%, si dhe krahasuar me vitin 2023 (443,998.13 €), -38.82%, lidhet kryesisht me uljen e dëshirës/ vullnetit për pagesë pas heqjes së kushtëzimit për regjistrimin e automjeteve.

Heqja e kushtëzimit (pra, moskërkimi i dëshmisë së pagesës së tatimit në pronë, vërtetimit, si parakusht për regjistrim të automjeteve) ka ndikuar në rënien e disiplinës së pagesës, sepse një pjesë e tatimpaguesve e ka pasur pagesën e tatimit në pronë të lidhur me këtë proces.

Të hyrat nuk janë të ndara veç e veç në “Tatimi në Pronë – Objektet” dhe “Tatimi në Pronë – Parcelat”, pasi ka ndryshuar sistemi i tatimit në pronë, i menaxhuar nga Departamenti i Tatimi në Pronë (MFPT) dhe ky sistem për momentin nuk gjeneron raport që i ndan të hyrat sipas këtyre dy kategorive. Si rrjedhojë, shumat në tabelë paraqiten në mënyrë të përgjithshme, pa ndarje analitike.

Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2025 € '000	2024 € '000	2023 € '000	% e totalit 2024	% e ndryshimit nga 2023
taksa për regjistrim të automjeteve	50001	87.42	79.43	71.96	10.05%	21.48%
taksa për regjistrim biznesi	50006			0.04		-100.00%
taksa për parkim publik, kamping dhe rekreacion	50008	20.43	18.71	9.36	9.16%	118.25%
taksa për leje ndërtimi	50009	160.39	30.76	117.06	421.38%	37.01%
taksa për regjistrimin e trashëgimisë - ndërrimi	50011	0.08		1.48		-94.46%
taksa për ndërrim të destinimit të pronës	50012	19.82	61.91	27.73	-67.98%	-28.50%
taksa për certifikatë të lindjes	50013	17.65	18.38	12.55	-3.95%	40.70%
taksa për certifikatë të kurorëzimit	50014	2.31	2.37	2.78	-2.74%	-17.02%
taksa për certifikatë të vdekjes	50015	0.63	0.59	0.65	6.75%	-2.31%
taksa për certifikata të tjera	50016	4.14	1.17	10.12	252.87%	-59.10%
taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	50017	0.15	0.12	0.13	22.69%	12.31%
taksa të tjera administrative	50019	53.36	82.18	56.60	-35.07%	-5.73%
taksa për pjesëmarrje në tender	50020			0.28		-100.00%
taksa për certifikatë mjekësore	50024	6.68	9.14	7.38	-26.93%	-9.55%
taksa për shtetësi	50025	0.51		0.00		25400.00%
taksa për legalizimin e objekteve	50026	7.55	20.54	9.90	-63.27%	-23.77%
taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste	50029		0.36	2.59	-100.00%	-100.00%
taksa për leje urbanistike	50030					
taksa për legalizim të dokumenteve	50031		0.40		-100.00%	
taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plan	50032	12.47	8.85	14.69	40.90%	-15.13%
taksa për leje mjedisore	50045	31.40	2.24	11.49	1304.62%	173.40%
gjjobat nga inspektorati	50104	3.14	2.29	7.44	37.42%	-57.77%
gjjobat e tjera	50107		6.00		-100.00%	
të hyrat nga shitja e mallrave	50403			8.07		-100.00%
shfrytëzimi i pronës publike	50405	1.96	2.66	1.45	-26.15%	35.48%
prona publike për tregti të hapur	50406			1.59		-100.00%
qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	50407	0.38	0.22	0.14	74.55%	178.26%
qiraja nga prona publike	50408	14.48	20.46	12.40	-29.22%	16.78%
participimet	50409	64.94	45.89	37.11	41.53%	75.03%
të hyrat nga shitja e pasurisë	50413	5.76				
receipts from debt and other fees for j.d and e.d.	50424	0.28	0.05		460.00%	
taksa për regjistrim të pengut	50460	0.91	2.73	1.85	-66.67%	-50.81%
matja e tokës në terren	50504	9.96	15.52	13.40	-35.85%	-25.70%
inspektimi higjeniko-sanitarë	50507					
Gjithsej		526.80	432.96	440.22	21.67%	19.67%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Të hyrat jo tatimore për vitin 2025 arrijnë në 526,799.98 €, krahasuar me 432,958.55 € në vitin 2024, duke shënuar rritje prej 21.67%. Krahasuar me vitin 2023 440,215.19 €, rritja është 19.67%. Rritja kryesisht është ndikuar nga realizimi më i lartë i të hyrave nga Taksa për leje ndërtimi, rritja e të hyrave nga Taksa për leje mjedisore dhe rritja e të hyrave nga Participimet. Po ashtu, rritje është shënuar edhe te Taksa për regjistrim të automjeteve dhe te disa tarifa të tjera komunale.

Në këtë shënim nuk janë paraqitur të hyrat indirekte, në shumë prej 237,885.92 €. Si rrjedhojë, shuma totale e të hyrave jo tatimore dhe të hyrave indirekte arrin vlerën 764,685.90 €.

Institucionet e nivelit qendror arkëtojnë të hyra nga shërbimet e kryera në territorin e komunave.

Të hyrat e arkëtuara në nivel qendror, si gjobat e Policisë, gjobat e Gjykatave dhe të hyrat nga prerja/shfrytëzimi i pyjeve, bartën te komunat në territorin e të cilave janë arkëtuar dhe përmes procesit të transferit, shpërndahen për shfrytëzim nga komuna.

Për periudhën TM1-TM4/ 2025, të hyrat indirekte vetanake të bartura për Komunën janë:

Policia e Kosovës (gjobat në trafik): 210,387.00 €

Gjykatat (gjobat): 18,402.00 €

Agjencioni i Pyjeve (taksat): 9,096.92 €

Gjithsej (TM1-TM4 / 2025): 237,885.92 €

Shënimi 10 Të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	Shënim e	2025	2024	2023	2024	% e ndryshimit nga 2023
		€ '000	€ '000	€ '000		
Lloji i të hyrës 1		-	-	-		
Lloji i të hyrës 2					%	%
Lloji i të hyrës 3					%	%
Lloji i të hyrës 4					%	%
Gjithsej		-	-	-	0%	%

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve

Përshkrimi			2025	2024	2023
			€ '000	€ '000	€ '000
Komuna Kaçanik	Subvencionimi për bujqësi me participim të qytetarëve	92500	21.95	0.34	2.77
Komuna Kaçanik	Subvencionimi për bletari me participim të qytetarëve	92504	1.58	-	4.78
Qeveria Zvicrane	GRANTI PER PERFORMANCE KOMUNALE 2024	92196		286.73	
Qeveria Zvicrane	GRANTI PER PERFORMANCE KOMUNALE 2025	92336	113.33	-	
Gjithsej			136.86	287.07	7.55

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Grantet e përcaktuara të donatorëve përfshijnë mjetet e pranuar për qëllime të caktuara, të cilat përdoren sipas kushteve/kritereve të përcaktuara nga dhënësi i grantit dhe nuk mund të rialokohen për qëllime të tjera.

Për vitin 2025, në këtë kategori janë realizuar të hyra në vlerë totale 136,857.60 €, të përbëra nga:

- Subvencionimi për bujqësi me participim të qytetarëve: - Në vitin 2025 janë realizuar 21,950.00 € participime. Këto mjete paraqesin subvencionim komunal për përkrahje në bujqësi, i zbatuar me participim të qytetarëve, sipas thirrjes publike të shpallur nga komuna, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
- Subvencionimi për bletari me participim të qytetarëve: - Në vitin 2025 janë realizuar 1,580.00 € participime. Këto mjete paraqesin subvencionim komunal për përkrahje në bletari, i zbatuar me participim të qytetarëve, sipas thirrjes publike të shpallur nga komuna, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
- Qeveria Zvicerane – Granti për Performance Komunale- Marrëveshja 2025
Në vitin 2025 janë realizuar të hyra në vlerë 113,327.60 €. Ky grant mbetet i dedikuar për qëllime të përcaktuara në kuadër të programit të performancës komunale për vitin 2025 dhe është përdorur sipas kushteve të marrëveshjes mes MAPL – së, DEMOS dhe Komunës.

Shënimi 12 Tjera

Natyra e pranimi	2025 € '000	2024 € '000	2023 € '000
Depozitat 1	-	-	-
Depozitat 2			
Depozitat 3			
Depozitat tjera			
↓			
Gjithsej	-	-	-

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

Kategoria ekonomike	2025	2024	2023
	€ '000	€ '000	€ '000
Paga dhe shtesa	-	-	-
Mallra dhe shërbime			
Shpenzime komunale			
Transfere dhe subvencione			
Shpenzime kapitale			
Gjithsej pagesat nga palët e treta	-	-	-

Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1:

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet (zbatohet për organizatat që mbledhin të hyra)

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2025	2024	2023
40110	Tatimi në pronë	2,263,059.99	2,042,630.00	1,694,781.61
50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë	219,070.00	219,070.00	219,430.00
50405	Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike	47,514.35	54,291.36	58,926.62
Gjithsej		2,529,644.34	2,315,991.36	1,973,138.23

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 2:

Data e lëshimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	20__
Gjithsej						0

Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

		2025		2024		2023	
Kategoria							
Ekonomike	Kategoria ekonomike	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe shtesa		39,138.40		100,249.60		
13	Mallra dhe shërbime	8,837.15	178,529.64	1,261.69	54,759.84	7,752.40	91,134.82
14	Shpenzime komunale						
20	Transfere dhe subvencione	1,800.00	1,292.00		860.00		
30	Shpenzime kapitale		69,481.74		1,555.07		
Gjithsej		10,637.15	288,441.78	1,261.69	157,424.51	7,752.40	91,134.82

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 3

Data e pranimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës	20__
Gjithsej							0

Neni 18 Detyrimet kontingjente

Kategoria ekonomike	Kategoritë ekonomike	2025	2024	2023
11	Paga dhe shtesa	1,299,550.53	1,755,491.53	1,954,234.00
13	Mallra dhe shërbime	6,789.00	13,500.00	21,589.00
14	Shpenzimet komunale			
20	Subvencione dhe Transfere			
30	Shpenzimet kapitale	720,089.00	589,296.00	583,935.00
Gjithsej		2,026,428.53	2,358,287.53	2,559,758.00

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 4

Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2025	2024	2023
Ndërtesa	10,974,479.47	11,334,680.01	12,536,147.95
Toka	49,049,164.12	49,049,164.12	48,869,952.60
Pajisjet	141,953.00	140,595.01	187,444.80
Infrastruktura	8,144,019.23	8,802,573.38	8,178,211.05
Makineria	-	-	-
Automjetet	272,945.98	363,701.93	459,963.02
Tjera	15,666,154.90	12,763,060.29	10,470,649.67
Gjithsej	84,248,716.70	82,453,774.74	80,702,369.09

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 5

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2025	2024	2023
Pajisjet dhe mobiljet	206,590.76	210,073.39	97,154.00
Gjithsej	206,590.76	210,073.39	97,154.00

Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 6:

Neni 19.3.3 Stoqet

Klasifikimi i pasurive	2025	2024	2023
Stoqet			210.00
Gjithsej	-	-	210.00

Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 7:

Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara

<u>Data e lëshimit</u>	<u>ID e furnitorit te Zyrtarit</u>	<u>Nr i kuponit të shpenzimit</u>	<u>Arsyeja</u>	<u>2025</u>
				-
Gjithsej				-

Shpalos me poshtë në detaje shënimet nga tabela:

Nga vlera e përgjithshme e avanseve të hapura, 684.40 € janë avanse të bartura që datojnë që nga viti 2010.

Në bazë të raporteve të gjeneruara nga SIMFK për kodet ekonomike 13810 dhe 13820 për vitin 2010, rezulton se këto dy avanse janë të mbyllura, andaj nuk ka avanse të paarsyetuara për këtë periudhë.

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara

Përshkrimi	2025	2024	2023
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	1,033,041.11	1,098,068.10	814,722.67
Të hyrat e pranuar në këtë vit	1,036,330.65	980,616.57	1,092,747.68
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	2,069,371.76	2,078,684.67	1,907,470.35
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	(1,640,599.31)	(1,045,696.56)	(809,442.35)
Bilanci për bartje	428,772.45	1,032,988.11	1,098,028.00

Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim

Përshkrimi	2025	2024	2023
Të hyrat nga fondi zhvillimor ne mirebesim nga viti i kaluar	-	-	-
Të hyrat e pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Bilanci për bartje	-	-	-

Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	2025	2024	2023
Të hyrat e dedikuara nga viti i kaluar	-	-	-
Të hyrat e dedikuara të pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Bilanci për bartje	-	-	-

Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara

Përshkrimi	2025	2024	2023
Grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti i kaluar	36,687.01	5,333.90	2,561.00
Grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar në këtë vit	136,857.60	287,073.76	7,554.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	173,544.61	292,407.66	10,114.85
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	(170,983.76)	(255,720.65)	(4,780.95)
Bilanci për bartje	2,560.85	36,687.01	5,333.90

Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e Buxhetit Nr. 08/L-332	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Administrata Komunale	112	99		117		123	
Kuvendi Komunal	27	27		27			
Zjarrëfikësit	18	15		17		18	
Arsim	531	530		517		528	
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	134	126		121		117	
Gjithsej	822	797	0	799	0	0	0

Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1	0	0	0	0	0	0
Departamenti 2						
Departamenti 3						
Gjithsej	0	0	0	0	0	0

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave të angazhuar.

Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime te veçanta

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Kryetarit					1	
Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	1				1	
Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	3		2		2	
Gjithsej	4	0	2	0	4	0

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave te angazhuar.

Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

- Përmes procedurave të rregullta të prokurimit, ka kontraktuar një konsulente për projektin: “Shërbime konsulente për kompletimin e Draftit të PZHK-së”.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- Meqenëse ka qenë e pamundur të angazhohen si staf i rregullt përmes procedurave të konkursit, për shkak të mungesës së interesimit për aplikim, Komuna e Kaçanikut përmes procedurave të rregullta të prokurimit ka angazhuar gjithsej 3 mjek specialistë në sektorin e shëndetësisë: një pulmolog, një gjinekologe dhe një radiolog.

Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
1	Rekomandimi B1: Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Këto pagesa janë ekzekutuar nga Departamenti i Thesarit (MFPT), pa propozim të Komunës se nga cila kategori ekonomike të tërhiqen ato mjete. Pothuajse e gjithë kjo shumë vjen si pasojë e Kontratës Kolektive në sektorin e arsimit, e nënshkruar nga Qeveria, mirëpo barra financiare e mbetur tek komuna. Ne do të kërkojmë nga Thesari (MFPT) të konsultohen paraprakisht me komunën për kategorizimin e saktë të pagesave të këtij lloji.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
2	Rekomandimi A1: Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël sipas kërkesave ligjore.	Janë regjistruar pothuajse gjitha pasuritë jokapitale në sistemin “e-pasuria”; do të bëhen verifikime të rregullta mes blerjeve dhe regjistrimeve në këtë sistem pas trajnimit të zyrtarit përgjegjës për përdorimin e sistemit “e-pasuria”.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
3	Rekomandimi A2: Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, duke i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.	Është forcuar procesi i monitorimit të ekzekutimit të projekteve kapitale dhe do të raportojmë çdo devijim të mundshëm në këto projekte.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
4	Rekomandimi A3: Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e paarsyetuara të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Është punuar në realizimin e punëve bazuar në planin dinamik dhe afateve të parapara në kontratë. Dinamika e punëve përcillet në vazhdimësi nga menaxherët dhe mbikqyrësit përkatës të kontratave të caktuara.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
5	Rekomandimi A4: Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Për shkak të mungesës së stafit në Zyrën e Tatimit në Pronë, nuk ka qenë e mundur të kryhet inspektimi i nevojshëm (20% e pronave). Nga Zyra e Tatimit në Pronë, ose do të punësohet ndonjë zyrtar për verifikim të pronave ose do të shqyrtohet mundësia e kontraktimit të ndonjë kompanie private.	12 muaj	I pa zbatuar	

6	Rekomandimi B2: Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/ punëve.	Do të vazhdon të bëhet procedimi i pagesave sipas procedurave të parapara në Rregullën Financiare 01/2013/MF. Para pranimi të punëve/mallërave/shërbimeve do të bëhet zotimi apo kërkesa për blerje.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
7	Rekomandimi A5: Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara për të gjitha kontrata e lidhura.	Janë planifikuar dhe analizuar kostot finale të projekteve dhe për të njejtat do të parashihen shuma edhe në projeksionet buxhetore sipas kërkesave buxhetore.	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
8	Rekomandimi B3: Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Tash mbahet një regjistër (protokol) i faturave, ku shënohet data e pranimi, bashkë me datën e afatit për pagesë çka mundëson të bëhet planifikim më i saktë edhe i planit të rrjedhës së parashë (cash plan).	12 muaj	Pjesërisht i zbatuar	
9	Rekomandimi B4: Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Janë ndërmarrë gjitha hapat e nevojshëm që mos të paraqitet prapë kjo gjetje.	12 muaj	I zbatuar	
10	Rekomandimi B5: Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Edhe përkundër trajnimit për menaxhimin e kontratave përmes e-prokurimit, menaxherët akoma nuk kanë filluar me punë përmes këtij sistemi.	12 muaj	I pa zbatuar	

11	Rekomandimi B6: Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Tek llogaritë e arkëtueshme, përveç Zyrës së Tatimit në Pronë, që ka sistemin ProTax dhe menaxhohen regjistrat e saktë, taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe taksa për shfrytëzim e pronës publike i azhurnojnë regjistrat vetëm në excel. Janë zhvilluar aktivitete të nevojshme për uljen e nivelit të llogarive të arkëtueshme. Shembull: për përditësimin e të dhënave të biznesit, nevojitet të paguhet obligimi që rrjedh nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë; për të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i pronës publike, komuna ka pasur marrëveshje me disa operator ekonomik, kurse në rast të mosrespektimit të marrëveshjes, janë bërë propozimet për përmbarim. Janë shqyrtuar edhe mundësitë e eliminimit apo faljes së borxheve të vjetëruara (taksa për ushtrimin e veprimtarisë).	12 muaj	I pa zbatuar	
12	Rekomandimi A6: Komuna duhet të sigurojë që NjAB të mos mbetet pa udhëheqës se NjAB- se dhe të ndërmarr masa në angazhimin e një udhëheqës se NjAB-se.	Kjo çështje është adresuar, pasi komuna ka përfunduar procedurat e rekrutimit për këtë pozitë të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB).	12 muaj	I zbatuar	

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

- Rekomandimi A- nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja. (6)
- Rekomandimi B- nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura. (6)



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01-Nr. 104/02-3795/26
Kaçanik, 10.02.2026

Njësia e auditimit të brendshëm

DATË/A:	
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Sabedin Vishi- Kryetar i Komunës
CC:	Komiteti i Auditimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Pranverë Loku Zharku-Auditore e Brendshme
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti vjetor për vitin 2025 të NJAB-Kaçanik



I nderuar Kryetar,

Duk u bazuar ne Ligjin nr. 06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm te Financave Publike , NJAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik(Kryetarit) dhe e njofton Komitetin e Auditimit.
Kam nderin që me anë të kësaj shkrese t'iu paraqes Raportin Vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 të komunës së Kaçanikut .

Ju falënderoj për bashkëpunim!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**RAPORTI VJETOR
LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE
AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN
2025**

Kaçanik, shkurt 2026

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
2. HYRJE.....	5
3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETE E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	6
3.1. Aktivitetet planifikuara e NJAB.....	6
3.1.1. Aktivitete e auditimit.....	6
3.1.2. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve, aktiviteteve këshillëdhënëse dhe aktivitete tjera.....	6
3.1.3. Trajnime, seminare, përgatitja e raporteve, përgatitja e materialeve për Komitetin e Auditimit , përgatitja e materialeve për auditorët e jashtëm , takime me KA , takime me auditorët e jashtëm takime me menaxhmentin.....	6
3.1.4. Përgatitja e planit strategjik dhe vjetor.....	6
3.2. Aktivitete e realizuara NJAB gjate vitit 2025.....	7
3.2.1. Aktivitete e auditimit.....	7
3.2.2. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve, aktiviteteve këshillëdhënëse dhe aktivitete tjera.....	7
3.2.3. Trajnime, seminare, përgatitja e raporteve, përgatitja e materialeve për Komitetin e Auditimit , përgatitja e materialeve për auditorët e jashtëm , takime me KA , takime me auditorët e jashtëm takime me menaxhmentin etj.....	8
3.2.4. Planifikim strategjik dhe vjetor.....	8
4. KONKLuzionET.....	9
5. REKOMANDIMET.....	9

LISTA E SHKURTESAVE

1. **NJAB** - Njësia e Auditimit të Brendshëm
2. **NJQH/AB** – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm
3. **SSP** - Subjekti i Sektorit Publik
4. **IAB** - Instituti i Auditimit të Brendshëm
5. **AB** – Auditori Brendshëm
6. **AJ**-Auditori i jashtëm
- 7.**KBFP**-Kontrolli i brendshëm i financave publike
- 8.**QRK**-Qeveria e Republikës së Kosovës
- 9.**MFPT**-Ministria e Financave, Punës dhe transfereve

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komuna e Kaçanikut ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm si Njësi e Auditimit në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik sipas nenit 19, pika 1.2 e Ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe në pajtim me Rregulloren e QRK nr. 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik .

Po ashtu në harmoni me nenin 20 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike është i themeluar edhe Komiteti i Auditimit.

Ky raport në përgjithësi prezanton zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në komunën Kaçanikut për vitin 2025.

Këtu përfshihen aktivitetet e NJAB, konkluzionet dhe rekomandimet për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik .

Auditimi i brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës funksionon në mënyrë të decentralizuar, me palët e interesuara në vijim: Njësitë e Auditimit të Brendshëm, Auditorët e Brendshëm, Komiteti i Auditimit, Menaxhmentin e lartë si dhe NJQH/AB.

Plani vjetor është hartuar në bazë të kohës efektive të punës.

Ndikimi i punës së auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e Komitetit të auditimit.

Rekomandimet tona kryesore janë:

- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmerr veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse;
- Zbatimi i ligjit të auditimit të brendshëm, funksionalizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas Rregullores QRK 01/2019, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm;
- Komiteti i auditimit të rishikojë burimet, planet dhe rezultate të NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës;
- Njoftimi me kohë me ndryshimet legislative dhe aplikimi i tyre brenda afateve sa më të shkurta;
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit e në veçanti në fushat ku ka ndryshime të legjislacionit për qasje në sistemin e SIMFK-së.
- Përgatitja e stafit alternativ për një numër të madh funksioneve komunale për ushtrimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të përditshme komunale

2. HYRJE

Raporti është përgatitur në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, duke paraqitur një analizë mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Raporti vjetor për vitin 2025 është përgatit bazuar në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) dhe nenin 25 paragrafi 3.5 të Ligjit për KBFP, drejtori i NJAB çdo vit kalendarik përgatit dhe dërgon raporte vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të njësisë së auditimit të brendshëm tek menaxhmenti i lartë i SSP (kryetari), NJQH-AB dhe e njofton komitetin e auditimit të organizatës buxhetore.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktivitetëve të auditimit të brendshëm në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2025 si dhe të aktivitetëve të NJAB, krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerat dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes”

Qëllimi i këtij raporti është përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi të NJAB në bazë të ligjit të KBFP **Nr. 06/L-021** dhe përmbushjes së detyrave dhe obligimeve karshi planit vjetor dhe shkallën e realizimit të tij.

3.1.Aktivitetet e planifikuara NJAB

Objektivë e auditimit të brendshëm është vlerësimi i proceseve të veprimit të kontrollit përbrenda organizatës bazuar në vlerësimet e përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e audituara.

NJAB gjatë vitit 2025 aktivitetin e vet e ka zhvilluar duke u bazuar në Planin e Punës për vitin 2025 i cili është në harmoni të plotë me strategjinë për funksionimin e auditimit të brendshëm, Planin Strategjik për vitet 2025-2027 në bazë të resurseve njerëzore në momentin aktual. Planit strategjik dhe plani vjetor janë miratuar nga Kryetari i komunës dhe Komitetit i auditimit.

Aktivitetet kryesore të NJAB për vitin 2025 kanë qenë të përqendruara në përmbushjen e planit vjetor dhe atë:

3.1.1.Aktivitete të auditimit:

Njësia e Auditimit të brendshëm me planin e punës për vitin 2025 janë paraparë të kryhen pesë(5) auditime për dhënien e sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore-Komunë e Kaçanikut dhe atë:

1. Auditimi i procesit të Shpenzimeve për subvencione dhe transfere. Fushëveprimi viti 2024;
2. Auditimi i procesit të Menaxhimit të projekteve, Fushëveprimi kontratat e lidhura në vitin 2024;
3. Auditimi i procesit të Menaxhimit të pasurisë. Fushëveprimi: 01.07.2024-30.06.2025
4. Auditimi i procesit të hyrat në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Fushëveprimi 01.01.2025-30.09.2025
5. Auditimit i procesit të Menaxhimit të burimeve njerëzore. Fushëveprimi 01.01.2025-30.10.2025
6. Proces i auditimit sipas kërkesës së menaxhmentit .

3.1.2. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve, aktiviteteve këshillëdhënëse dhe aktivitete tjera

3.1.3. Trajnime, seminare, përgatitja e raporteve, përgatitja e materialeve për Komitetin e Auditimit, përgatitja e materialeve për auditorët e jashtëm , takime me KA , takime me auditorët e jashtëm, takime dhe konsultime NJQH-AB(MFPT) si dhe takime me menaxhmentin.

3.1.4. Përgatitja e Planit Strategjik 2026-2028 dhe Planit Vjetor për vitin 2026

3.2.AKTIVITETE E REALIZUARA TË NJAB-së PER VITIN 2025

3.2.1. Auditimet e kryera gjatë vitit 2025

Njësia e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2025 nuk ka arritur të përmbush në tërësi Planin vjetor të punës.

Arsyeja e mos kryerjes së auditimeve sipas planit vjetor për vitin 2025 ka qenë pensionimi i auditores në muajin mars si dhe procedurat e rekrutimit të cilat kanë zgjatur deri më datë 14.08.2025 ku dhe është plotësuar pozita e auditorit të brendshëm të Komunës.

Duke marrë në konsiderate afatin e shkurtër kohor për realizimin e auditimeve të planifikuara, në muajin shtator kemi bërë rishqyrtimin e planit vjetor i cili është miratuar nga Kryetari i komunës si dhe Komiteti i Auditimit.

Auditimet e kryera gjatë vitit 2025 përfshijnë auditimet e sistemit të pajtueshmërisë dhe rregullsisë, të cilat kryesisht kanë mbuluar me auditimet në këto fusha:

1. Auditimi i projekteve “ Ndërtimi i hapësirave publike dhe parqeve në lokacionet Kaçanik i vjetër dhe Lagjja Hajdari në fshatin Rekë. Proces i auditimit me kërkesë të Kryetarit të komunës. Fushëveprimi i auditimit: viti 2024.
2. Auditimi i procesit të të hyrave në drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Fushëveprimi i auditimit 01.01.2025-30.09.2025

Fushëveprimi i auditimeve të kryera është kryesisht auditime të vitit aktual dhe vitit paraprak. Secili nga auditimet e kryera ka përfunduar me një raport të shkruar i cili raport iu ka përcjell etnitetit të audituar, Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit. Nga këto auditime të kryera janë dhënë gjithsej 12 rekomandime për përmirësimin e kontrolleve të brendshme të vendosur nga menaxhmenti dhe funksionalizimin e tyre. Të gjitha këto raporte janë shqyrtuar në Komitetin e Auditimit dhe janë dhënë rekomandime menaxhmentit për zbatim .

3.2.2. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve, aktiviteteve këshillëdhënëse dhe aktivitete tjera

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të auditimit të brendshëm dhe planit të ndryshuar të punës për vitin 2025, kam bërë përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera në vitin 2025.

Si rezultat i këtyre auditimeve, janë dhënë 12 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti ka pranuar rekomandimet dhe ka ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimeve.

Nga 12 rekomandimet e dhëna : 3 rekomandime janë zbatuar plotësisht, 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht si dhe janë në proces të zbatimit 8 rekomandime të tjera.

Në të gjitha fushat e rekomanduara janë zhvilluar aktivitete e parapara për zbatimin e rekomandimeve.

Në procesin e auditimit të projektit “ Ndërtimi i hapësirave publike dhe parqeve në lokacionet Kaçanik i vjetër dhe Lagjja Hajdari në Fshatin Rekë. ” janë dhënë tre (3) rekomandime. Në lidhje me implementimin e këtyre rekomandimeve menaxhmenti ka ndërmarrë aktivitete për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe nga tre (3) rekomandime , dy(2) janë zbatuar plotësisht dhe një(1) rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Në procesin e auditimit “ Të hyrat në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. “ janë dhënë 9 rekomandime. Përshkak se auditimi është kryer në fund të vitit 2025, Menaxhmenti ka ndërmarrë disa aktivitete për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe implementimi i tyre është përcaktuar të bëhet gjatë muajve janar-mars 2026. Nga 9 rekomandime , një (1) rekomandim është zbatuar plotësisht ndërkaq tetë (8) rekomandime janë në proces. Këto rekomandime dhe rekomandimet e zbatuara pjesërisht mbeten në data bazën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për përcjellje.

Për të gjitha këto të gjetura janë dhënë rekomandime adekuate për përmirësimin. Janë përgatit draft raportet dhe u janë përcjell menaxhmentit të njësisë së audituar. Të gjitha draft raportet janë diskutuar me menaxhmentin, për të cilat menaxhmenti ka ofruar plan për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Raportet finale janë përcjell Kryetarit, komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të njësisë së audituar.

NJAB gjithashtu ka raportuar edhe përmes Sistemin Informativ për Raportim të Auditimit të Brendshëm -SIRAB.

3.2.3. Trajnime, përgatitja e raporteve, përgatitja e materialeve për Komitetin e Auditimit , përgatitja e materiale për auditorët e jashtëm, takime me KA, takime me auditorët e jashtëm takime me menaxhmentin etj.

Gjatë këtij viti janë realizuar edhe aktivitet e planifikuara si : Përgatitja e raporteve tremujore për menaxhmentin dhe Komitetin e auditimit, përgatitja e raportit vjetor 2025 dhe raporti i gjashtëmujorit të II për vitin 2025 dhe punë tjera administrative. Të gjitha raportet janë dorëzuar në afatet ligjore.

Përgatitja e informatave për Auditorët e jashtëm dhe asistence për Komitetin e auditimit .

Janë mbajtur takime me menaxhmentin, takime me auditorët e jashtëm, takime me NJQHAB, Komitetin e auditimit etj.

Komiteti i auditimit ka qenë aktiv dhe gjatë vitit ka mbajtur dy mbledhje të parapara në gjashtëmujorin e dyte, ku ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha raportet e auditimit, planin vjetor dhe strategjik dhe raportet gjashtëmujore dhe vjetore mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna.

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 ka qenë e monitoruar në vazhdimësi nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve , e cila kujdeset për arritjen e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha Standardet e parapara me Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale në fushën e auditimit.

Për të siguruar avancimin e vazhdueshëm profesional , NJAB ka pasur trajnime në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

3.2.4. Planifikimi strategjik dhe vjetor

Planifikimi është një funksion themelor menaxherial për të gjitha subjektet e sektorit publik.

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike është përcaktuar koha e hartimit dhe dorëzimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të angazhimeve të kapaciteteve audituese. Kështu që gjatë muajit dhjetor 2025 është përgatitur Plani Strategjik 2026-2028 ku janë parapara objektivat kryesore në një cikël trevjeçar të auditimeve, si dhe Plani Vjetor i angazhimit të kapaciteteve audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2026.

Plani strategjik 2026-2028 dhe Plani Vjetor për vitin 2026 i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur nga auditorja e brendshme, në bazë të vlerësimit të rrezikut. Vlerësimi i rrezikut është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes metodave si: takimeve dhe intervistave me menaxhmentet e drejtorive komunale, zyrtarë komunal, pastaj nga analizat e rezultateve të dalura nga auditimet e mëparshme, nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera. Këto plane janë miratuar nga menaxhmenti i lartë dhe komiteti i auditimit dhe pas miratimit janë dorëzuar në NJQH/AB në afatin ligjor.

Plani vjetor i auditimit është i ndarë nga plani strategjik dhe në të specifikohen auditimet që duhet të kryhen, fushëveprimi i tyre, objektivat si dhe afatin kohor.

Ky aktivitet është realizuar sipas planifikimeve të parashikuara me plan të punës për vitin 2026.

4. KONKLuzionet

Për realizimin e planit vjetor të punës sfidë mbetet mungesa e burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave strategjike të NJAB, që ka qenë edhe rekomandim i NJQHAB. Ndikimi i punës së auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e komitetit të auditimit.

5. REKOMANDIMET

Për të adresuar çështjet e paraqitura në seksionet e mëparshme, ne rekomandojmë veprimet si në vijim:

- Plotësimi i stafit për Njësinë e auditimit të brendshëm;
- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmerr veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse;
- Zbatimi i ligjit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike nr.06/L-021, funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm sipas Rregullores QRK 01/2019, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm;
- Komiteti i auditimit të kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas UA 01/2019, të rishikojë burimet, planet dhe rezultatet e NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.

Pranverë Loku Zharku- Auditore e Brendshme





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtorja e Arsimit
04 Nr 610/01-1989/26

INFORMATË
Për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2025-2026

Kaçanik, Janar/Shkurt 2026

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor
3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve
 - 3.1 Transporti i nxënësve
4. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimit parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
 - 5.1. Rrjeti shkollor
 - 5.2. Sukseset e nxënësve – Arsimit fillor
6. Arsimit i Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
 - 6.1. Numri i nxënësve dhe sukseset e tyre në dy nivelet 1 dhe 2
7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambarajtura të mësimdhënësve
8. Edukimi dhe Arsimit i Mesëm i Lartë (AML X – XII)
 - 8.1. Numri i nxënësve
 - 8.2. Sukseset e nxënësve
9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambarajtura të mësimdhënësve

Shkurtesat:

- DA Drejtoria e Arsimit
- MASHITI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- APF Arsimit Parafillor ose niveli 0
- AF Arsimit Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU Arsimit i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML Arsimit i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF Arsimit Joformal
- ShML Shkolla e Mesme e Lartë

- IAAAP Institucioni i Aftësimit dhe Arsimit Profesional
- SHENAT Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ujët
- QLEAP Qendra për Edukimin dhe Arsimin Parafillor

1. Hyrje

Informata për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor ka për qëllim të informoj publikun e gjërë dhe institucionet komunale mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut gjatë Gjysmëvjetorit të Parë, për vitin shkollor 2025 - 2026. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit të ri shkollor, përgatitjet e objekteve shkollore, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e fëmijëve në klasat parafillore, atyre në klasat e para dhe klasë të dhjetra, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët e mesëm të lartë dhe suksesin e arritur gjatë këtij gjysmëvjetori mësimor.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesin e arritur, kuadrin arsimor, mungesat e nxënësve e të mësimitdhënësve dhe të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezantuara janë bazë e mirë dhe mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, i cili zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, Mesëm të Ujët dhe Mesëm të Lartë).

Viti i ri shkollor 2025 – 2026, përkatësisht Gjysmëvjetori i parë ka filluar me 1 shtator 2025 dhe ka përfunduar më 24 dhjetor 2025, sipas kalendarit shkollor të hartuar nga MASHTI. Mësimi filloi në të gjitha institucionet arsimore: në 21 institucione shkollore të nivelit Fillor e Mesëm i Ujët, prej tyre 16 shkolla të plota 1 - 9 dhe 4 të tjera ku mësimi zhvillohet për klasat 1-5 ndërkq, në 1 shkollë mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-4, në 2 institucione të Mesme të Larta dhe në 1 qerdhe për fëmijë.

2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

Edhe këtë vit shkollor, me kohë kanë filluar përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2025/26, në përputhje me nevojat e identifikuar dhe kërkesat për fillimin sa më të mbarë të procesit edukativ arsimor në Komunën tonë. Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e këtij fillim viti shkollor, sivityt janë regjistruar gjithsej 284 fëmijë para fillor,

prej tyre 254 në shkollat fillore dhe 30 të tjerë në QEAP "Agimi" në Kaçanik, apo 68 më pak krahasuar me vitin e kaluar (352 fëmijë), ndërkaj në klasat e para këtë vit shkollor janë regjistruar 338 fëmijë, apo 34 më pak se një vit më parë (372).

Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjinnazin "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".

Në Gjinnazin "Skënderbeu", në klasat e dhjeta janë regjistruar 155 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore**, 4 paralele me 83 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shoqërore-Gjuhësore**, 3 paralele me 72 nxënës.

Ndërkaj, në IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 156 nxënës në 10 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 272 nxënës të ndarë në 3 Drejtimet:

Numri i nxënësve të regjistruar sipas drejtimeve dhe profileve në klasat e dhjeta:

1. **Elektroteknikë me profilet:**
 - Instalues Elektrikë, 1 paralele me 21 nxënës nga 24 të planifikuar
 - Informatikë, 1 paralele me 19 nxënës nga 32 të planifikuar
2. **Ekonomi me profilet**
 - Kontabilitet dhe tatime me 1 paralele me 18 nxënës nga 32 të planifikuar
 - Tregti me shumicë dhe pakicë, 1 paralele me 15 nxënës, nga 32 të planifikuar
 - Marketing dhe shitje, 1 paralele me 18 nxënës nga 32 të planifikuar
3. **Makineri me profilet:**
 - Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit e kanalizimit, 2 paralele me 32 nxënës të regjistruar nga 48 të planifikuar
 - Automekanik, 1 paralele me 11 nga 24 të planifikuar
 - Operator prodhimi, 1 paralele me 12 nxënës nga 24 të planifikuar
 - Trafik rrugor, 1 paralele me 10 nxënës nga 24 të planifikuar

Sivjet për herë të parë në IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" kanë filluar dy paralele, Tregti me shumicë dhe pakicë, 1 paralele dhe Automekanik, 1 paralele me mësim dual që nënkupton një sistem i kombinuar i lëndës mësimore në shkollë me aftësimin profesional praktikë, ndërkaj në nivel vendi ky lloj mësimi i kombinuar kishte filluar në disa shkolla të vendit në vitin shkollor 2023 – 2024.

Sa i përket kuadrit arsimor, DKA gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit për pozitat e lira: 4 mësimdhënës të mësimit klasor (një në SHFMU “E. Duraku” në Kaçanik, një në SHFMU “Agim Bajrami” në Shtegovë, një në SHFMU Gafur Luma në Gllloboçicë dhe një në SHFMU “Dituria” – Paralelja në Strazhë, një mësimdhënës të lëndës së matematikës në SHFMU “Gafur Luma” në Gllloboçicë (zëvendësim), një mësimdhënës të Kimisë me kohë të caktuar në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me plotësim orësh në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, një mësimdhënës të Biologjisë, po ashtu me kohë të caktuar në SHFMU “7 Shtatori” në Begracë, një mësimdhënës të Gjuhës angleze në SHFMU “Dituria” – Paralelja në Strazhë, një mësimdhënës të lëndës TIK në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me plotësim orësh në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, një mësimdhënës të lëndëve të Makinerisë në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”, një mësimdhënës të lëndës së Gjeografisë në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik dhe dy edukatore në Qerdhën “Agimi” në Kaçanik.

3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve

Para fillimit të vitit të ri shkollor, në SHFMU “Jusuf Gërvalla” – Paralelja e ndarë në Nikaj është bërë ljerja e sipërfaqes së brendshme të objektit shkollor, ndërsa janë kryer edhe disa renovime në hapësirën e jashtme shkollore. Vlen të theksohet se ky aktivitet është bërë me mjete dhe punë vullnetare të komunitetit të fshatit. Renovime janë bërë edhe në SHFMU Emin Duraku”, objekti në Dushkajë, objekti i SHFMU “Idriz Seferi” në Bob dhe ai i SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj, ndërsa është shpenzuar shuma mbi 30 mijë euro, mjete nga buxheti komunal. Janë siguruar edhe 7 gjenerator në vlerë prej 51,849 euro, ku disa nga shkollat janë pajisur me nga një gjenerator, pastaj kabinetet e IAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka” në Kaçanik janë furnizuar me materiale në vlerë 13,641 euro dhe, me kohë dhe mjaftueshëm janë furnizuar të gjitha shkollat me lëndë djegëse, pelet dhe dru.

Ndërkaj, që gjatë muajit Tetor, në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob është përfunduar Palestra sportive janë shpenzuar gjithsej 367 mijë euro, nga buxheti i komunës prej të cilave 200 mijë euro janë investuar vitin e kaluar (2024) dhe 167 mijë euro, gjatë vitit 2025. Po ashtu, Palestra sportive në shkollën e Bobit është furnizuar edhe me pajisje sportive në vlerë mbi 60 mijë euro, mjete të financuara nga MASHTI. Ndërkohë kanë rifilluar punët për ndërtimin e objektit shkollor në Doganaj i filhuar më 2019, ndërsa ishte planifikuar të përfundonte më 2022, e po ashtu, janë duke u zhvilluar punët për ndërtimin e objektit të qerdhës për fëmijë në fshatin Reke. Të dy këto projekte janë duke u financuar nga MASHTI, përkatësisht Qeveria e vendit.

Edhe sivjet, sikurse edhe dy vitet e kaluara, Ministria e Arsimit nuk ka bërë furnizimin e nxënësve me libra shkollore, ndërsa i ka subvencionuar me nga 80 euro nxënësit e nivelit 1 – 5, e po ashtu, me nga 80 euro edhe ata të nivelit 6 – 9, por jo edhe ata të nivelit para fillor.

Furnizimi i nxënësve me libra ka qenë një nga sfidat e këtij filim viti shkollor, sikurse që ishte edhe dy vitet e kaluara. Vlen të theksohet se ka shumë raste kur prindërit për shkak të ndryshme nuk kanë arritur të aplikojnë në sistemin eKosova, andaj edhe fëmijët e tyre kanë ngelur pa tekste shkollore, sikurse që ka edhe raste ku për shkak të panjohura akoma nuk është bërë pagesa respektivisht subvencionimi i librave për nxënës.

Në Komunën e Kaçanikut nuk ka asnjë librar, kështu që prindërit dhe nxënësit janë detyruar të gjejnë alternativa për furnizim në qytetet tjera e madje edhe në një shtore ushqimore/minimarket, këtu brenda qytetit të Kaçanikut e cila po merret edhe me furnizimin e nxënësve me libra.

3.1 Transporti i nxënësve

Edhe këtë vit shkollor 2025-2026 sikurse edhe tri vitet e kaluara shkollore (2022 – 2023, 2023 – 2024 dhe 2024 - 2025), Drejtoria e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimit dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Mbi 14 mijë (14.375) euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, pastaj nxënësve të lokaliteteve Gllboçicë, Kollinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijnë mësimet në Gjimnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të disa shkollave fillore të cilët udhëtojnë nga fshati Llanishtë në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, nxënësit e fshatit Semajë, të cilët udhëtojnë në shkollën e Elezajve dhe atyre të Slatinës të cilët udhëtojnë në shkollën e Doganajve. E po ashtu edhe të dy nxënësve të fshatit Kollinë që udhëtojnë në shkollën e fshatit Kovaçec dhe anasjelltas. Ndërkaq, është 760 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas. Ndërkaq, që pritet që edhe të gjithë nxënësve tjerë të cilët vijnë mësimet në Gjimnazin “Skënderbeu” të iu hiqen shpenzimet e udhëtimit, po ashtu nga buxheti i Komunës.

4. Ngritja e cilësisë - Zbatimi i Kurrikulës së re

DKA, mbështet dhe përkrahë përkujdesjen për ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit tanë të përfillojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre ne vend e më gjërë. Po ashtu, DKA vazhdimisht identifikon nevojat e mësimdhënësve për trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku synohet aplikimi i shkathësisë të reja, por edhe zhvillimit e ngritjes profesionale, ndërkaq zbatimi i Kurrikulës së re bërtarnë dhe ngritja e sistemit efikas ofron mundësi për sigurimin e cilësisë dhe përgatitjen e nxënësve për sfidat e jetës.

Me qëllim të ngritjes së cilësive në arsim, rritjes/shtimit të nivelit të përgjegjësisë dhe angazhimit më të madh në shkollë, përgjatë 5 ditëve (krisesht vikendeve, e shtunë dhe e diel) është mbajtur një trajnim me temë: Programi për rishikimin/përmirësimin e teksteve shkollore, me mësimdhënësit e arsimit fillor, mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Edhe gjatë këtij Gjysmëvjetori, Ekipi Komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta ka identifikuar dhe vlerësuar 5 fëmijë me nevoja të veçanta, sipas kërkesave të prindërve. Për rastet e vlerësuara janë dhënë rekomandimet përkatëse si: sigurimi i asistentes, sigurimin e transportit etj. Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë vitit shkollor 2025 – 2026 është duke i subvencionuar me nga 60 – 100 euro për muaj për 21 fëmijë me nevoja të veçanta, për periudhën shator 2025 deri në Qershor 2026.

5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan-programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarevajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësive në mësimdhënie dhe nxënie.

Edhe gjatë këtij gjysmëvjetori, rëndësi e veçantë është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësisë, aftësisë për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe ndërtimit të personalitetit të tyre dhe mirëqenies së tyre në përgjithësi.

Arsimit parashkollor (niveli 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçantë. Në të gjitha shkollat fillore e të mesme të ulëta funksionojnë klasat parafilelore, përveç në SHF MU "Dinuria" në Ivajë dhe në paralelen e ndara fizike, në fshatin Strazhtë dhe 2 paraleleve të ndara fizike në Varë e Provoji të SHF MU "Kadi Zeka".

Në nivelin 0 (parafillor) sivejt janë regjistruar gjithsej 284 fëmijë prej tyre 254 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 30 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP "Agimi.

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Arsimi fillor e i mesëm i ulët ofron mundësi dhe synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë (niveli 3), në Komunën e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkollat e mesme të larta; në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri e vëllezërit Çaka". Përmes këtij niveli, synohet zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimi i dijes në fusha të caktuara, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës.

Drejtoria e Arsimit është e orientuar dhe angazhohet për përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistrohët në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, fokus është përfshirja e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimit që ofron Shkolla Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" e po ashtu, edhe në Gjimnazin "Skënderbeu".

5.1 Rrjeti shkollore

Rrjetit të shkollave në Komunën e Kaçanikut iu është shtuar edhe një shkollë e pavaruar në fshatin Kovagëc. Më 17 nëntor 2025, me vendim të Kryetarit të Komunës, z. Besim Ilazi është bërë pavarësimi i Shkollës Filllore e të Mesme të Ulët në Kovagëc, ndërsa paraprakisht Ministria e Arsimit kishte lëshuar Pëlqim për pavarësimin e saj pasi shkolla kishte plotësuar të gjitha kriteret për funksionimin si shkollë e pavarur. Shkolla e fshatit Kovagëc deri në ditën e pavarësimit (17.11.2025) të saj kishte funksionuar si Paralele e ndarë Fizike e SHFMU "Idriz Seferi" në Bob. Vlen të theksohet se në SFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj ka filluar mësimi vetëm me një ndërrim, pasi paraprakisht janë krijuar kushte solide për zhvillimin e procesit mësimor vetëm në një ndërrim.

Në Komunën e Kaçanikut, me pavarësimin e SHFMU në Kovagëc, sivjet funksionojnë 12 shkolla anë, fillore e të mesme të ulëta dhe 9 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Runjevë,
2. SHFMU "Idriz Seferi" në Bob me paralelet e ndarë në Gajre,
3. SHFMU "Jusuf Gërralla" në Biçec me paralelet e ndarë në Nikaj,
4. SHFMU "Kadri Zekë" në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli,
5. SHFMU "Ali Asllani" në Doganaj,
6. SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj me paralelet e ndarë në Bajnicë,
7. SHFMU "Qamil Ilazi" me paralelet e ndarë në Fushë të Pajtit,
8. SHFMU "7 Shtatori" në Begracë,
9. SHFMU "Agim Bajrami në Stagovë,
10. SHFMU në Kovagëc
11. SHFMU "Gafur Luma" në Gllloboçicë dhe
12. SHFMU "Dituria" në Ivajë me paralelet e ndarë në Strazhë.

Përveç shkollave fillore e të mesme të ulëta, në Komunën e Kaçanikut funksionojnë edhe 2 shkolla të mesme: Gjimnazi "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik dhe një qerdhe për fëmijë, QIEAP "Agimi" në Kaçanik.

Bazuar në gjendjen fizike të objekteve shkollore, mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF, AMU dhe AML është në nivel të kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor, me përjashtim të objektit të vjetër të Shkollës fillore "Ermin Duraku" në Kaçanik dhe shkollës në Doganaj. Të dy këto objekte shkollore janë shumë të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndërkohë që nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Doganaj, i filluar në vitin 2019, sipas kontratës është dashtë të përfundoj më 2022 dhe tani më ka kaluar afatet kohore të planifikuara, ndërkohë që lajm i mirë është se tani më kanë rifilluar punimet për ndërtimin e objektit shkollor në Doganaj, pas një periudhe të gjatë kohore. Ndërsa sa i përket ndërtimit të shkollës në qytet, DKA, është duke bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar investimet e nevojshme për ndërtimin e objektit të ri shkollor, përkatësisht objektit të SHFMU "Ermin Duraku" në Kaçanik.

5.2 Sukseset e nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)

Në nivelin fillor, nga gjithsej 1956 nxënës sa ishin të regjistruar në fillim të këtij Gjysmëvjetori, kanë vijuar gjithsej 1936 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 1917 nxënës, apo shprehur në përqindje 98.00 %. Me sukses negativ kanë ngelur 19 nxënës e 21 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor, gjithsej 1957 me 2077 me sa ishin regjistruar një vit më parë (2024/25), atëherë del se në këtë vit shkollor, në këtë nivel, janë regjistruar gjithsej 121 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.12.

Për më shumë të dhëna në nivelin I-V, shih Tabelën Nr. 1
Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Gjysmëvjetori i Parë të vitit shkollor 2025 – 2026

			SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										TE PANOTUAR						
Klasa	Gj.nxenes		Vlojinë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Mjaft.		Gj.pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijë		Te cregj		Nota mesatare	
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		
I	336	175	332	174	198	103	65	36	50	23	19	12	332	174	98.8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	4.38
II	359	176	356	174	224	126	67	31	46	11	16	6	355	174	98.88	1	0	0	0	0	0	1	0	1	1	2	1	4.40	
III	428	208	423	206	204	114	109	54	80	34	26	2	419	203	97.89	2	1	0	0	2	2	4	3	0	0	5	2	4	
IV	436	209	432	206	213	132	99	43	84	27	32	5	425	205	97.47	2	1	0	0	5	0	7	1	0	0	4	3	4.02	
V	397	178	393	175	200	119	82	20	90	29	22	7	386	173	97.22	1	0	3	2	3	0	7	2	0	0	4	3	4.15	
I-V	1956	946	1936	935	1039	594	422	184	350	124	115	32	1917	929	98.00	6	2	3	2	10	2	19	6	1	1	19	10	4.12	

6. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2025-2026 ishte 1691, prej tyre 807 femra, ndërsa nëse e krahasojmë këtë numër me një vit më parë, (gjatë vitit shkollor 2024-2025, në këtë nivel shkollor kishte 1763), del se sivjet, në nivelin e mesëm të ulët, janë gjithsej 72 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1691 nxënësve (807 f) të nivelit AMU, kanë vijuar 1743 (803 femra) dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsej 1238 nxënës apo shprehur në përqindje 86.50 %, ndërkaj me nota negative kanë ngelur gjithsej 441 apo 26.07 % e 12 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.48.

Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Gjysmëvjetorin e Parë të vitit shkollor 2024 – 2025

	SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR									
	Gj.nxenes		Vijonë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Mjaft.		Gj.pozitiv		%		Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijon Te cregji		Nota mesatare	
lasa																												
VI	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F			GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		
410	203	409	203	160	117	94	50	82	19	10	3	346	189	84.39	25	9	14	3	24	2	63	14	0	0	1	0	3.8	
VII	430	197	426	195	126	85	103	58	72	25	13	4	314	173	73.02	43	12	21	7	48	3	112	22	0	0	4	2	3.57
VIII	433	206	429	205	110	84	100	59	70	32	10	2	290	181	66.97	34	10	26	5	79	9	139	24	1	0	3	1	3.44
IX	418	201	415	200	122	87	74	56	75	31	17	5	288	179	68.89	40	12	25	6	62	3	127	21	0	0	3	1	3.44
VI-V	1691	807	1679	803	518	373	371	223	299	107	50	14	1238	722	86.50	142	43	86	21	213	17	441	81	1	0	11	4	3.48

6.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet I dhe 2 (I-V dhe VI –IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2025-2026 ka qenë 3647 (1748 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 3614, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3154 apo 86.50 %. Ndërkaj, me nota negative kanë mbetur 460 nxënës prej tyre 84 femra e 33 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.81.

Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2025-2026 (3647) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë që ishin 3847, ateherë del se në këtë nivel shkollor. gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 200 nxënës.

Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3

Suksesit sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

	SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR										
	Gj. nxenes		Vijonë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Mjart.		Gj.pozitiv		%		Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijë		Te cregj.		Nota mesatare
klasa	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F			GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	
I	336	175	332	174	198	103	65	36	50	23	19	12	332	174	98.8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	4.38
II	359	176	356	174	224	126	67	31	46	11	16	6	355	174	98.88	1	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1	2	1	4.40
III	428	208	423	206	204	114	109	54	80	34	26	2	419	203	97.89	2	1	0	0	2	2	2	4	3	0	0	5	2	4
IV	436	209	432	206	213	132	99	43	84	27	32	5	425	205	97.47	2	1	0	0	5	0	7	1	1	0	0	4	3	4.02
V	397	178	393	175	200	119	82	20	90	29	22	7	386	173	97.22	1	0	3	2	3	3	0	7	2	0	0	4	3	4.15
I-V	1956	946	1936	935	1039	594	422	184	350	124	115	32	1917	929	98.00	5	2	3	2	10	2	19	6	1	1	20	10	4.12	
VI	410	203	409	203	160	117	94	50	82	19	10	3	346	189	84.39	25	9	14	3	24	2	63	14	0	0	1	0	3.8	
VII	430	197	426	195	126	85	103	58	72	25	13	4	314	173	73.02	43	12	21	7	48	3	112	22	0	0	4	2	3.57	
VIII	433	206	429	205	110	84	100	59	70	32	10	2	290	181	66.97	34	10	26	5	79	9	139	24	1	0	3	1	3.44	
IX	418	201	415	200	122	87	74	56	75	31	17	5	288	179	68.89	40	12	25	6	62	3	127	21	0	0	3	1	3.44	
VI-IX	1691	807	1679	803	518	373	371	223	299	107	50	14	1238	722	73.19	140	41	85	20	216	17	441	77	1	0	11	4	3.48	
I-IX	3647	1748	3614	1734	1554	968	787	406	656	230	161	45	3154	1650	86.5	145	45	90	23	226	19	460	84	2	1	31	14	3.81	

Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

Nr.	shk.oll.	Gjithsej nxënës		Vijonë		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										Të Panotuar				Nota mesatare		
						Shkëlq		Shumë mirë		Mirë		Mjaft.		Gjithsej pozitiv		%	1x1			2x1			3x1			Gj negativ		Muk vijonë			Çregjistru ar	
																	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj		F	Gj
1	"E.D"	1194	577	1183	573	510	322	252	135	200	62	46	12	1008	531	85	46	20	36	12	93	10	175	42	1	0	10	4	3.85			
2	"K.Z"	354	168	348	168	128	78	75	49	67	26	20	8	290	161	81.92	17	3	8	2	33	2	58	7	0	0	6	0	3.78			
3	"L.S"	275	131	275	131	136	81	81	37	41	12	8	1	266	131	96.72	4	0	3	0	2	0	9	0	0	0	0	0	4.15			
4	"J.G"	280	142	280	142	148	96	64	27	47	18	10	0	269	141	96	0	0	5	1	6	0	11	1	0	0	0	0	4.12			
5	"N.O."	272	135	272	135	124	78	56	32	60	19	9	1	243	129	89	15	6	4	0	12	0	29	6	0	0	0	0	3.8			
6	"Q.L."	378	170	372	169	139	84	86	44	61	22	9	1	295	156	79	28	4	18	5	30	4	77	13	0	0	6	1	3.79			
7	"A.A"	231	114	227	110	114	74	42	21	34	11	8	0	198	106	87	5	1	5	1	19	2	29	4	0	0	4	4	3.93			
8	"S.Sh"	225	100	224	99	88	48	37	17		20	16	11	191	96	79	8	4	7	2	18	0	33	3	1	1	0	0	3.05			
9	"G.L."	85	39	85	39	40	23	15	6	16	6	7	3	78	38	92	7	1	0	0	0	0	7	1	0	0	0	0	3.92			
10	"A.B."	153	70	150	67	37	27	45	21	37	12	5	2	124	62	83	11	4	2	0	13	1	26	5	0	0	4	4	3.6			
11	"D.Sh"	43	19	43	19	15	11	7	5	14	5	7	3	43	19	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.75		
12	Kov	156	83	155	82	75	46	27	12	29	17	16	3	149	80	96	4	2	2	0	0	0	6	2	0	0	1	1	4.01			
Gjith	3647	1748	3614	1734	1554	968	787	406	656	230	161	45	3154	1650	87	145	45	90	23	226	19	460	84	2	1	31	14	3.81				

7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pamabajtura të mësimdhënësve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmëria e regullt e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimi ndikon negativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky tregues merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I – V dhe VI – IX), në këtë Gjysmëvjetor janë angazhuar gjithsej 346 mësimdhënës (152 mashkuj e 194 femra) prej tyre 136 në mësimin klasor dhe 210 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë të gjithë (346) apo shprehur në përqindje 100 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përgjatë këtij gjysmëvjetori, kanë bërë gjithsej 53.069 mungesa prej tyre 43182 të arsyeshme, ose 14.55 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë kësaj periudhe kanë humbur 1410 orë mësimore ose mesatarisht nga 4.07 orë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pamabajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

Nr.	Emri i shkolles	KUADRI ARSIMOR																Mesat. për nx.	Orë të mbajta të arsimit	Mesat për arsimit
		Mësimi klasor				Mësimi lëndor				Dy ciklet				Mungesat e nxënësve						
		Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	GJ	F	Kv	%	GJ	ARS.					
1	"Emin Duraku"	35	34	35	100	47	29	47	100	82	63	82	100	19623	15199	16.33	400	4.88		
2	"Kadi Zeka"	16	7	16	100	16	7	16	100	32	14	32	100	5687	4425	16.06	79	2.46		
3	"Idriz Seferi"	11	7	11	100	15	7	15	100	26	14	26	100	3714	3105	13.5	153	5.88		
4	"Jusuf Gërvalla	12	7	12	100	16	10	16	100	28	17	28	100	4380	3810	15.6	59	2.1		
5	"Qamil Ilazi"	15	10	15	100	16	7	16	100	31	17	31	100	5142	4346	11.95	60	1.93		
6	"Nazmi Osmani"	10	9	10	100	18	6	18	100	28	15	28	100	4145	3704	15.23	175	6.25		
7	"Ali Asllani"	9	6	9	100	16	7	16	100	25	13	25	100	3949	3573	17.39	33	0.18		
8	"7 Shtatori"	6	3	6	100	14	9	14	100	20	12	20	100	1265	638	0.17	68	3.40		
9	"G.Luma"	6	3	6	100	9	4	9	100	15	7	15	100	882	789	10.37	55	3.66		
10	"A.B."	6	3	6	100	13	5	13	100	19	8	19	100	1950	1649	13	136	7.15		
11	"Dituria"	5	2	5	100	17	3	17	100	22	5	22	100	464	284	10.79	172	7.81		
12	Kovaceci	5	3	5	100	13	6	13	100	18	9	18	100	1868	1660	11.9	20	1.66		
	Gjithsej	136	94	136	100	210	100	210	100	346	194	346	100	53069	43182	14.55	1410	4.07		

8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

Në arsimin e mesëm të lartë, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijeve dhe njohësive të përgjithshme dhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësi, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integritetit me të lehtë të tyre në shoqëri.

Edukimi dhe arsimimi në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML), po ashtu, i është kushtuar rëndësi e veçantë pasi në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

8.1 Numri i nxënësve

Në vitin shkollor 2025-2026 në dy shkollat e mesme janë regjistruar gjithsej 865 nxënës (486 meshkuj dhe 379 femra) prej tyre 476 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 389 në LAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar këtë vit shkollor prej 865 nxënës, me atë të vitit të kaluar prej 895 nxënës, atëherë del se sivjet në të dy shkollat e mesme janë regjistruar 30 nxënës më pak.

Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" janë duke funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkencat Natyrore me gjithsej 12 paralele, nga 4 paralele në klasat X, XI dhe XII dhe në Shkencat Shogërore-Gjuhësore, funksionojnë 9 paralele dhe ato nga 3 në klasat e X, XI dhe XII.

Ndërkaq, në LAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" procesi mësimor është duke u zhvilluar në 29 paralele dhe atë 10 paralele në klasat e dhjeta me 3 drejtime: 1. Elektronikë me profilet Instalues elektrik me 1 paralele dhe Informatikë me 1 paralele, 2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet dhe tatime me 1 paralele, Tregu me shumicë dhe pakicë, 1 paralele dhe Marketing dhe shitje 1 paralele dhe 3. Makineri me profilet Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, me 2 paralele, Automekanik me 1 paralele, Operator prodhimi me 1 paralele dhe Trafik rrugor me 1 paralele. Në klasat e XI funksionojnë 9 paralele dhe ato me profilet: Metalpunues, me 1 paralele, Informatikë me 1 paralele, Kontabilitet dhe tatime me 1 paralele, Nëpunës i administratës dhe shërbime të zyrës me 1 paralele, Automekanik me 1 paralele, Instalues i ngrohjes, Ujësjetësit dhe Kanalizimit me 2 paralele, Instalues elektrik me 1 paralele dhe Trafik rrugor me 1 paralele. Në klasat e XII, funksionojnë 10 paralele me profilet: Elektronikë industriale me 1 paralele, Informatikë me 1 paralele, Kontabilitet dhe tatime me 1 paralele, Nëpunës i administratës dhe shërbime të zyrës me 1 paralele, Automekanik me 1 paralele, Instalues i ngrohjes, Ujësjetësit dhe Kanalizimit me 2 paralele, Instalues elektrik me 1 paralele dhe Metalpunues me 1 paralele dhe Automekani me 1 paralele.

8.2 Suksesi i nxënësve

Nga numri i përgjithshëm prej 865 nxënës (379 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 829 nxënës, prej tyre 373 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 472 ose 54.56 %.

Me nota të parrafshme kanë mbetur 357 nxënës ose 41.27 % prej tyre dhe të panotuar e të përgjithshëm kanë mbetur gjithsej 36 të tjerë.

Sukseset e aritjes reflekton vlerësimin e njohurive të aritjes të nxënësve për këtë Gjysmëvjetor të vitit shkollor 2025-2026, ndërkohë nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.13 dhe atë në Gjymnazin "Skënderbeu" 3.64 dhe LAAP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.62.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6

Sukseset në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2025-2026

Emri i shkollës	Klasa	Të regjistruar		Vijojnë		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										TE PANOTUAR				Mesatarja
						Shkëlq.		Sh. mirë		Mirë		Mjaft.		Gjithë pozitiv		%	1X1		1X2		Përsëritje me 3x1		Gjithsej negativ		Nuk vijojnë përgjithësim		Të regjistruar			
		Gj	F	Gj	F												Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	
		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		
		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	
Skënderbeu	X	173	104	171	102	42	31	51	36	24	12	1	0	118	79	69	15	8	13	7	25	8	53	23	2	2	0	0	3.55	
	XI	138	82	136	82	37	29	36	24	13	9	0	0	86	62	63.2	26	12	9	4	15	4	50	20	2	0	0	0	3.67	
	XII	165	111	162	110	42	34	41	34	32	19	4	3	119	90	73.5	27	17	8	2	8	1	43	20	3	1	0	0	3.69	
	X-XII	476	297	469	294	121	94	128	94	69	40	5	3	323	231	68.9	68	37	30	13	48	13	146	63	7	3	0	0	3.64	
F. Guri dhe v. Çaka	X	162	35	139	33	3	0	10	4	31	11	5	1	49	16	30.2	21	5	23	6	46	6	90	17	23	2	0	0	2.59	
	XI	114	25	108	24	1	1	5	0	25	3	5	0	36	4	31.6	26	9	24	8	22	3	72	20	6	1	0	0	2.49	
	XII	113	22	113	22	5	2	20	7	33	10	6	1	64	20	56.6	15	1	15	1	17	0	49	2	0	0	0	0	2.78	
	X-XII	389	82	360	79	9	3	35	11	89	24	16	2	149	40	38.3	62	15	62	15	85	9	211	39	29	3	0	0	2.62	
X - XII		865	379	829	373	130	97	163	105	158	64	21	5	472	271	54.6	130	52	92	28	133	22	357	102	36	6	0	0	3.13	

9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Nxënësit e këtij niveli, në fund të kësaj periudhe, kanë bërë gjithsej 27626 mungesa (11793 mungesa nxënësit e Gjimnazit dhe 15833 ata të IAAP) prej të cilave me arsye 18802 ose 31.93 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit është relativisht i lartë, ndërkohë që DKA kërkon nga shkollat përkatëse të ndërmarrin masa adekuate me qëllim të zvogëlimit në minimum numrin e orëve të humbura mësimore.

Ndërkaq, mësimdhënësit e këtij niveli të AML-së kanë humbur gjithsej 663 orë mësimi apo 7.62 orë mësimi për një mësimdhënëës. Ngritja profesionale e mësimdhënëseve është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e nxënie të suksesshme. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 87 mësimdhënëës, të gjithë të kualifikuar (100%), prej tyre 40 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 47 në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka".

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambaritura të mësimdhënëseve në shkollat e Mesme të Larta

Tab.Nr.7											
Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR					Mungesat e nx		Mesatarja për nxënëës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%	Gj	Arsyeshme				
1	Skënderbeu	40	21	40	100	11793	8686		24.78	409	10.23
2	IAAP	47	20	47	100	15833	10116		26	254	1.79
	Gjithsej	87	41	87	100	27626	18802		25.38	663	7.62

DKA mbetet e përkushtuar dhe angazhohet për rezultate dhe suksese edhe më të mira duke promovuar një sistem arsimor më të avancuar e bshkëkohor të krahaseshëm me ato të vendeve më të zhvilluara.

Drejtori i Drejtorisë

Zakir Doda





01.Nr. 104/02-4196/26
Datë 13.02.2026

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29 të rregullore (qrk) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 15 pika 3 dhe shkronja (h dhe q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, si dhe në pajtim me Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/02-16985/2024, të datës 31.07.2024, Raporti i Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronëve të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim Nr.njesis 021/463, nr.prot 37-5/2025, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm , Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës , në mbledhjen e radhës të merre këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK

z. Faik (Rufat) Muça

1. Kuvendit të komunës për miratim të PROPOZIM vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik.
2. Sipas propozimit të cekur në piken 1 të këtij propozimi, në lidhje me këmbimin e pronës si vijon:
 - 2.1 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917049-00195-0, me sipërfaqe prej $S= 23 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=1040m^2$, në pronësi, Komuna e Kaçanikut (P.SH Rrugët Publike dhe te pakategorizuar) me vendodhje në Rr. "Brahim Muça", Kovaçec, Kaçanik , ZK Kovaçec, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithëshme prej 345.00 €, dhe
 - 2.2 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917049-842-2, me sipërfaqe prej $S= 40 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=8664 m^2$, në pronësi, Komuna e Kaçanikut (P.SH Rrugët Publike dhe te pakategorizuar) me vendodhje në Rr. "Brahim Muça", Kovaçec, Kaçanik, ZK Kovaçec, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithëshme prej 600.00 €, e cila këmbëhet me:
 - 2.3 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917049-00196-0, me sipërfaqe prej $S= 63 m^2$ nga me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 840 m^2$, në pronësi të personit fizik Faik (Rufat)

Muça me vendbanim në Rr. "Brahim Muça", Kovaçec, Kaçanik, ZK Kovaçec, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithëshme prej 945.00 €,


3. Propozimi për iniciimin e këmbimit të pronës së paluajtshme u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin dhe rregullimin e rrugës Rr. "Brahim Muça", Kaçanik, ZK Kovaçec.
4. Kompromisi i pronës të personit fizik që është objekt i këmbimit, do të bëhet me pronën komunale, të cilat janë vlerësuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, në Ministrinë e Financave.
5. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës,
6. Zbatimin e këtij vendimi do të bëjë Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtjes së Mjedisit, gjegjësisht Zyra Komunale Kadastrale - Kaçanik, e cila do të bëjë regjistrimin e pronave dhe të drejtën e pronësisë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi.

Të bashkangjitur këtij Propozim Vendimi janë:

- Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/02-16985/2024, të datës 31.07.2024,
- „Raporti i Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronëve të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim Nr.njesis 021/463, nr.prot 37-5/2025.
- Certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit të pronave që janë objekt i këmbimit dhe
- Skica.

Drejtori i DUKMM-së
z. Korab Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department
Komuna: Kaçanik Zona Kadastrale: Kovacec

Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikates se Pronës						Vlerësimi	
Nr.	Pronat/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Totali (€)
1	Faik (Rufat) Muça	196-0	Mal i Klasës 3	840	63	15.00	945.00
Total							





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odelenje za Procenu Nepokretnosti – Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Kaçanik Zona Kadastrale: Kovacec

Të dhënat sipas Elaboratit /Certifikates se Pronës					Vlerësimi	
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²) Totali (€)
	P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuar	842-0	Rrugët e pakategorizuara	11872	40	15.00 600.00
1	P.SH Rrugët Publike dhe të Pakategorizuar	195-0	Rrugët e pakategorizuara	1040	23	15.00 345.00
	Total					945.00



Approvuar: 29.05.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-16985/24

Kaçanik, 31.07.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/I-092 për dhëniën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ((Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të neni 29.5 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, duke vendosur sipas Propozim Vendimit Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, 01Nr. 104/02-16985/24 të datës 19.07.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 31 korrik 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZONA KADASTRALE KAÇANIK DHE KOVAÇEC

1. Me këtë Vendim, **SHPALLET** me interes publik prona e paluajtshme në Zonën Kadastrale në Kaçanik, me pronësi private të personit fizik
2. Sipas pikës 1. të këtij Vendimi, shpallet me interes publik parcela e pronës si vijon:
2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-01003-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=288 m^2$, në pronësi të personit Misin (Halim) Sopa , me vendodhje Rr. " Ismail Qemajli ", ZK Kaçanik (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $14 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).
3. Me këtë Vendim, **SHPALLET** me interes publik prona e paluajtshme në Zonën Kadastrale në Kovaçec, me pronësi private të personit fizik.
4. Sipas pikës 3. të këtij Vendimi, shpallet me interes publik, parcela e pronës si vijon:
4.1 Parcela Kadastrale P-70917049-00196-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=840 m^2$, në pronësi të personit Faik (Rufat) Muça, me vendodhje Rr. "Brahim Muça", ZK Kovaçec. (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $63 m^2$, e cila nevojitet për rregullimin-zgjerimin e rrugës "Brahim Muça" Kovaçec).
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kovaçec

341-4175/2026

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917049-00195-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1040



Shkalla/Razmera/Scale: 1:866

Punoi/Obradio/Created: Mentor Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.02.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:51:35



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917049-00195-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	06-941/01-0004176/26
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.02.2026 - 13:47
Komuna / Opština / Municipality:	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kovacec / Kovacevac / Timori
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917049-00195-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Inovira / Socially owned Land	Rural	1040			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LIVADA RUSTEMI	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²) (m ²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakegjeve/Kategorizimi Përfundimtar/Road		1040

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershtatimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	P.SH. RRUGËT PUBLIKE DHE TË PAKATEGORIZUARA	KCID0900166	///			1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kovaçec

941-9126/26

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-70917049-00842-2	Parcelë / Parcela / Parcel	8664



Shkalla/Razmera/Scale: 1:5388

Punci/Obradio/Created: Mentor Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.02.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:50:06



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917049-00842-2

Numeri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 06-941/01-0004176/26
Data dhe koha e kështimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 13.02.2026 - 13:50
Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kovaçec / Kovacevac / Trimori
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numeri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917049-00842-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	8664	Projekti i Shpërndimit	08.08.2025	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ROVINE	0		08.08.2025	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakegjeve/Kategorizimi Pakegjeve/Unecategorized Road		8664

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. person Licent broj ID, No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostojna adresa Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	P.SH. RRUQËT PUBLIKE DHE TË PAKATEGORIZUARA	KCID00900166	///			1/1		11.08.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kovaçec

94-6176/2020

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917049-00196-0	Parcelë / Parcela / Parcel	840



Shkalla/Razmera/Scale: 1:603

Punoi/Obradio/Created: Mentor Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.02.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:52:16



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917049-00196-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

06-941/01-0004176/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.02.2026 - 13:47

Komuna / Opština / Municipality:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Kovëçec / Kovacevac / Trimori

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917049-00196-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	840			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postel Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ORA DRONQIT	0			

A.2 LLOJI I SHËRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shërytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shërytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Pjorë/šumsko/Forestry	Tokan Pjorë/šumsko zemljište/Forest	Mal I Klasë 3/Suma 3 Klasse/3rd Class Forest	840

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi posttal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostost adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Parashkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Muga Faik (Rufat)	1012851126	KOVAČEVIĆ / KOVACHEVAC / TRIMORI /		Rr. "Brahim Muga" Nr.4	1/1	441/2024	21.05.2024



01.Nr. 104/02-4198/26
Datë 13.02.2026

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29 të rregullore (qrk) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 15 pika 3 dhe shkronja (h dhe q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, si dhe në pajtim me Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/01-6738/2024, të datës 29.03.2024, Plotësim ndryshimi i Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/01-22999/2024, të datës 30.09.2024, Raporti i Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronëve të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim Nr.njesis 021/463, nr.prot 104-1/2025, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës të merre këtë:

**PROPOZIM VENDIM PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK
z. ISEN (AGUSH) RAKA**

1. Kuvendit të komunës për miratim të PROPOZIM vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik.
2. Sipas propozimit të cekur në piken 1 të këtij propozimi, në lidhje me këmbimin e pronës si vijon:
 - 2.1 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-00577-3, me sipërfaqe prej $S=30.81\text{ m}^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=706\text{ m}^2$, në pronësi, Komuna e Kaçanikut me vendodhje në Rr. "Dëshmoret e Kombit", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithëshme prej 3,410.00 €, e cila këmbëhet me:
 - 2.2 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-00596-1, me sipërfaqe prej $S=31.07\text{ m}^2$ nga me sipërfaqe të përgjithëshme prej $S=598\text{ m}^2$, në pronësi të personit fizik Isen (Agush) Raka me vendbanim në Rr. "Dëshmoret e Kombit", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithëshme prej 3,410.00 €,
3. Propozimi për iniciimin e këmbimit të pronës së paluajtshme u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin dhe rregullimin e rrugës "Rr. Ismail Raka", Kaçanik, ZK Kaçanik


4. Kompromisi i pronës të personit fizik që është objekt i këmbimit , do të bëhet me pronën komunale , të cilat janë vlerësuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës se Paluajtshme, në Ministrinë e Financave.
5. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës,
6. Zbatimin e këtij vendimi do të bëjë Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastr dhe Mbrojtjes së Mjedisit, gjegjësisht Zyra Komunale Kadastrale - Kaçanik , e cila do të bëjë regjistrimin e pronave dhe të drejtën e pronësisë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi.

Të bashkangjitur këtij Propozim Vendimi janë:

- Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/01-6738/2024, të datës 29.03.2024,
- Plotësim ndryshimi i Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/01-22999/2024, të datës 30.09.2024, Raporti i Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronëve të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim Nr.njësis 021/463, nr.prot 475-2/2025.
- Certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit të pronave që janë objekt i këmbimit dhe
- Skica.

Drejtori I DUKMM-së
z. Korab Krasniqi



Kryetari I Komunës
z. Sabedin Vishi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 01-6738/24
Kaçanik, 29.03.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ((Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të neni 29.5 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, duke vendosur sipas Propozim Vendimit Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadashtër dhe Mbrojtje të Mjedisit, 01Nr. 104/01-6738/24 të datës 15.03.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 mars 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZONA KADASTRALE KAÇANIK DHE GAJRE

1. Me këtë vendim, SHPALLEN në interes publik, parcelat e pronës së paluajtshme në Zonën Kadastrale Kaçanik, me pronësi private të personit fizik dhe juridik.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, shpallen me interes publik parcelat e pronës si vijon:
 - 2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-00577-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 706 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Dëshmoret e Kombit", ZK Kaçanik (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $31.07 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).
 - 2.2 Parcela Kadastrale P-70917048-00596-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 565 m^2$, në pronësi të personit Isen (Agush) Raka , me vendodhje Rr" Dëshmoret e Kombit", ZK Kaçanik, (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $30.81 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).
3. Me këtë vendim, SHPALLEN në interes publik, parcelat në pronën e paluajtshme në Zonën Kadastrale Gajre, me pronësi private të personit fizik dhe juridik
4. Sipas pikës 3. të këtij vendimi, shpallen me interes publik parcelat e pronës si vijon:

- 4.1 Parcela Kadastrale P-70917016-00101-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 4607 \text{ m}^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, Rugët Publike dhe të Pakategorizuar, me vendodhje Rr. " Brigata 162 Agim Bajrami", ZK Gajre. (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 165 m^2 , e cila nevojitet për rregullimin e rrugës "28 shkurti", Gajre).
- 4.2 Parcela Kadastrale P-70917016-00756-5, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 178 \text{ m}^2$, në pronësi të personit Burim (Baki) Çallaku , me vendodhje Rr. "28 shkurti", ZK Gajre. (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 178 m^2 , (komplet parcela) e cila nevojitet për rregullimin e rrugës "28 shkurti", Gajre).
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 060/01-22999/24
Kaçanik, 30.09.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të neni 29.5 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, duke vendosur sipas Propozim Vendimit Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, 01Nr. 060/01-22999/24 të datës 16.09.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01 NR.104/01-6738/2024 TË DATËS 29.03.2024 PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZONËN KADASTRALE KAÇANIK DHE GAJRE

1. Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 nr.104/01-6738/2024 i datës 29.03.2024 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelave kadastrale në zonën kadastrale Kaçanik dhe Gajre.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit nga pika 1 e këtij Vendimi, bëhen në pika 2. paragrafët 2.1 dhe 2.2, ashtu që hiqet teksti i vjetër, shtohet teksti me përmbajtjen si vijon:

2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-00577-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 706 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Dëshmoret e Kombit", ZK Kaçanik (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $30.81 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).

2.2 Parcela Kadastrale P-70917048-00596-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 598 m^2$, në pronësi të personit Isen (Agush) Raka , me vendodhje Rr " Dëshmoret e Kombit", ZK Kaçanik, (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $31.07 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).

3. Ndryshimi i vendimit bëhen, për shkak të një gabimi teknik në identifikimin e parcelave për këmbim edhe nga parcela kadastrale nr. P-70917048-00596-2, duhet të jetë parcela nr. P-70917048-00596-1 si dhe sipërfaqet duhet të ndryshohen si në atë publike dhe private, në parcelën publike duhet të jetë $30.81 m^2$, ndërsa në parcelën private duhet të jetë $31.07 m^2$.

4. Pikët tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.

5. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë: Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 nr.104/01-6738/2024 të datës 29.03.2024 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelave kadastrale në zonën kadastrale Kaçanik dhe Gajre: Certifikatat e pronës për personat Fizik. Kopja e planit; Skica e parcelave për Këmbim.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë);
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Kaçanik


Nr. i njesisë kad. / Br. kat. jedinice: 596-1 dhe 596-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: Kaçanik

Nr. i lëndës / Br. predmeta: 07/2024

Lloji i njesise kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcele

Shkalla e zvogimit / Razmera plana: 1:1000



P	Y	X	H	Kodi	Përshkrimi	Burimi
1	7520971.113	4676948.142	546.899	6	Kunj druri	PM
2	7520982.148	4676932.443	545.061	6	Kunj druri	PM
3	7520992.022	4676918.418	543.455	6	Kunj druri	PM
4	7521000.116	4676920.048	543.338	6	Kunj druri	PM
5	7521009.616	4676924.628	540.732	6	Kunj druri	PM
6	7521016.906	4676927.678	538.363	6	Kunj druri	PM
7	7521023.856	4676929.627	537.662	6	Kunj druri	PM
8	7521023.686	4676935.477	536.866	6	Kunj druri	PM
9	7521023.716	4676943.074	536.908	6	Kunj druri	PM
10	7521023.746	4676950.467	536.822	6	Kunj druri	PM
11	7521018.532	4676951.380	537.525	6	Kunj druri	PM
12	7521008.112	4676950.191	0.000	40	Objekt-Shtëpi	PV
13	7520974.924	4676948.352	546.578	6	Kunj druri	PM
14	7521002.494	4676937.646	539.987	6	Kunj druri	PM
15	7520988.247	4676917.537	543.699	6	Kunj druri	PM

Rilevori / Surveor: N.P.SH. GEOPROJECT

(emri dhe mbiemri i gjeodist/kompanisë/ime i prezime gjeodist/ kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence: 07

Nenshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 14.02.2024



Aprovi / Usvajao:

(emri dhe mbiemri i përfaqësuesit/ime i prezime shërbëtorit)

Nenshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministria e Financave, Rada i Trasfereve - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministria e Financave, Rada i Trasfereve - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Kaçanik Zona Kadastrale: Kaçanik						
Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikates se Pronës					Vlerësimi	
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ / m ²) Totali (€)
1	Isen (Agush) Raka	596-1	Pemishtrë e Klasës 2	598	31	110.00 3,410.00
Total						3,410.00



Pracuar ! 30.05.2025
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Kaçanik Zona Kadastrale: Kaçanik						
Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikates se Pronës						
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Vlerësimi
1	Komuna e Kaçanikut	577-3	Kullose e Klasës 4	706	31	Çmimi i tokës (€ / m ²) Totali (€)
					110.00	3,410.00
	Total					3,410.00

APROVUAR : 30.05.2025



Data/ Data/Date: 13.02.2026
Koha/ Vreme/ Time: 01:41:26



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00577-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	06-941/01-0004176/26
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.02.2026 - 13:40
Komuna / Opština / Municipality:	KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917048-00577-3	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shpëtimore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	706		09.12.2021	21.01.2022

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
DUSHKAJA	0		09.12.2021	21.01.2022



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Pojlopjeveredho/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klases 4/Pashnjak 4 Klase/4th Class Pasture	706

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personat Licai broj ID, No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Perskribimi Opis Description	Azhuruar Akturirano Updated
Poseidim individual / Individualna Druzvina / Single possessor	Komuna e Kaçanikut	600246913	///		QAMUL ILAZI	1/1		21.01.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik

961-9176/20

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917048-00596-1	Parcelë / Parcela / Parcel	598



Shkalla/Razmera/Scale: 1:325

Punci/Obradio/Created: Mentor Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.02.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:42:13



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00596-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	06-941/01-0004176/26
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.02.2026 - 13:40
Komuna / Opština / Municipality:	KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917048-00596-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Inovina / Socially owned Land	Urban	598		16.02.2024	16.02.2024

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
DUSHKAJA	0		16.02.2024	16.02.2024



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Slpërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Pemishitet/Voćnjaci/orchard	Pemishitë E Klasës 2/Voćnjak 2 Klase/2nd Class Orchard	598

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adresa Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individitnalna Drzavina / Single possessor	RAKA ISEN (AGUSH)	1500199080	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK /			1/1		22.02.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	10.02.2026	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	60/01-3665	-1.		

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2026

Kaçanik, 2026
Komiteti për komunitete

Komiteti për komunitete

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për ti siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve të komunës masat që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Përbëja e Komitetit për Komunitete:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Tel.	E-mail
1.	Betim Shala	Kryesues i Komitetit për Komunitete - LDK	049/809/109	betim.shala@-gov.net
2.	Islam Gashi	Anëtar i kuvendit- LVV	044/449/445	islam.ggashi@gmail.com
3.	Lejla Luta	Anëtare e Kuvendit- VZHK	044/121/103	lejlaLuta44@gmail.com
4.	Hafize Sallahu	Anëtare e kuvendit- AAK	044/379/419	hafize.sallahu@gmail.com
5.	Shemsedin Abazi	OJQ/Shoqëria civile	044/224/685	shabazi@live.com

Temat dhe aktivitetet e Komitetit për Komunitete për vitin 2026

Nr.	Tema	Aktivitetet	Përkrahja e nevojshme	Kalendari kohor 2026
1.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Gjendja e bizneseve 3-Të ndryshme	-Vizitë bizneseve që udhëhiqen nga gratë	-Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	Shkurt-mars
2.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Gjendja e sportit në Kaçanik 3-Të ndryshme	-Vizitë selive të klubeve -Takim me përfaqësues të klubeve sportive	-Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport	Mars-prill
3.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Rastet Sociale në Kaçanik 3-Gjendja e shoqatës Hendikos 4-Vizitë në vende të ndryshme 5-Të ndryshme	-Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale -Takim tek shoqata Hendikos	-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Prill-maj

4.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Hapësirat për parqe të reja 3-Mirëmbajtja e hapësirave publike 4-Mungesa e parkingjeve 5-Të ndryshme	-Takim me personat përgjegjës nga DSHPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave	Maj-qershor
5.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Gjendja e shoqatave të dalura nga lufta 3-Të ndryshme	-Takim me Organizatën e Veteranëve të Luftës -Takim me Shoqatën e Invalidëve të Luftës -Takim me Organizatën e Familjeve të Dëshmorëve	OVL UÇK	Qershor-Korrik
6.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Gjendja e Arsimit në Kaçanik 3-Të ndryshme	Vizitë shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të larta. Takim me këshillin e prindërve	Drejtoria Komunale e Arsimit	Korrik-Shtator

7.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Gjendja e fermerëve dhe bujqëve në Komunën e Kaçanikut 3-Shpërndarja e Granteve 4-Të ndryshme	-Takim me drejtoreshën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik -Vizitë bujqëve dhe fermerëve	-Drejtorja e Bujqësi dhe Zhvillim Rural -Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik	Shator-tetor
8.	1-Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar 2-Aktivitet Rinore 3-Të ndryshme	-Takim me OJQ që merren me aktivitete Rinore -Vizitë tek KVRL -Vizitë tek Kryqi i Kuq -etj	Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport	

Vërejtje: Përveç aktiviteteve të parapara në Planin e Punës mund të zhvillohen edhe aktivitete të tjera sipas nevojës!

Grupi punues:

- 1.Betim Shala
- 2.Islam Gashi
- 3.Hafize Sallahu
- 4.Lejla Luta
- 5.Shemsedin Abazi

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete:
Betim Shala



Kaçanik, Shkurt 2026

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK				
I	Data	12.02.26	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	01	Shtojcë	60/01-4004 - 1.

Sabedin Vishi

From: Safete Beqiri <safetebeqiri@komunat-ks.net>
Sent: Wednesday, February 11, 2026 2:30 PM
To: Sabedin Vishi
Subject: Propozim - Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së
Attachments: Formula e zgjedhjes se delegatit per Kuvend te AKK-se.pdf

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

I nderuar Kryetar,

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ju fton që, në përputhje me Statutin dhe rregullat e brendshme të AKK-së, të emëroni delegatët e Komunës Suaj për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së. Bashkangjitur gjeni **Propozim-Formulën** për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvendin e AKK-së. Në bazë të kësaj Propozim-Formule, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin Komunal, propozohet që Komuna Juaj të përfaqësohet nga:


- PDK – një anëtar i Kuvendit Komunal
- LVV – një anëtar i Kuvendit Komunal

Ju njoftojmë se kjo është vetëm **formulë orientuese/propozuese** e AKK-së. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se vendimin final për përfaqësim e marrin Kuvendet Komunale përkatëse, dhe se delegimi i përfaqësuesve duhet të miratohet me vendim formal nga Kuvendi Komunal, në përputhje me procedurat ligjore dhe statutore.

Ju lutemi që pas miratimit në Kuvendin Komunal, vendimin zyrtar me emrat e delegatëve të përzgjedhur ta dërgoni në adresën elektronike: safetebeqiri@komunat-ks.net
 Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë!

Me respekt,

Safete Beqiri
 Asistente e Administratës
 Asociacioni i Komunave të Kosovës
 Tel: +381 38 / 245-734
 Fax: +381 38/245-733
www.komunat-ks.net
safetebeqiri@komunat-ks.net



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Për:	Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin/en e Kuvendit të Komunës
Nga:	Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni i Komunave të Kosovës
Data:	10 Shkurt 2026
Subjekti:	Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së

I nderuar Kryetar,

I/E nderuar Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës,

Sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, numri i delegatëve për Kuvend të AKK-së është caktuar në bazë të kriterëve të shënuara në vijim:

Përveç Kryetarit të Komunës, komunat i delegojnë për çdo 10 anëtar të KK-së, 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e AKK-së. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor.

Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të Kryetarëve të Komunave (numri dhe përkatësia në bazë të përfaqësimit të tyre në KK).

Komunat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Komunës, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal.

Kjo formulë e përfaqësimit është aplikuar që nga fillimi.

Me respekt,

Sazan Ibrahim

Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës